RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Auditim Financiar

Tiranë, tetor 2026

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	**PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE**	3-3
1	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3-3
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-7
II.	**HYRJA**	7
1	Objektivat dhe qëllimi	8
2	Identifikimi i çështjes	8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	10
5	Kriteret e Vlerësimit	10-11
6	Standartet e auditimit	11
7	Metodat e auditimit	10
8	Dokumentimi i auditimit	12
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	13-134
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	13
3.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	13-18
3.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	18-31
3.3	Auditim mbi të ardhurat vendore	31-48
3.4	Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025	48-99
3.5	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	99-134
IV.	**REKOMANDIME**	134-154

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Bashkia Përmet, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligji nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Përmet për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

b. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimet e auditimit të tij:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Përmet. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.*
- *Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.*
-*Auditim mbi burimin e krijimit të të ardhurave.*
-*Auditim mbi pasqyrat financiare të vitit 2025.*
-*Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

c. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar transaksionet e likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

d. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

-Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit rezulton një nivel i lartë detyrimeve debitore në Bashkinë Përmet në fund të vitit 2025, që ka ardhur në rritje prej +11,376,415 lekë, ose + 12.3 % më shumë se fundi i vitit të mëparshëm, ku shtesat vjetore të llogarisë së debitorëve janë 14,164,044 lekë dhe likuidimet/ shlyerjet për 2,787,629 lekë. Gjendja e mbartur e debitorëve (llog.468) deri me 31.12.2024 është 92,2 milionë lekë kurse në fund t vitit 2025 detyrimet debitorë të paraqitura në llogarinë 468 janë 103,6 milionë lekë.

- Nga auditimi i të ardhurave tatimore konstatohet se deri më datë 31.12.2025, për mos pagesën e detyrimeve tatimore *janë debitorë 85 subjekte si biznes i vogël dhe biznes i madh*, në vlerën 427,585 mijë lekë, nga 521 subjekte të regjistruara. Përgjatë vitit 2025 vlerës së detyrimeve të mbartura për taksa e tarifa vendore më datë 31.12.2024 prej 30,450,900 lekë i janë shtuar debitorë në 3,432,894 lekë, ku vlera e arkëtuar është 27,910,524 lekë. Gjendja e detyrimeve të pa arkëtuara më datë 31.12.2025, rezulton për 31,343,418 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Përmet, ku niveli i detyrimeve në fund të vitit 2025 është më i lartë në shumën +892,518 më shumë se niveli i detyrimeve të datës 31.12.2024

-Nga auditimi i borxheve dhe detyrimeve vjetore për taksat dhe tatimet vjetore në Bashkinë Përmet për vitin 2025 rezultoi se në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm"*, në Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025, nuk është kontabilizuar vlera totale prej 2,054,221 lekë e 1,486 debitorëve familjarë.
-Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Përmet së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifike ka vlerën 514,848 mijë lekë, buxheti i rishikuar ka vlerën 559,550 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 426,705 mijë lekë ose në masën 76%, me një mosrealizim të fondeve prej -132,845 mijë lekë.Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është realizuar në masën 90 %; zëri shpenzime operative (602) dhe zëri transferta në buxhete familjare (604) është realizuar në masën 74 %. Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli 230-231) është realizuar në nivelin 52%.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:
-Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm, në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e miratimin e pasqyrave financiare.
- Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik, Drejtoria Financës dhe e Buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë Përmet, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës së borxhit progresiv tatimor prej 57,000,236 lekë dhe veçanërisht për arkëtimin e debisë prej 34,776,313 lekë të debitorëve të kategorisë "biznes".
-Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të marrin masat për verifikimin e listës së debitorëve të trashëguar nga ish- komunat për saktësimin e numrit dhe të debitorëve
-Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë, duke marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces zbatimi;
-Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata (AAGJ), i cili të verifikojë dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse për gjithë zërat e aktiveve dhe në përfundim të punës komisioni të hartojë raportin për drejtuesin e institucionit mbi rezultatet e inventarizimit.
Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të Bashkisë Përmet, të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e punës në mbajtjen e Regjistri të Aktiveve të institucionit, i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vend ndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.
Regjistri të Aktiveve të përfshijë aktivet afatgjata dhe afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e saj.

-Bashkia Përmet të marrë masat për forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar automatizimin dhe integrimin e proceseve të kontabilitetit dhe administrimit të të ardhurave, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Për këtë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të implementojë dhe përdorë një sistem të certifikuar/program kontabiliteti për regjistrimin e veprimeve financiare, duke eliminuar mbajtjen manuale të ditarëve dhe duke siguruar mbajtjen e centralizuar dhe të plotë të të dhënave, për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe implementimit të programeve financiare, që garantojnë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të kryejë analizimin, sistemimin dhe rakordimin e tepricave të llogarive *4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)"*, me qëllim eliminimin e mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, si dhe sigurimin e klasifikimit dhe paraqitjes së tyre në përputhje me kërkesat e kuadrit normativ në fuqi.
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Përmet të marrë masa të kryejë një analizë të detajuar të dokumentacionit financiar dhe ligjor të të dhënave për llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" dhe për sistemimin e trajtimi kontabël të aktiveve të regjistruara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", që nuk plotësojnë kriteret e njohjes si asete të njësisë, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi; të cilat për 5 (pesë) raste të audituara për investime nga ana e Bashkisë Përmet nuk janë në posedim apo pronësi të saj, por përfaqësojnë investime në favor të komunitetit përfitues me vlerë sipas kostos historike **144,456,959 lekë**.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion mbi auditimin financiar[1]: *i kualifikuar*
Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Përmet, për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të fluksit të mjeteve monetare (cash flow), të ndryshimit të aktiveve neto/flukseve neto dhe shënimet shpjeguese.
Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:
Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Përmet nuk paraqesin në mënyrë të drejtë disa elementë të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin e Kualifikuar", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **"opinioni të kualifikuar"[2]**, e shprehur kjo sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm.

Baza për opinionin:

1 - Mbështetur në ligjin nr. 154/2014 "Për organizmin dhe funksionimin e KLSH-së".
2 - Sipas Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së miratuar me Vendimin nr. 246, datë 19.12.2022 të Kryetarit te KLSH-së, Kapitulli VII, pika 4.2, (fq 54, 60-61): "Opinioni i modifikuar" do të jepet në rastet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*", pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI- P1, "Deklarata e Limës", INTOSAI -P10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 130 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit të llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së që për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025 është përcaktuar në shumën 8,752 mijë lekë për shpenzimet dhe 1,277 mijë lekë për të ardhura, si dhe mangësitë/ anomalitë e mëposhtme:

- Nga auditimi i gjendjes së e llogarisë 210 "*Toka, troje, terrene*" rezultoi se nuk është përfshirë në 110 raste vlera e truallit të aktiveve afatgjata materiale (llog.212) në pronësi të Bashkisë Përmet. me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.

-Në llogarinë 212 "*Ndërtesa dhe Konstruksione*" janë kontabilizuar dhe kapitalizuar 5 (pesë) zëra shpenzimesh për investime nga ana e Bashkisë Përmet në shumën 144,456,959 lekë, të cilat nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Përmet, pasi janë shpenzime për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për shumën 144,456,959 lekë.

- Bashkia Përmet ka në administrim 22 (njëzetë e dy) banesa të llojit apartament të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara në pronësi të saj, me vlerë privatizimi 34,084,716 lekë, nga të cilat me datën 31.12.2025 mbeten në pronësi të kësaj Bashkie 20 (njëzetë) apartamente. Vlera e këtyre apartamenteve të regjistruara në ASHK për llogari të Bashkisë Përmet nuk është përfshirë në llogarinë 212 "*Ndërtime e rikonstruksione"* dhe nuk janë përfshirë as në Regjistrin e Aktiveve të kësaj Bashkie.

- Nuk ka gjetur zbatim rekomandimi i lënë më parë për saktësimin e vlerës së llogarisë 26 mbi aktivet financiare me pjesëmarrje, me ndikim në saktësinë e informacionit kontabël.

- Raportimi i detyrimeve të prapambetura si në strukturë dhe në vlerë totale nuk përputhet me detyrimet e prapambetura në fakt, pasi shuma e detyrimeve në vlerën 4,880,824 lekë e lidhur me vendime gjyqësore të formës së prerë nuk është kontabilizuar më datën 31.12.2025 si shtesë e llogarisë 467 "*Kreditorë të ndryshëm",* duke nënvleftësuar për këtë shumë vlerën e kësaj llogarie. Si rrjedhojë, përllogaritja e vështirësisë financiare nuk është e saktë, ngaqë stoku i detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë. Sa më sipër, shuma e detyrimeve të prapambetura *(e korrigjuar)* arrin në 9,134,114 lekë, duke ndryshuar raportin e stokut të detyrimeve ndaj shpenzimeve vjetore kësaj Bashkie. Për këtë arsye dhe masa e vështirësisë financiare ndryshon nga 1% në 2 %.

- Mos pozicionim me korrektesë të llogarive kontabile sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në vitin 2025. Nga auditimi i të dhënave të llogarisë *4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"* rezultoi se totali i kësaj llogarie në fund të vitit 2025 në vlerën 39,718,239 lekë, nuk kuadron me tepricën e llogarinë 7206 *"Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit",* me një diferencë 64,904,146 lekë. Teprica e llogarisë *4341 "Operacion me shtetin (detyrime)"* sipas Pasqyrave të Llogaridhënies Vjetore të depozituara në Degën e Thesarit

për vitin 2025, paraqitet në shumën 0 (zero) lekë. *Nga ana tjetër,* vlera totale e llogarive 411,423-429,468 është 103,608,706 lekë, me një moskuardim prej 103,608,706 lekë.
- Evidentohet një nivel i lartë i llog. 468, debitorë të pa arkëtuar, ku gjendja e mbartur e debitorëve deri me 31.12.2024 është 92,2 milionë lekë, kurse në fund të vitit 2025 detyrimet e debitorëve janë regjistruar për 103,6 milionë lekë. Në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" në Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025, nuk është kontabilizuar detyrimi në vlerën totale prej 2,054,221 lekë, që u përket 1,486 debitorëve familjarë, duke sjellë nënvlerësim të kësaj llogarie për këtë shumë.
- Vlera neto totale e aktiveve në dokumentin "Regjistri i Aktiveve" nuk përputhet me vlerën neto të aktiveve në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore (Formati 7/b) me datën 31.12.2025. Regjistri i Aktiveve i vitit 2025 nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale, jomateriale, llogaritë e pjesëmarrjes në kapital dhe afatshkurtra, si dhe nuk është i plotësuar sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë përgjegjëse për financat.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH"*, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 379/1 prot., datë 09.04.2026 *"Auditim Financiar në Bashkinë* Përmet*"*, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.04.2026 – 22.05.2026, në subjektin Bashkia Përmet krye "*Auditim Financiar*" për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 - 31.12.2025, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Q.C. *përgjegjës grupi*
2. I. U. *auditues*
3. V. K. *auditues*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Auditimi Financiar në Bashkinë Përmet kishte si objektiva kryesore: - Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij; - Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315); - Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Përmet është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

2. Identifikimi i çështjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Përmet, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Përmet.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Përmet janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Kryetari i Bashkisë Përmet *(Administratori i Përgjithshëm)*, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës dhe Buxhetit, në cilësisë *e Nëpunësit Zbatues* (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Përmet, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3. *Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret ligjore duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kuadrin rregullues mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiar* të llogaridhënies vjetore; ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Përmet në raport me kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI (sipas INOTSAI), të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispoizcion të auditimit.
Audituesit kanë zbatuar Parimet e Auditimit Financiar; kërkesat Etike dhe pavarësinë, Kontrollin e Cilësisë, Menaxhimin e grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.
Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, etj.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Përmet është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.
Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit.
Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:
-Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 "*Mbi Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".
- Ligji nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *"Për financat e vetëqeverisjes vendore";*
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar*;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;*
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Ligji nr. 152-2013, "*Për nëpunësin civil",* i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore"* i ndryshuar*;*
- Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 *"Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë",* i ndryshuar
- VKM nr.500 datë 14.08.2001 *"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendor"*
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "*Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim*;
-VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", me ndryshime*;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",* i ndryshuar;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar*;*
- Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 "*Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike"*
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*,
-UMF nr. 2, datë 27.09.2019 "*Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*".
-Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 "*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*", i ndryshuar;
-Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2021 "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit*";
-Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", i ndryshuar;
-Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
-Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut, etj.

6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

- INTOSAI P1- Deklarata e Limës me udhëzuesit për kryerjen e auditimit.
- ISSAI 100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*" .
- ISSAI 1300 "*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*";
- ISSAI 200 "*Parimet e auditimit financiar*" dhe
- ISSAI 2000-2200 "Aplikimi i stadardeve te auditimit financiar"
- ISSAI 1000-2999 "*Udhëzues të Auditimit Financiar*";
- INTOSAI GOV 9100 "*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*" si dhe INTOSAI GOV 9110 "*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Rregullore e brendshme *"Mbi procedurat e auditimit në KLSH"*;
- Rregullore e brendshme "*Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së"*;

7. Metodat e auditimit*:*

Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me evidence dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Sa më sipër, audituesit kanë aplikuar auditim *i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje, mbi bazën e riskut të vlerësuar.* Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, janë marrë në konsideratë dy elementë:
- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe - Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.
Nga ana e grupit të auditimit auditohen procedurat, mbi këto aspekte si më poshtë:

- *Kontrolli aritmetik.*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të

bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë gabime. *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)*

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi i MF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

- *Kontrolli i vlerësimit*.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.*

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi*.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- Intervista

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Përmet me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

- *Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

- Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të 17 influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja . Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike

(ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirë informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar dhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH, me ndryshimet. Gjithashtu, është mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit", duka administruar dokumentacion të mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve.
Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

- Sipas shkresës së KLSH-së me nr.379/3 prot., datë 25.06.2026, në subjektin e auditimit Bashkia Përmet është dërguar Projekt Raporti i auditimit.
- Bashkia Përmet nuk ka përcjellë pranë KLSH-së komente, shpjegime apo observacione *(në formë shkresore dhe elektronike)* mbi Projekt-Raportin e Auditimit brenda afatit 1-mujor nga data e marrjes në dorëzim nga personat përgjegjës, referuar parashikimeve të neneve 26 dhe 29, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".* Për rrjedhojë, në mungesë të reagimit zyrtar brenda afatit ligjor të përcaktuar, Projekt-Raporti i hartuar është konsideruar i mirëqenë dhe mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Auditimi në subjektin "Bashkia Përmet", u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t'u audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e

realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave. Bashkia Përmet është e organizuar dhe funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*". Profili i Bashkisë Përmet: Përmeti kufizohet në veri me Bashkinë Skrapar, në lindje me Bashkinë Përmet, në perëndim me Bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Përmetit. Kjo Bashki përbëhet nga 5 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Bashkia e Përmetit rrethohet nga pasuri të rralla natyrore e monumentale, por edhe historike, kisha dhe manastire të vjetra. Një nga pasuritë e rralla të zonës, Ujërat Termale të Bënjës, gati 14 km larg qytetit të Përmetit. Bashkisë do t`i duhet të shtojë lidhjet me programe ndërkombëtare për të thithur donatorë dhe mbështetur sektorin turistik. Ky sektor lidhet edhe me rritjen e tregut për produktet origjinale të zonës apo punimet artizanale. Bashkia duhet të gjejë mundësi të reja për punësimin e grave, sidomos në biznese të vogla prodhuese dhe me profilin e ri të zhvillojë sektorin e agrobiznesit, të vreshtarisë dhe prodhimit të verës. Shërbimet shëndetësore kanë nevojë të përmirësohen, ndërsa spitali i Përmetit ka nevojë për një staf më profesional dhe për mirëmenaxhim të shërbimeve. Po kështu, sektori arsimor ka nevojë të ristrukturohet në funksion të mbështetjes së transportit të nxënësve dhe të përmirësimit të mjediseve shkollore.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Auditimi u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Të dhëna të përgjithshme të bashkisë Përmet janë dhënë si më poshtë:

Qarku	Qendra e Bashkisë Përmet	Njësitë Administrative	Numri i fshatrave	Numri i popullsisë
Gjirokastër	Përmet	Përmet	Qyteti	20,301
		NJA Çarçovë	9	
		NJA Frashër	8	
		NJA Petran	15	
		NJA Qendër Piskovë	17	

Nga auditimi në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të kësaj Bashkie rezultoi sa vijon :

2.1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi si dhe monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për vitin 2025

Bashkia Përmet ushtron funksionet e saj. në zbatimin e Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". Aktivitetet kryesore të Bashkisë Përmet për vitin 2025 janë të organizuara sipas natyrës sëprocesve dhe detyrave funksionale në: Aparati (Politikëbërja, Njësia e Funksioneve dhe Njësia e Shërbimeve), të cilat integrohen nëpërmjet 5 drejtorive kryesore, si më poshtë: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Projekteve të Huaja, Drejtoria e Urbanistikës/Planifikimit

të Territorit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë e Turizmit, Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit e Kulturës. Për vitin 2025, numri i përgjithshëm i punonjësve të institucionit, është miratuar me Vendimin, nr.15, datë 15.01.2025, "*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Përmet për vitin 2025*", të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak (VKB) nr.107, datë 18/12/2024, "*Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj*" dhe VKB nr.109 datë 18/12/2024 "*Për miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të punonjësve të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar bashkisë të bashkisë Përmet dhe të institucioneve që varen prej saj për vitin 2025*" .

Për 37 pozicione pune, marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ndërsa 271 pozicione pune, që janë punonjës administrativë (punonjës që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtje, shërbimi, ruajtje, etj.) marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Numri i përgjithshëm i punonjësve është 320 punonjës. Analiza e hollësishme e 5 (pesë) komponentëve të MFK dhe zbërthimi i çdo parimi është trajtuar në Akt Konstatimin nr.1, datë 22.05.2026 të depozituar në Bashkinë Përmet, ku në trajtë të përmbledhur konsistojnë sa vijon:

- *Mjedisi i Kontrollit* nuk është implementuar i plotë, dhe për rrjedhojë nuk funksionon në një shkallë të mjaftueshme. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, zhvillimin e kapaciteteve etj. Mjedisi i kontrollit nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta, dhe si pasojë aktivitetet e kontrollit rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet e punës bazuar në "*Kodin punës*" nuk janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë, mënyra apo kriteret e rekrutimit/largimit për çdo pozicion. Mungojnë politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit menaxherial dhe punonjësve të këtij institucioni. Për largimet nga puna, nuk është zbatuar kriteri i përcaktuar ne VKM 124, datë 17.02.2016, Kreu III, pika 29, ku të dokumentohet dorëzimi i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse si dhe dokumentacioni që disponon punonjësi për shkak të detyrës.

Në rregulloren e brendshme, mungojnë përshkrimet e detajuara të proceseve, rrjedhës së punës, procedurat për informimin dhe raportimin, si dhe proceset e vendimmarrjes individuale me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë janë realizuar takime të vazhdueshme me menaxherët e lartë dhe me drejtuesit e njësive të vartësisë, por pavarësisht nga kjo nuk provohet se ka vendosur rregulla dhe procedura lidhur me proceset kryesore me qëllim për të monitoruar zbatimin e tyre, p.sh si identifikohen dhe reagohet ndaj risqeve në nivelet e caktuara të menaxhimit etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin Nr.10296/2010 "*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar, neni 9, pika 4 shkronja (f).

Nga ana e GMS janë realizuar takime vetëm mbi aspektet të planifikimit dhe monitorimit të PBA, të cilat janë dokumentuar përmes procesverbaleve përkatëse.

- *Menaxhimi i Riskut* nuk funksionon mjaftueshëm. Rezulton se është ngritur Grupi Koordinues Teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet, ku janë përfshirë të gjitha strukturat funksionale të Bashkisë Përmet. por nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priotizimin e risqeve të përputhshmërisë (*analiza probabilitet x impakt dhe rivlerësimi i risqeve pas kontrolleve që implementohen nga menaxhimi).* Identifikimi, analiza dhe aktivitetet për

menaxhimin e riskut, nuk janë dokumentuar për çdo fazë duke lënë gjurmë në regjistrat e riskut dhe në planet e veprimit. Nga ana e Bashkisë nuk janë përcaktuar kontrollet specifike për çdo risk dhe niveli i risqeve pas implementimit të këtyre masave korrigjuese.
Nga auditimi konstatohet se, nuk ka një praktikë komunikimi për risqet e identifikuara dhe aktivitetet e ndërmarra në përgjigje të risqeve. Gjatë hartimit të Regjistrit të Riskut, risqet e brendshme nuk lidhen konkretisht me aspektet konkrete të procesit të planifikimit, veprimeve dhe transaksioneve operacionale, angazhimit të burimeve njerëzore, të mbikëqyrjes (ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës dhe raportimit për objektivat, etj.). Regjistri vjetor i risqeve nuk është hartuar si një dokument i konsoliduar deri në fund të muajit Dhjetor të vitit 2025 nga kjo njësi publike, duke marrë në konsideratë objektivat e njësisë publike, burimet financiare dhe planet operacionale të punës së çdo strukture të miratuara me buxhetin vjetor. Nuk ka një strategji te riskut apo identifikim te tij, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, të Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe UMF nr.16, dt. 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e Grupit të menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në Njësitë Publike"*

- *Aktivitetet e Kontrollit* përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm. Në Bashkinë Përmet zbatohet kontrolli parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen çdo vit vetëm nga KLSH, pasi kjo Bashki nuk ka krijuar NJAB. Nga auditimi, rezultojnë procedura kontrolli vetëm për të dhënat financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit realizohen kontrolle të rakordimeve të brendshme dhe veprime korrigjuese (stornuese) nga specialistët e kontabilitetit në mbajtjen e ditarëve, hartimin e listë pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera. Aktivitetet e kontrollit nuk kuptohen mjaftueshëm dhe për pasojë një pjesë e mirë e tyre mungojnë, si p.sh. mungon një rregullore për aksesin në aplikacione të ndryshme si p.sh. GIS etj. Rregullorja e Brendshme e Bashkisë nuk përcakton objektivat dhe detyrat specifike referuar Strukturës Organizative të miratuar. Kështu, në rregulloren e brendshme të Bashkisë Përmet nuk janë të përcaktuara detyrat funksionale të specialistit të IT-së, duke krijuar boshllëk në përcaktimin e përgjegjësive, roleve, funksioneve dhe aspekteve koordinuese, si dhe me ndikim në vlerësimin e performancës së këtij funksionit të rëndësishëm. Bashkia Përmet nuk ka hartuar e miratuar procedura të plota e të përshtatshme për të siguruar infrastrukturën e IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Nga auditimi, bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion, rezulton se ndryshimet e bëra në strukturën organizative nuk janë shoqëruar me përditësimin e rregullores së brendshme.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Mungesa e gjurmëve të auditimit, sipas proceseve kryesore dhe procedurave që zbatohen nga çdo drejtori si pjesë e strukturës së miratuar të kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore, krijon vështirësi në ndërtimin e skemave funksionale dhe monitorimin efektiv të tyre, pasi nga auditimi konstatohet se nuk janë hartuar gjurmët e auditimit dhe manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore, për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

-Programi i përdorur nga sektori i financës për përpunimin e raporteve është program *në Microsoft Excel,* ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Nuk është përgatitur rregullorja për shërbimin IT dhe nuk ka sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e të dhënave të

menaxhimit financiar IT për njësinë vendore.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 4, pikat 19-20, neni 8, pika 8 germa "a", neni 16, pika 2, nenet 20-22, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.16, dt. 31.12.2024 "Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e Grupit të menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në Njësitë Publike" Kreu III neni 7, dhe kreu IV neni 12; dhe "Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4 datë 26.01.2024 Kapitulli III "Komponentët e MFK" , pika 3.5, Anekset.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.
Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Përmet, është miratuar me vendimin nr.15 datë 15.01.2025, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.107, datë 18.12.2024 "*Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë, Njësive Administrative dhe institucioneve në varësi të saj"*, në të cilën është parashikuar pozicioni i "specialistit të AB".
Nga auditimi në Bashkinë Përmet rezulton se, nuk është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, sipas përcaktimeve të pikës nr. 1/a, të Vendimit të KM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik".
Për vitin 2025 nga Sektori i Burimeve Njerëzore të Bashkisë Përmet, është shpallur njoftimi për vendin vakant të Specialistit të Auditit të Brendshëm. Njoftimi është bërë në zbatim të nenit 22 dhe nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin civil" i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar, Kreu II, IV dhe VIII. Ky publikim është bërë 3 herë, (përkatësisht sipas shkresave me nr.284 Prot.,datë 29/01/2025, nr.2169 Prot.,datë 04/07/2026 dhe nr.343 Prot.,datë 16/10/2025), por nuk është finalizuar pasi nuk ka patur aplikime për këtë pozicion.
Nga auditimi, rezulton se mungesa e burimeve njerëzore për të plotësuar njësinë e auditit të brendshëm në Bashkinë Përmet ka sjellë mungesën e vlerësimit të mjaftueshmërisë dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme dhe të sistemit të menaxhimit financiar, veprime në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*" neni 10, pika 1/b, dhe të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*" pika 6/a. me VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik".

Konkluzion*:** Grupi i auditimit të KLSH-së bazuar në informacionin e grumbulluar nga pyetësorët mbi vetëvlerësimin dhe rezultatet e testimeve të kryera nga auditimi në terren, vlerëson se sistemi i kontrollit ë brendshëm në Bashkinë Përmet ***vlerësohet pjesërisht efektiv dhe se komponentët e MFK-së ***nuk kanë funksionuar plotësisht***, ku është konstatuar se elementë të ndryshëm të sistemeve të MFK nuk kuptohen tërësisht nga njësia ose janë të implementuara në një shkallë jo të plotë e të mjaftueshme. Më konkretisht:
- Në rregulloren e brendshme të institucionit, mungojnë përshkrimet e detajuara të proceseve, rrjedhës së punës, procedurat për informimin dhe raportimin, si dhe proceset e vendimmarrjes individuale me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre. Në rregulloren e brendshme nuk janë të përcaktuara detyrat funksionale të shërbimeve të IT-së, duke krijuar boshllëk në përcaktimin e përgjegjësive, roleve, funksioneve dhe aspekteve koordinuese, si dhe me ndikim në vlerësimin e performancës së këtij funksionit të rëndësishëm.
-Mjedisi i kontrollit nuk ka përfshirë rregulla dhe procedura të qarta, dhe si pasojë aktivitetet e kontrollit rezultojnë të pamjaftueshme për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit të MFK-së. Mungojnë politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA, stafit menaxherial dhe punonjësve të këtij institucioni. Për largimet nga

puna, nuk është zbatuar kriteri i përcaktuar në VKM nr. 124, datë 17.02.2016, Kreu III, pika 29, ku të dokumentohet dorëzimi i inventarit në ngarkim, i pajisjeve dhe mjeteve të punës në njësinë përgjegjëse si dhe dokumentacioni qe disponon punonjësi për shkak të detyrës.
-Nga ky institucion, nuk janë hartuar e miratuar, gjurmët e unifikuara të auditimit për procedurat e çdo drejtorie;
-Programi i përdorur nga sektori i financës për përpunimin e raporteve është program në Microsoft Excel, ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Nuk ka sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e të dhënave të menaxhimit financiar IT për njësinë vendore.
-Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit dhe manualet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore, për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.
-Identifikimi, analiza dhe aktivitetet për menaxhimin e riskut, nuk janë dokumentuar për çdo fazë duke lënë gjurmë në regjistrat e riskut dhe në planet e veprimit. Nga ana e Bashkisë nuk janë përcaktuar kontrollet specifike për çdo risk dhe niveli i risqeve pas implementimit të këtyre masave korrigjuese.
-Regjistri vjetor i risqeve nuk është hartuar si një dokument i konsoliduar deri në fund të muajit Dhjetor të vitit 2025 nga kjo njësi publike, duke marrë në konsideratë objektivat e njësisë publike, burimet financiare dhe planet operacionale të punës së çdo strukture, bazuar në buxhetin vjetor të miratuar. Nuk ka një strategji të riskut apo identifikim të tij, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 21, të Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, si dhe UMF nr.16, dt. 31.12.2024 "*Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e Grupit të menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe funksionimin e Grupit të Menaxhimit të Risqeve në Njësitë Publike".*
-Nuk është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, sipas përcaktimeve të pikës nr. 1/a, të Vendimit të KM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik".
Sa më sipër, shkaku kryesor për gjendjen e krijuar është mungesa e krijimit të një sistemi të plotë të MFK, mungesa e funksionimit të sistemeve të MFK-së, të cilat sjellin për pasojë që këto sisteme të mos kuptohen nga njësia publike dhe mungesën e reagimit ndaj risqeve të mundshme.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"* i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma "b"; Ligjin nr. 114/2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik",* neni 13; Vendimin e KM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", pika nr. 1/a. "Manualin e MFK", miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.4 datë 26.01.2024, Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016, *"Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike",* pika 2.3;
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj. A.H, me detyrë Kryetar i Bashkisë Përmet, zj.E.K me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1.1.Programimi PBA-së 2025-2027 dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2025 deri më 31.12.2025:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2025-2027, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipet e Menaxhimit te Programeve (EMP) për PBA 2025-2027 dhe buxhetin vjetor 2025 me Urdhrin

nr.44, datë 11.2.025. Mbi këtë bazë janë hartuar Deklarata e Politikës së Programit dhe Produktet e Programit dhe kostot përkatëse të tyre si pjesë e PBA-së. Grupi i auditimit ka analizuar dokumentacionin e hartimit te PBA-se për tre fazat dhe dokumentimin e hartimit të kërkesave buxhetore nga çdo sektor apo zyrë:

- ✓ Sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë me nr.388, datë 01.11.2024 është krijuar grupi i punës për hartimin e buxhetit të vitit 2025 ku përfshihen GMS dhe drejtues të NJA dhe institucioneve të varësisë së Bashkisë
- ✓ Me vendimin e Këshillin Bashkiak nr.11, datë 30.01.2024 janë miratuar "Vlerësimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2025-2027".
- ✓ Është miratuar në Këshillin Bashkiak nr.99, datë 18.12.2023 "Kalendari i Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025" si dhe janë miratuar tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027
- ✓ Kryetari i Bashkisë Përmet ka dërguar pranë Ministrisë së Financave projekt-dokumenti i PBA 2025-2027 ***(Faza I)*** me shkresën Nr.1435/1 prot., datë 25.06.2024. Pas dërgimit të komenteve nga Ministria e Financave mbi projekt-dokumentin e programit buxhetor afatmesëm është bërë miratimi i PBA 2025-2027 (Faza 1) me VKB nr. 39, datë 07.06.2024.
- ✓ Janë miratuar tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm dhe është bërë miratimi i PBA 2025-2027 *(Faza II)* sipas VKB nr. 68, datë 25.09.2024. Nga ana e Bashkisë është dërguar në Ministrinë e Financave faza e dytë e PBA-së me shkresën Nr.2594 prot., datë 07.10.2024.
- ✓ *Faza e III* e Buxhetit afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Përmet është miratuar me VKB nr. 110, datë 18.12.2024. Faza 3 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr.71 prot., datë 13.01.2025.
- ✓ Sipas VKB nr.107, datë 18.12.2024 është miratuar Buxheti Vjetor 2025 (*me të ardhurat gjithsej dhe shpenzimet gjithsej në shumën* 504,839 mijë lekë *dhe të detajuara sipas natyrës, miratuar plani i të ardhurave për periudhën 3 vjeçare të PBA-së dhe detajimi i buxhetit 2025-2027 për grupin e shpenzimeve korente dhe kapitale sipas programit buxhetor afatmesëm 2025-2027).* Buxheti i Bashkisë Përmet për vitin 2025 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën Nr.71 prot., datë 13.01.2025.

- Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, për vitin 2025 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve në zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 27, pika 2; pikën nr. 2.4.2, "Grupi i Menaxhimit Strategjik", të Manualit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.01.2024; Paragrafin 13 të Udhëzimit të MF nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"; si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.01.2024 dhe Udhëzimin nr. 3, datë 28.02.2024, "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027", pika 11 .

Shpërndarja e programeve buxhetore për vitin 2025 sipas funksioneve/nënfunksioneve që NJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre, i atribuohet kërkesave të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". Nga auditimi evidentohet se, që prej vitit 2024, Bashkia Përmet është përfshirë si bashki pilot në zbatimin e metodologjisë së re të Programit Buxhetor Afatmesëm, në zbatim të Udhëzimit nr. 6, datë 28.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe në përputhje me Shtojcën nr. 5 "Metodologjia e re e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024–2026 dhe Buxhetit 2024". Për vitin buxhetor 2025 , buxheti dhe monitorimet e tij janë kryer në SMBV.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, pasqyruar dhe në tabelën nr. 1 (në anekset), rezultoi se nga 20 programe buxhetore të miratuara nga MF për përgatitjen e PBA 2025-2027 nga ana e Bashkisë Përmet ka funksione/nënfunksione të cilat *nuk kanë program buxhetimi*, si:

- Funksioni "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" *(neni 23):* nënfunksioni 13: "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik";
- Funksioni "Në fushën e mbrojtjes së mjedisit" *(neni 26);):* nënfunksioni :**1**.Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit,tokës dhe ujit nga ndotja. **2**.Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. **3**.Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit, etj.

Çdo funksion i përcaktuar në Ligjin 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr.7, datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shtojca 1. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit në territorin që mbulon Bashkia Përmet.

Programet buxhetore të zbatuara nga ana e Bashkisë Përmet.
Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/*2015 "Për Vetëqeverisjen vendore"*, Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008", Ligjin nr. 9652/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së buxhetit", Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018", Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shtojca 1, etj.

Konstatim: Nga verifikimi i dokumentacionit mbi përmbushjen e funksioneve të bashkisë referuar 20 programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MF për PBA 2025-2027, rezultoi se disa programet buxhetore të lidhura me funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" si dhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, nuk janë marrë në konsideratë nga Bashkia Përmet për të parashikuar fonde në buxhet, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" shtojca 1 dhe Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).

Takimet konsultative me grupet e interesit në komunitet:

Nga auditimi rezultoi se Bashkia Përmet 3.për PBA 2025-2027 dhe Projekt buxhetin e vitit 2025, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I, neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2024-2026 dhe Projekt buxheti vjetor 2024 nga ana e Bashkisë Përmet është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun.

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, web-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura në secilin takim, konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" Kreu IV, neni 11-20; dhe pika 16 e Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4)..

Kalendari i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit Vjetor.
Bashkia Përmet ka hartuar "Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor" për Bashkinë dhe njësitë administrative për vitin 2025 dhe miratuar me VKB nr. 73, datë 23.12.2024, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 33;

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor.
Programet afatmesme 2025-2027 dhe 2026-2028 janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 9652/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit", Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 6, datë 28.02.2023 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026" dhe VKB për miratimin e taksave vendore për Bashkinë për vitin 2025 .Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit),* tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).*

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2025

Të dhënat në mijë lekë

Emërtimi	Viti 2024	Viti 2025
Të ardhurat faktike	**57,926**	**78,833**
Shpenzimet faktike	**380,436**	**426,706**

Burimi: Bashkia Përmet. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

PBA 2025-2027 (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet e Këshillit Bashkiak me nr.39 , datë 07.06.2024, me VKB nr.110 , datë 18.12.2024.

- Me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr.107 datë 18.12.2024, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi njësive administrative dhe funksionet e deleguara për vitin 2025.
- Me Vendimin nr. 109, datë 18.12.2024 është miratuar niveli i pagave të Bashkisë.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive: Të dhëna në formë tabelore për planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet jepen në tabelën në vijim:

Tabela nr. 1, Të dhënat planifikimin e buxhetit bazë dhe ndryshimet *në mijë lekë*

Njësia	Bashkia + Ndërmarrjet/institucionet e vartësisë Viti 2025							
Art.	Emërtimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)=(5)-(4)	5/4*100
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2024	**PBA Plan Viti 2025**	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2025	**Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2025**	**Fakti 12-mujorit 2025**	Diferenca F-P	% e realizimit
600	Paga	197100	250569	250569	259143	233314	-25829	90
601	Sigurime Shoqërore	32457	39533	39533	41664	38352	-3312	92
600+601	**Paga +Sigurime**	**229557**	**290102**	**290102**	**300807**	**271666**	-29141	90
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	66224	75532	75532	80889	58243	-22646	72
603	Subvencione							
604	Transferta Korente të Brendshme	4896	5925	5925	7170	6503	-667	91
605	Transferta Korente të Huaja							
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	5755	3754	3754	9300	7390	-1910	79
602-606	Shpenzime operative	76875	85211	85211	97359	72136	-25223	74
609	Rezervat		5156	5156	2864		-2864	0
Shpenzime Korrente		76875	90367	90367	100223	72136	-28087	72
230	Kapitale të Patrupëzuara	6436	1470	1470	3955	1148	-2807	29
231	Kapitale të Trupëzuara	68958	132909	132909	154565	81755	-72810	53
Totali	**Shpenzime Kapitale**	75394	134379	134379	158520	82903	-75617	52
Totali (korrente + kapitale)		381826	514848	514848	559550	426705	-132845	7

Burimi: Bashkia Përmet

Në tabelën e mësipërme nuk janë përfshirë të dhënat e Projekteve me Skemë të Pjesshme Thesari në vlerën 38,140,000 lekë, pasi sistemi i SMBV i përjashton këto financime.

- ✓ Për vitin 2025, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 107, datë 18.12.2024, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1029,1, datë 08.01.2025.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2025 kanë vlerën 106,357,000 lekë, transferta e pakushtëzuar ka vlerën 220,294,000 lekë, transferta specifike ka vlerën 178,188,000lekë, të ardhurat e pritshme nga marrëveshjet ndërkombëtare me skemë të plotë Thesari ka vlerën 8,472 ,000 lekë, të ardhurat e pritshme nga marrëveshjet ndërkombëtare me skemë të pjesshme Thesari 38,140,000 lekë,të ardhurat e pritshme nga marrëveshjet me (UNDP) në vlerën 1,537,000 lekë.

Në total të ardhurat janë ë vlerën 552,988,000 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 552,988,000 lekë.

-Gjatë vitit 2025, janë marrë gjithashtu disa vendime të Këshillit Bashkiak Përmet të cilat kanë miratuar ndryshimin e vlerave të buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- ✓ Me VKB nr.17, datë 18.02.2025, për miratimin e buxhetit shtesë për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2024, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 42,989,109 lekë.

- ✓ Me VKB nr.55 ,datë 02.07.2025 "Për disa ndryshime në VKB nr.107, datë 18.12.2024"
- ✓ Me VKB nr.76 datë 23.09.2025"Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr.107, datë 18.12.2024".Buxheti shtesë shtohet me 4,000,000 lekë dhe në të njëjtën vlerë dhe shpenzimet.
- ✓ Me VKB nr.93, datë 22.10.2025 "Për një ndryshim në VKB nr.107, datë 18.12.2024"
- ✓ Me VKB nr.97, datë 13.11.2025 "Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB nr.107, datë 18.12.2024". Buxheti shtohet me vlerën 1,219,314 lekë dhe pakësohet me Kap. 02 në vlerën 3,505,000 lekë.

Sa më sipër, në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të MF nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", pika 114:

2.1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grande qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit të institucionit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të KB.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, por kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Përmet dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregon se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Përmet si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2025, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferta e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të audituesve të KLSH-së rezulton se realizimi i shpenzimeve buxhetore *me të ardhurat e veta të Bashkisë Përmet së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike*, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën **514,848 mijë** lekë, buxheti i rishikuar ka vlerën **559,550 mijë** lekë, ndërsa realizimi është në vlerën **426,705 mijë** lekë ose në masën **76**%. Me një mosrealizim të fondeve prej **-132,845 mijë lekë.**

- Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 271,666 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 300,807 mijë lekë ose në masën 90 %.
- Zëri shpenzime operative (602) dhe Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 97,359 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 72,136 mijë lekë ose në masën 74 %.
- Niveli i realizmit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli 230-231) është planifikuar në vlerën **158,520** mijë lekë dhe është realizuar në vlerën **82,903** mijë lekë me një mosrealizim të këtyre fondeve prej **- 75,617** mijë lekë, ose realizimi në nivelin **52%.**

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Përmet në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"* neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",* UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm"* dhe VKB përkatëse.

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta:

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2025 ka vlerën 74,865 mijë lekë, ndërsa realizimi ka vlerën 78,834 mijë lekë ose në masën 105 %. Bashkia Përmet ka pasur të ardhura të trashëguara nga viti 2024 shumën 109,643,306.98 lekë nga të cilat :

- granti në vlerën 91,171,969.4 lekë
- të ardhura në vlerën 17,117,190.63 lekë
- të ardhura jashtë limitit në vlerën 402,913 lekë
- të ardhura nga projekte të huaja në vlerën 951,233.95 lekë.

Gjatë viti 2025 shuma e përdorur e të ardhurave për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale të Bashkisë Përmet është në vlerën 86,419,738 lekë.

Kjo vlerë ka mbuluar zërat e shpenzimeve si më poshtë:

- Llogaria 600 (Paga) në shumën 27,679,323 lekë;
- Llogaria 601 (Sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 238,567 lekë;

- Llogaria 602 (Blerje mallra, shërbime) në shumën 11,404,350 mijë lekë;
- Llogaria 606 (Transferta buxhete familjarë, individ) në shumën 1,726,084 lekë;
- Llogaria 230-231 (Investime kapitale) në shumën 42,494,281 lekë.
- Llogaria 604 (Transferime korrente te brendshme) në shumën 2,877,133 lekë;

Buxheti faktik i vitit 2025 është në vlerën 643,281,018 lekë duke përfshirë transfertat e kushtëzuara për investime për ndihmën ekonomike dhe PAK.
Sipas realizimit të buxhetit Bashkia Përmet me të ardhurat e veta mbulon **13 %** të buxhetit vjetor 2025. Të dhënat e mësipërme për vitin 2025, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë:
Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë.
Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjencës.
Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.
Fondet e Emergjencës planifikohen për të përballuar situata emergjente në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001, "Për Emergjencat Civile" i ndryshuar, të nenit 29 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të pikës III/3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".
Mbështetur në nenin 65 të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej *4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre*, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e veta vendore etj.
U audituan për vitin 2025:

- ✓ vlerat e llogaritura për këtë qëllim;
- ✓ mënyrën e llogaritjes të kësaj vlere, bazën ligjore për këtë;
- ✓ vlera e përdorur në fakt, destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve nga Bashkia Përmet;
- ✓ vlera e pa përdorur

Me anë të VKB nr. 107, datë 18.12.2024 si dhe me VKB nr.17 datë 18.02.2025 *"Për disa shtesa në VKB nr.107 datë 18.12.2024"* janë miratuar për vitin 2025, fondi rezervë, i kontigjencës, si dhe fondi i emergjencës në total **5,926,000** lekë, si vijon:

- fondi rezervë dhe kontigjence nga granti në vlerën 500,000 lekë;
- fondi rezervë dhe kontigjence nga të ardhurat në vlerën 1,000,000 lekë;
- fondi i emergjencës civile në vlerën 4,426,000 lekë.

Parashikimi i fondeve të emergjencave civile dhe fondit rezervë është mbështetur në përvojën e viteve të mëparshme, ndërsa fondi i kontigjence parashikohet duke filluar nga viti 2008-2009 dhe në vijim. Ndryshe nga sa më sipër, fondi i emergjencave civile planifikohet në shume totale minimalisht 4% të totalit të buxhetit të Bashkisë, ka filluar nga viti 2020. Nga Bashkia Përmet në

buxhetin e vitit 2025 është parashikuar fondi i rezervë dhe kontigjence në vlerën **1,500,000** lekë. Struktura e fondeve me destinacion:

Në lekë

Emërtimi	**Plan 2025**	**Fakt 2025**
Fondi rezervë dhe fond kontigjence	1,500,000	1,492,000
Fondi i emergjencës	4,426,000	144,622
Shuma	**5,926,000**	**1,636,622**

Burimi: Bashkia Përmet

A. Fondi Rezervë**:** Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe nenit 6 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, është krijuar Fondi rezervë. Në buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025, është planifikuar fond rezervë (së bashku me fondin e kontigjencës, referuar VKB nr. 107, dt. 18.12.2024 (*fq. 6 e tabelave që shoqërojnë VKB-në*) në vlerën 1,500 mijë lekë.
B. Fondi i Kontingjencës**:** Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.
C. Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile**:** Në zbatim të nenit 65 të Ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.
Likuidimi i sipas urdhër shpenzimit:
Me anë të shkresës nr.492/1 datë 25.02.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është bërë çelje fondi i kushtëzuar për mbrojtjen civile për Bashkinë Përmet, në vlerën 3,838,799 lekë. Nga ky fond janë shpenzuar 528,000 lekë sipas urdhër shpenzimeve të mëposhtme:
1.Urdhër shpenzimi nr.938 datë 03.11.2025 në vlerën 484,000 lekë.
2.Urdhër shpenzimi nr.939 datë 03.11.2025 në vlerën 44,000 lekë.
Për vitin 2025 fondi i emergjencave është shpenzuar në vlerën 144,622 lekë kundrejt planit në vlerën 4,426,000 lekë, (Urdhër shpenzimi nr.988 datë 06.11.2025 në vlerën 144,622 lekë).

- Subvencione: Bashkia Përmet për vitin nuk ka pasur subvencione për vitin 2025.
- Kredi të marra**:** Bashkia Përmet nuk ka marrë kredi për vitin 2025.

3.1.3 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.,).

Bashkia Përmet më datë 01.01.2025, ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta vlerën **2,648,974** lekë. *Nga kjo vlerë e përfshirë në planin e buxhetit vjetor të vitit 2025 është parashikuar fondi* 4,898,069 lekë *për likuidimin e këtyre detyrimeve përgjatë vitit 2025***.** Gjatë vitit 2025 është likuiduar vlera e detyrimeve vjetore e të prapambetura ku në fakt janë kryer pagesat për **644,779 lekë,** si në tabelën e mëposhtme. Më datë 31.12.2025, vlera totale e detyrimeve të prapambetura me burim financimi nga të ardhurat e veta është në vlerën **4,253,290** lekë. Detyrimet e Bashkisë Përmet vijnë nga kontrata të mëparshme të trashëguara edhe nga ish-komunat të cilat kanë mungesa dokumentacioni ose kompanitë të cilat kanë kryer shërbimin nuk janë më aktive.

Detyrimet e prapambetura 2025.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se, vlera e raportuar nga Bashkia Përmet në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2025, është **4,253,290 lekë**, dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtorisë së Financave Vendore) në kuadër të vetëvlerësimit financiar për 4-mujorin e tretë Shtator - Dhjetor 2025. Referuar përcaktimeve të Kreut II, pikat nr. 6 dhe 13, të Udhëzimit të MF nr.35, dt. 29.12.2023 *"Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare të NJQV-të":*

6."Detyrime financiare të prapambetura (të konstatuara dhe të papaguara)" konsiderohen detyrimet financiare të transaksioneve të shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore të cilat rezultojnë të papaguara prej mbi 60 ditë kalendarike që nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik, si edhe ato pas afatit të pagesës të përcaktuar në marrëveshjen apo legjislacionin përkatës. (p.sh marrëdhëniet e punës dhe kontributeve, vendimet gjyqësore, për rimbursimin e TVSH-së etj.).

13. "Gjendje normale financiare", *në kuptimin e këtij udhëzimi quhet rasti kur detyrimi financiar i prapambetur është nën 15% të shpenzimeve vjetore faktike, dhe që është në një afat nën 60 ditë kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit).*

Tabela nr.2. Gjendja e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Përmet me dt. 31.12.2025

Në Lekë

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	**Borxhe (a+b)**			
a	**Hua afatgjatë**			
a.1	Principali			
a.2	Interesi			
B	**Hua afatshkurtër**			
b.1	Hua			
b.2	Overdrafte			
b.3	Kredi të furnitorëve			
II	**Detyrimet e prapambetura**	**4,253,290**		
				1 %
A	Vendime Gjyqësore	302,088		
a.1	Shërbime			
a.2	Energji elektrike	2,346,886		
a.3	Mirëmbajtje			
B	Investime	1,604,316		
b.1	Rimbursim TVSh			
b.2	Mallra			
C	Të tjera			
c.1	Sigurime shoqërore			
c.2	Sigurime shëndetësore			
c,.3	Ardhura personale			
	Tatime të tjera			
	Paga			
	Shpronësime			
	Transferta individ			
	Transferta subjektet			
III	**Totali (I + II)**	**4,253,290**	**426,705,665**	**1%**

Burimi: Bashkia Përmet, Raportimi në MF (Drejtorisë së Financave Vendore)

Bashkia Përmet në datën 01.01.2025 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor ***detyrime të prapambetura*** progresive shumën prej 2,648,974 lekë. Bazuar në shpjegimet nga subjekti nën auditim, evidentohet se detyrimi i mësipërm nuk është likuiduar për arsyet e mëposhtme dhe i përbërë nga sa vijon:

✓ Vlera prej 2.346.886 detyrim ndaj FSHU (OSHEE) Bashkia Përmet është në proces gjyqësor sipas kërkesë padisë nr.2545, datë 26.08.2022.

✓ Detyrimi prej 302,088 lekë i kontabilizuar në favor të z.B. Ç. sipas Vendimit nr.3854 datë 28.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është rrëzuar, por ende nuk ka një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Nga auditimi rezulton se, gjatë vitit 2025 në këtë Bashki janë krijuar ***detyrime të reja*** të prapambetura në vlerën + 2,249,095 lekë, nga të cilat janë shlyer - 644,779 lekë brenda vitit 2025. Pra, detyrimet e prapambetura të krijuara gjatë vitit 025 janë <u>+ 1,604,316 lekë</u>.
Si rrjedhojë gjendje të detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2025 është në vlerën <u>4,253,290 lekë</u> (me çelje për 2,648,974 lekë + shtim gjatë vitit 2025 për 1,604,316 lekë).

✓ Detyrimi ndaj subjektit "L" shpk prej 1,604,316 lekë me objekt *"Rikonstruksion i Pallatit të Sportit"* nuk është likuiduar. Konstatohet se, nga Drejtoria e Zhvillimit të Territorit është hartuar një proces verbal i mbajtur në datë 10.11.2025, bërë me dije subjektit me shkresën nr.3801, datë 13.11.2025 për marrje masash të menjëhershme për korrigjim të defekteve të shfaqura në objekt.
Stoku i detyrimit të mbetur më datën 31.12.2025 dhe raportuar në MF elektronikisht, (në bazë të e-mailit të datës 9.02.2026 nga Sektori i Marrëdhënieve Fiskale Ndërqeveritare në MF), dhe rakordon me vlerën e detyrimeve të pasqyruara me dt. 30.01.2026 në sistemin e Thesarit, që i takon periudhës së raportimit 2025.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore:
Gjatë vitit 2025 në Bashkinë Përmet janë protokolluar 3 (tre) vendime gjyqësore sipas tabelës në vijim të materialit, (për kreditorët "H" shpk, "A" sha dhe zj. I A.) të cilat janë vendime gjyqësore të formës së prerë për vitin 2025,dhe nuk janë raportuar në stokun e detyrimeve të prapambetura të vitit 2025 që raportohen në Ministrinë e Financave, për të cilat nga ana e Bashkisë Përmet janë kryer pagesat gjatë vitit 2026. *Me hollësisht,*

Tabela nr. 3 Vendime gjyqësore ku Bashkia është palë debitorë me vendimmarrje të formës së prerë.

Kreditori /pala paditëse	Pala e paditur	Objekti	Shuma e detyrimit	Vendimi Gjyqësor dhe likuidimi	Data e protokollimit në Bashkinë Përmet
H. shpk	*BASHKIA PËRMET*	Permbushje te detyrimit kontraktual	4,533,109	Bazuar ne Vendimin e Gjykatës se Apelit Tiranë nr.**8-86-2025-59), datë 23.01.2025.** Likuiduar me urdhër pagesën **nr.119 date 15.04.2026**	Nr. 406 prot, **dt. 11.02.2025**
A sh.a	*BASHKIA PËRMET*	Përmbushje te detyrimit kontraktual	328,035	Bazuar ne Vendimin e Gjykatës se Apelit Gjirokastër nr.**20-2019-288/131, date 04.04.2019.** Likuidimi me urdhër pagesën **nr.108 date 02.04.2026.**	Nr. 1063 prot **Dt 06.05.2019,**
I. A.	*BASHKIA PËRMET*	Dëmshpërblim për zgjidhjen e marrëdhënies se punës	19,680	Bazuar ne Vendimin e Gjykatës Administrative se Apelit **nr.778 date 12.05.2025.** Likuidimi me urdhër pagesën **nr.107 date 02.04.2026**	Nr 2850 prot **dt. 04.09.2025**
E.S.	*BASHKIA PËRMET*	Dëmshpërblim pre zgjidhjen e marrëdhënies se punës	481,480	Bazuar ne Vendimin e Gjykatës Administrative se Apelit nr. 671 date 24.04.2025 . Likuidimi me urdhër pagesën nr.441 date 22.10.2025	Nr. 1431 prot, Dt 02.05.2025

Burimi: Sektori Juridik, Bashkia Përmet

Konstatim:
1. Nga analiza e llogarive financiare të detyrimeve të prapambetura rezultoi:

✓ Vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Përmet me datën 31.12.2025 është *rritur krahasuar me të dhënat e stokut në çelje të vitit ushtrimor* me datën 01.01.225, për + 1,604,316 lekë, (4,253,290 lekë - 2,648,974 lekë). Pra, detyrimet e prapambetura janë rritur **1.6 herë** krahasuar me gjendjen e detyrimeve në fillim të periudhës ushtrimore 2025.

✓ Referuar dokumentit "Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për tre vitet në vazhdim" (Aneksi nr. 2 i tabelave të vetëvlerësimit financiar për 4-mujorin e tretë të vitit 2024), dërguar në Ministrinë e Financave, rezulton se detyrimet e mbetura deri më datë 31.12.2024 janë planifikuar për t'u shlyer deri më datën 31.12.2025. Nga shqyrtimi i planit të buxhetit vjetor për vitin 2025, rezultoi se Bashkia Përmet ka programuar fonde në buxhet, por nuk ka parashikuar një grafik të detajuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të cilat përbëjnë detyrime të mbartura nga viti 2024.

✓ Shuma e detyrimeve të lidhura me vendimet gjyqësore në fund të v.2025 për Bashkinë Përmet është 302,088 lekë, ku është kontabilizuar detyrimi në favor të z.B. Ç. (sipas Vendimit nr.3854 datë 28.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të cilën nuk ka një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Apelit Tiranë). Rezulton se në shumën e detyrimeve të prapambetura gjithsej, prej **4,253,290 lekë** në datën 31.12.2025, nuk është kontabilizuar shuma prej **4,880,824 lekë,** që lidhet me tre vendime të Gjykatave të Apelit (datë 23.01.2025, datë 04.04.2019 e datë 12.05.2025, të likuiduara në Prill 2026).

Sa më sipër, moskontabilizimi i shumës 4,253,290 lekë në llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm", ka sjellë nënvleftësimin e kësaj llogarie për këtë shumë.

Rrjedhimisht, vlera e detyrimeve të prapambetura (e korrigjuar) arrin **në 9,134,114 lekë**, (shuma 4,253,290 + 4,880,824). Kjo vlerë në raport me shpenzimet vjetore 9,134,114 : 426,705,665 lekë, bën që raporti i stokut të detyrimeve ndaj shpenzimeve vjetore të jetë **2.14 %,** nga **1 %** të raportuar nga ana e kësaj Bashkie në MF.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52 "Kryerja e shpenzimeve", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" pikat 20-22 dhe 27-29; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 107 e 186; Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", "Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" dhe pikat 81, 148 dhe 148/1 "Raportimi i detyrimeve te prapambetura në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

2. Vendime gjyqësore për marrëdhëniet e punës:

Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë Përmet, u konstatua që përgjatë vitit 2025 bashkia ka kryer likuidime për shpenzime gjyqësore në vlerën **501,160 lekë**, për zbatim të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 671(86-2025-852), datë 24.04.2025 me objekt dëmshpërblim page për kreditorin z.E. S. në vlerën 481,480 lekë, dhe vendimit të Gjykatës Administrative se Apelit nr.778, datë 12.05.2025 në vlerën **19,680** lekë për kreditorin zj.I. A., duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe shpenzime pa ekonomicitet në vlerën **501,160 lekë**. Mos analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe mos nxjerrja e përgjegjësive administrative, ndikon negativisht për korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore e në shmangien e uljen e shpenzimeve financiare me kosto negative në buxhet. Vlera prej **501,160 lekë shpenzime sjell kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe janë shpenzime pa ekonomicitet.** Këto veprime janë

në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.*

3.1.4 <u>*Monitorimi i buxhetit dhe raportimi periodik në Këshillin Bashkiak:*</u>

A. *Hartimi i raporteve katërmujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit* **.**Në zbatim të nenit 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 "Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore", si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
a. <u>*Raportimi i zbatimit të buxhetit*</u>***:*** Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Përmet administron raportet 4, 8 dhe 12 mujore të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit për vitin 2025 si vijon:
1. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të parë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me email datë 05.06.2026 (pas konfirmimit nga Prefekti).
2. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të dytë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave me email datë 30.09.2025.
3. Vetëvlerësimi financiar dhe detyrimet e prapambetura i 4-mujorit të tretë 2025 dërguar në Ministrinë e Financave sipas SMBV në datë 23.02.2026.
Rezulton se raportimet janë dërguar në MFE në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare brenda afatit ligjor.
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raportet e Monitorimit të buxhetit të vitit 2025 janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

<u>B. *Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura.*</u> Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë edhe në rrugë elektronike. Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të* ***detyrimeve të prapambetura*** *të qeverisjes së përgjithshme*".
Raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura

- Raportimi i parë me emailin datë 05.06.2025
- Raportimi i dytë me emailin datë 30.09.2025
- Raportimi i tretë në SMBV në datë 23.02.2026 dhe email 09.04.2026.

<u>C. *Raportimi në ministri mbi programi "Emergjencat Civile"*</u> është bërë sipas Udhëzimit Plotësues të MF nr. 2, datë 24.01.2025 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025*", pika 118, ku citohet

118. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat përfitojnë fonde nga programi "Emergjencat Civile" sipas pikave 18,19, 20 dhe 21 të këtij udhëzimi duhet të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit/Drejtorinë e Financave Vendore në fund të çdo tremujori mbi ecurinë e realizimit të shpenzimeve faktike nëpërmjet këtyre fondeve

Raportimi në ministri mbi programi "Emergjencat Civile"


- Shkresa nr.1821/1 datë 23.06.2025 me objekt "Raportim për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, katër mujori i parë i vitit 2025"
- Shkresa nr.3612/1 datë 18.11.2025 me objekt "Raportim për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, katër mujori i dytë i vitit 2025"
- Shkresa nr.291 datë 26.01.2026 me objekt "Raportim për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, katër mujori i tretë i vitit 2025"

Tabela nr. 4, Performanca e treguesve financiarë të Bashkisë. Struktura dhe efikasiteti i shpenzimeve publike të bashkisë për të përmbushur funksionet e veta ligjore.

Emërtimi	2022	2023	2024	2025	Mesatarja 2022-2025
Nr frymësh	19272	18647	18647	18647	18803
Buxheti total	389695472	558569763	544544320	643281018	534022643
Buxheti për frymë (në lekë)	20,221	29,955	29,203	34,498	28,469
Te ardhurat e veta	47,449,632	66,387,350	42,598,132	86,419,738	60,713,713
Te ardhura për fryme	2,462	3,560	2,284	4,635	3,235

Burimi: Bashkia Përmet

Në trajtë grafike të dhënat mbi të ardhurat për frymë dhe buxhetin për frymë të popullsisë në juridiksionin e Bashkisë jepen në vijim: Grafiku nr. 1



Burimi: Bashkia Përmet, përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH-së

Të Ardhurat për frymë

Të dhënat e të ardhurave të veta/frymë për Bashkinë Përmet tregojnë një trend të ndryshueshëm gjatë viteve të fundit. Në vitin 2022, të ardhurat ishin 2,462 lekë/frymë dhe janë rritur në 3,560 lekë/frymë në v.2023, duke shfaqur një përmirësim të indikatorit. Megjithatë, në vitin 2024,ka një rënie në 2,284 lek/frymë. Viti 2025 tregon një vlerë të ardhurash/frymë prej 4,635 lekë/frymë, ose me një rritje mbi mesataren e periudhës prej 3,235 lekë/frymë. Sa më sipër, nga ana e strukturave të Bashkisë së Përmetit është e nevojshme një analizë e thelluar për të kuptuar arsyet e rënies së të ardhurave të veta dhe atyre për frymë në vite të caktuara, si p.sh. në vitin 2022, 2024. Kjo analizë mund të ndihmojë në parashikimin e stabilitetit të ardhshëm financiar të bashkisë. Ecuria e të ardhurave thekson nevojën për planifikim të kujdesshëm dhe menaxhim të qëndrueshëm financiar.

***Konkluzion*:** Nga auditimi i procesit të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit të Bashkisë Përmet për vitin 2025 rezultoi se sistemi buxhetor është funksional, por paraqet dobësi në planifikimin realist të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe në përfshirjen e plotë të funksioneve në programimin buxhetor. Diferenca ndërmjet buxhetit të rishikuar dhe realizimit faktik, veçanërisht niveli 52% i realizimit të investimeve, evidenton se planifikimi dhe rishikimi i buxhetit nuk kanë reflektuar në mënyrë të mjaftueshme burimet reale të financimit dhe kapacitetin për realizimin e objektivave të planifikuara. Megjithëse Bashkia ka kryer procedurat e rakordimit dhe

të raportimit periodik të zbatimit të buxhetit, mekanizmat e monitorimit nuk kanë rezultuar plotësisht efektivë për përshtatjen në kohë të shpenzimeve me realizimin faktik të të ardhurave.
Gjithashtu, janë evidentuar dobësi në menaxhimin, kontabilizimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat në fund të vitit 2025 rezultojnë të rritura krahasuar me fillimin e vitit. Pagesat për vendime gjyqësore dhe mungesa e analizës së shkaqeve të tyre kanë gjeneruar kosto shtesë për buxhetin. Në tërësi, sistemi i buxhetit vlerësohet se funksionon, por kërkon përmirësime në planifikimin e burimeve, monitorimin dhe rishikimin e buxhetit, si dhe në administrimin e detyrimeve të prapambetura, me qëllim rritjen e disiplinës buxhetore, saktësisë së raportimit financiar dhe eficiencës në përdorimin e fondeve publike.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj.A. H., me detyrë Kryetar i Bashkisë Përmet, zj.E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

3.2- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:
Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore:
Struktura organizative e Bashkisë së Përmetit, e zbatuar për vitin 2025 është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.15, datë 15.01.2025, ndryshuar me nr. 269, datë 22.07.2025, ndryshuar me nr.436, datë 20.10.2025 dhe nr. 467, datë 07.11.2025, me objekt "Për disa ndryshime miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Përmet për vitin 2025", në të cilën përfshihet edhe Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesve si pjesë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Bujqësisë (DZHETB), e përbërë nga 12 pozicione pune në strukturë, më konkretisht:
Drejtor; *Sektori Tatime-Taksave, Aseteve dhe Licensave* (STTAL) me 1 Përgjegjës Sektori, dhe 7 specialistë: Nga këto 3 Specialist për Tatimet dhe Taksat, 2 specialiste asetesh dhe 1 administrator shërbimesh; *Sektori për Bujqësi dhe Turizëm* (SBT) me 1 Përgjegjës dhe 3 specialistë, nga këto: 2 Punonjës për Asetet, Turimin dhe 1 për Mjedisin.
Për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar ***Paketa Fiskale*** miratuar me VKB nr. 15, datë 27.11.2024, me objekt "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet për vitin 2025", për të cilën është marrë konfirimimi mbi bazueshmërinë ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastër. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së paketës fiskale për vitin 2025, kryesisht në ndarjen e detyrave, mbi strukturën që bën përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore dhe strukturën që ngarkohet për vjeljen e saj, konstatohet se:

Auditimi i "Regjistrit Elektronik" të Tatimeve dhe Taksave Vendore ndaj subjekteve tatim paguese, që ngarkohen dhe shlyhen nga subjektet:
- Burimi i të dhënave sa i përket kategorisë biznes për llojin e aktivitetit, sipërfaqes së ambienteve ku biznesi ushtron aktivitet, xhiros vjetore etj., në regjistrin elektronik të STT&L-së nuk është i plotë dhe i shoqëruar me dokumentacion shoqërues.
- STTAL çdo fillim viti krijon një regjistër të ri ***elektronik në format Excel*** për administrimin e të dhënave për çdo njësi administrative. Bazuar në regjistrin elektronik që këto njësi administrojnë (veçmas për çdo njësi administrative) STTAL në Zyrat e Taksave pranë NjA Qendër Piskovë, Frashër, Petran, Carshovë, të cilat bëjnë menaxhimin e të dhënave sa i përket regjistrimit /ç'regjistrimit, planifikimit, njoftim detyrimin dhe regjistrimin e arkëtimeve për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë të cilët kanë detyrimin për të paguar taksat dhe tarifat vendore, sipas kategorisë së detyrimeve tatimore, përfshirë përjashtimet apo lehtësimet fiskale për

kategori të caktuara taksapaguesish

Konstatim:

a.- STTAL përmbledh në bazën e saj të të dhënave të Bashkisë, sistemin e evidencave dhe të dhënave përsa i përket regjistrimit /çregjistrimit, planifikimit, njoftim detyrimit dhe regjistrimit të arkëtimeve për abonentët familjarë dhe personat fizikë e juridikë që mbahen nga NJA-të***, pa kryer verifikime mbi saktësinë e të dhënave dhe duke mos e dokumentuar me procesverbal nivelin e mbetur të detyrimeve për tarifat dhe taksat vendore të papaguara sipas kategorisë së detyrimeve tatimore m datën 31.12.2025.***

b.-Për periudhën në auditim ***nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit të mbylljes së regjistrit elektronik vjetor ekzistues dhe arkivim të kopjes së printuar dhe elektronike (CD), përpara krijimit të regjistrit elektronik të vitit pasardhës***. Të dhënat që administrohen nga regjistrin elektronik (informacioni mbi subjektet tatimpagues që popullohen në regjistrin elektronik), shërbejnë për përgatitjen e evidencave të cilat përdoren për raportim (evidenca mbi planifikimin e pritshëm dhe realizimin faktik mbi të ardhurat për taksa/tarifa vendore, evidenca mbi ndjekjen e subjekteve debitore, listat për njoftim bllokimi për subjektet debitore në bankat e nivelit të dytë apo QKB) realizimi në drejtimin e Bashkisë Përmet dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

- Auditimi i "Regjistrin Elektronik" për kategorinë *"Biznes"* dhe *"Familjar",* është vlerësuar i rëndësishëm, për shkak të rëndësisë së veçantë të shërbimit që ofron. Ky regjistër administron të dhëna për kategorinë "Biznes" dhe "Familjar", në nivel lokal. Siguria e informacionit është bërë gjithnjë më e rëndësishme për institucionet e administratës shtetërore që administrojnë të dhëna, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit.

Siguria e informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Bazuar për sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit bazuar në elementët kyç të cilët janë: "*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria".*

Për të minimizuar rrezikun e gabimeve, parregullsive, shkeljeve dhe mos zbulimin e tyre, titullarët duhet të vendosin rregulla që i shpërndajnë tek punonjës të ndryshëm përgjegjësinë e zbatimit të dy, ose më shumë fazave kyçe të një operacioni, procesi, apo aktiviteti.

Përgjegjësitë duhet të ndahen në mënyrë të tillë, që përjashton mundësinë që një punonjës i vetëm të jetë njëherësh përgjegjës për miratimin (marrjen e vendimit), zbatimin, dhe kontrollin, për të garantuar kryerjen e kontrolleve efektive, si dhe për të ruajtur ekuilibrin në zbatimin e një operacioni/transaksioni.

Konstatim: - Nga ana e Bashkisë është miratuar "Rregullorja e brendshme për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit elektronik të tatimpaguesve vendorë të Bashkisë Përmet", miratuar me Vendimin nr.507, datë 26.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë**.** Rregullorja është miratuar në fund të vitit 2025 dhe nuk ka parashikuar aspektet e gjenerimit/printimit dhe arkivimit të të dhënave

periodike e vjetore mbi tatimpaguesit e Bashkisë. Për periudhën në auditim nuk ka një dokumentim, protokollim të momentit mbylljes së regjistrit vjetor ekzistues e depozitim të tij në Zyrën e Protokoll- Arkivës (*version hard copy dhe CD*) dhe krijimit të regjistrit të ri vjetor.
-Procesi i popullimit të Regjistri Elektronik në STT dhe procesi i përpunimit dhe përgatitjes së evidencave kryhet nga të njëjtit përdorues, por nuk ka një dokumentim të veçantë (procesverbal) për kryerjen e këtij procesi për ndarjen e aktiviteteve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar dhe Manualit të MFK.
- Nuk ka përcaktime në rregullore të brendshme apo në rregulloren specifike mbi krijimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit elektronik se si rakordohen të dhënat e këtij regjistri me strukturat e brendshme dhe të jashtme dhe si dokumentohet çdo saktësim apo ndryshim i ndonjë të dhëne (saktësim a përditësim i tij), referuar nenit 6 të kësaj rregulloreje miratuar me Vendimin nr.507, datë 26.11.2025.
Sa më sipër, veprime jo në përputhje me përcaktimet e nenin 5/: iv) të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar përcaktohet se "Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak përcakton: iv) rregullat e raportimit, të dokumentimit e kontrollit të taksave vendore".
- Nuk ka evidenca të cilat vërtetojnë monitorimin e procesit të popullimit të regjistrit elektronik, përpunimin e informacioneve të raporteve të gjeneruara nga ky regjistër në evidencat format excel dhe më pas shkresore për njoftim detyrime drejt tatimpaguesve, raportime midis drejtorive apo drejt titullarit.
- Drejtoritë të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme për subjekte tatimpagues apo individë nuk administrojnë regjistër për menaxhimin e të dhënave mbi taksat dhe tarifat që administron (Sipas strukturës së Paketës Fiskale). Këto drejtori nuk rakordojnë me SSHT-në lidhur me realizimet e të ardhurave që kanë përgjegjësi të menaxhojnë sipas përcaktimeve në paketën fiskale të miratuar me VKB nr. 15, datë 27.11.2024, me objekt "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet për vitin 2025"dhe kërkesat të cilat i drejtohen Bashkisë Përmet për informacion sa i përket gjendjes debitore (detyrimeve ndaj bashkisë lidhur me taksa dhe tarifa vendore) të subjekteve.

Rakordimi midis DZHETB dhe DBFBNJ të Bashkisë Përmet

- Mungon rakordimi analitik periodike e vetor dhe i dokumentuar midis sektorit të tarifave dhe taksave vendore dhe sektorit të kontabilitetit.
Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore përdor për veprimtarinë e saj evidencën e vënë në dispozicion nga DZHETB (STTAL-ja), e cila krijohet nga procesi i përpunimit në formatin Excel i informacionit të grumbulluar në regjistrin elektronik vjetor *(në të cilin nuk ka të dhëna mbi informacionin historik mbi subjektin)* si dhe nga informacioni që paraqesin drejt saj drejtoritë/sektorët të cilat administrojnë taksa dhe tarifa vendore bazuar në paketën fiskale. Procesi i përpunimit bëhet manualisht duke ulur efiçencën, nivelin e cilësisë dhe sigurinë e informacionit të përpunuar.
- Raportet e monitorimit dhe raportet vjetore të hartuara nga ana e DZHETB nuk kanë bashkëlidhur gjurmë dokumentare justifikuese të raporteve të gjeneruara nga regjistri elektronik me formatet e përpunuara nga përdoruesit.
-Nuk ka gjurmë të rakordimeve periodike dhe vjetore midis DZFEBT dhe DBFBNJ, por janë mjaftuar me dërgimin me shkresë zyrtare të nielit të realizimit të të ardhurave vendore sipas kategorive.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 4 pika 26, neni 5, neni 11; Ligjin nr. 139/2015, datë

17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 9, neni 35, neni 41; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, neni 5, pika "ç"; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar nenet 25, 27, 28, 31; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore" nenin 3; Ligjin nr. 2/2017, datë 26.01.2017, "*Për sigurinë kibernetike*" neni 4; Ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010 "*Për bazat e të dhënave shtetërore"* Kreun II "Rregullat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave; Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar" nenet 2, 3, 5, 6, 20, 27, 28; VKM nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores "Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore" i ndryshuar; Vendimin nr. 710, datë 21.08.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", (ndryshuar me VKM nr. 755, datë 26.10.2016); Kreun II, pikën k, të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit", (ndryshuar me VKM nr. 36, datë 24.01.2018; nr. 88, datë 14.02.2018; nr. 448, datë 26.7.2018; nr. 872, datë 24.12.2019); pikën 4, "Kërkesat e sigurisë" shkronja b, të "Rregullores për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike" miratuara nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019; pikën 4, germa "a", të "Rregullores për menaxhimin e log-eve digitale në administratën publike", miratuar me Urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT); Manualin e Auditimit të Brendshëm, të miratuara me Urdhrin e Ministrit të financave nr. 4, datë 26.01.2024, Kreu II, pika 2.4 dhe Kreu III, pika 3.2

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Paketa fiskale e aplikuar nga Bashkia Përmet për periudhën nga data 01.01.2025, deri më 31.12.2025, është miratuar me Vendimin nr. 15, datë 27.11.2024, me objekt "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet për vitin 2025" të Këshillit Bashkiak.
Në këtë dokument janë përcaktuar afatet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit privat dhe familjar. Afati i pagesës është pjesë integrale e paketës fiskale, si një element i rëndësishëm i taksave dhe tarifave vendore dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet gjykimit të Këshillit Bashkiak. Në dokumentin e Paketës Fiskale, në pikën nr. 4 të saj ku trajtohet niveli i taksave dhe tarifave vendore janë përcaktuar afatet e pagesës së tyre, ku thuhet se:

"Afati i pagesës së taksave dhe tarifave vendore për subjektet është data 30 Prill, për popullatën përcaktohet në marrëveshje me agjentin tatimor duke e përpjesëtuar për 9 muaj shumën totale të detyrimeve".

Përcaktimi i afatit të pagesës duhet të jetë i tillë që të garantojë mbledhjen e të ardhurave brenda një kohe të caktuar (kryesisht brenda 6-mujorit të parë të vitit) me qëllim që me këto të ardhura të sigurohet financimi i shpenzimet të miratuara në planin vjetor të buxhetit. Sa më sipër,në pajtueshmëri me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, germa "c", ku përcaktohet që: "Përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale".

Tabela nr. .5, Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Përmet për vitin 2025 *Në 000/lekë*

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	B	4	5	6	7	8	9
I	***Te ardhura nga Tatimet***	***3341***	***5204***	***151***	***4500***	***6048***	***133.4***
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	0	154			44	
2	Tatim mbi te ardhurat personale	3341	5050	151	4500	6004	133.4

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2024			Viti 2025		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	B	4	5	6	7	8	9
II	***Te ardhura nga Taksat***	***21142***	***19516***	***93***	***30125***	***30592***	***101.5***
2	Taksa mbi B. Vogël	0	0				
3	Taksa e Pasurisë, ndërtese	9880	7418	75	***12000***	***10720***	***89***
4	Taksa mbi token Bujqësore	1825	1980	108	2025	2611	129
5	Takse mbi regj e Automjete	4637	6282	135	6000	6965	116
6	Taksa e ndikimi te nd. mbi infrastrukturë	3200	1331	42	7000	8112	116
7	Takse Tabele	300	301	100	400	419	105
8	Takse hoteli	110	289	263	500	307	61
9	Takse Parkimi						
10	Takse për hapësira publike						
11	Takse reklame						
12	Takse Trualli	940	1501	160	1700	1346	79
13	Takse e kalimit te drejtës se pronësisë	250	415	166	500	112	22
III	***Te ardhura nga Tarifat***	***24700***	***24354***	*98.6*	***28600***	***31641***	**110.6**
14	Tarife Pastrimi	13220	14284	108	13000	15822	122
15	Tarifë shërbim te tjera publike (gjelbërim)	1970	1955	99	2000	2354	118
16	Tarife leje transport.	1800	1094	61	1800	1836	102
17	Tarife vend banor/gj CIVILE						
18	Tarife urbanistike	1000	1112	111	1500	4214	281
19	Tarife regj biznes i Ri						
20	Tarife ndriçimi rrugor	4550	4037	89	7000	4358	62
21	Te ardhura te tjera						91.5
22	Tarife certifikimi mishi						
23	Tarife parkimi	250	60	24	500	80	16
24	Tarife për hapësira publike	850	1178	139	1200	1513	126
25	Tarifa lende drusore	810	589	73	1100	1405	128
26	Tarifa MNZ	250	45	18	500	59	12
IV	***Te ardhura te tjera***	***8970***	***8852***		***11640***	***10553***	***90.6***
21	Qira trualli	5370	2818	52	6540	4862	74
22	Shitje Pas e& privatizim banese						
23	Qira kullote	1230	1130	92	**2500**	**1223**	**49**
24	Tarifë uji i pijshëm				200	177	
25	Te ardhura tenderë						
26	Gjoba. Sekuestrime					1079	
27	Takse Vule					1246	
28	Qera ndërtese						
29	Dhurata, sponsoi & Garanci.		2423				
30	Te ardhura te tjera	2370	2481	104.7	2400	1966	73.8
	GJITHSEJ (I+II+II+ IV)	**58,153**	**57,926**	**99.6%**	**74,865**	**78,834**	**105.3%**

Burimi: DZHETB Bashkia Përmet

Për vitin 2025, planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është në vlerën 74,865 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 78,834 mijë lekë, ose 103,5 %, me një diferencë në tejkalim të treguesit të realizimi kundrejt planifikimit të të ardhurave buxhetore vendore në vlerën **+ 3,969 mijë lekë.** Kjo situatë paraqet një ecuri pozitive të financave vendore dhe një rritje të kapaciteteve fiskale të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në formë të përmbledhur, të ardhurat nga tatimet janë realizuar 133,4%, të ardhurat nga taksat realizuar 101,5%, të ardhurat nga tarifat janë realizuar 110.6% dhe të ardhurat e tjera 90.6%:


Tabela nr. 6 *në 000/lekë*


Grupimi	Plan Vjetor 2025	Realizimi Vjetor 2025	Niveli i realizimit (%)
Të ardhura nga tatimet	4,500	6,048	133.4
Të ardhura nga Taksat	30,125	30,592	101.5
Të ardhura nga Tarifat	28,600	31,641	110.6
Të ardhura të tjera	11640	10553	90.6
Gjithsej	**74,865**	**78,834**	**105.3**

Burimi: Bashkia Përmet, Raporti Vjetor i monitorimit

Në mënyrë grafike, referuar Raportit Vjetor të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Përmet, (raport i miratuar me VKB nr.9, datë 24.02.2026), niveli i realizimit të tët ardhurave gjithsej kundrejt planit 2025 paraqitet më poshtë:

Grafiku nr.2 Krahasimi i të ardhurave gjithsej v205 (plan /fakt) dhe v.2025 ndaj v.2024





Burimi: Bashkia Përmet, Raporti Vjetor i monitorimit

a. Analiza e përgjithshme e të ardhurave. *Në 000/lekë*

Përshkrimi	**Viti 2024 Fakt**	**Viti 2025 Fakt**	**Ndryshimi**
Të ardhura nga tatimet	5,204	6,048	+16.2%
Të ardhura nga taksat	19,516	30,592	+56.8%
Të ardhura nga tarifat	24,354	31,641	+29.9%
Të ardhura të tjera	8,852	10,553	+19.2%
Gjithsej	**57,926**	**78,834**	**+36.1%**

Burimi: Bashkia Përmet, Raporti Vjetor i monitorimit

Në total, të ardhurat vendore të Bashkisë Përmet gjatë vitit 2025 janë realizuar në masën 78,834 mijë lekë, kundrejt 57,926 mijë lekë në vitin 2024, ose me një rritje prej +36.1%. Realizimi i planit për vitin 2025 rezulton në masën 105.3% dhe është tregues i performancës së mirë fiskale nga përmirësimi i nivelit të arkëtimit.

b.Analiza e të ardhurave vendore sipas kategorive.

I. Të ardhura nga tatimet

Të ardhurat nga tatimet në v.2025 janë realizuar në vlerën 6,048 mijë lekë ose 133.4% e planit vjetor. Krahasuar me vitin 2024, këto të ardhura janë rritur me 16.2%, (nga llogaritja 6048/5204), ku kontributin kryesor e ka dhënë zëri tatim mbi të ardhurat personale, i realizuar në vlerën 6,004 mijë lekë. Kjo rritje lidhet me rritjen e numrit të të punësuarve, formalizimin më të mirë të pagesave dhe përmirësimin e administrimit fiskal.

II. Të ardhura nga taksat

Të ardhurat nga taksat rezultuan 30,592 mijë lekë ose 101.5% e planit, për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 30,125 mijë lekë dhe është realizuar 30,592 mijë lekë ose 101.5 % e vlerës së planifikimit, me një rritje prej 56.8% krahasuar me vitin 2024.

Analiza e treguesve kryesorë:

Taksa mbi pasurinë (ndërtesa): për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 12,000 mijë lekë dhe është realizuar 10,720 mijë lekë ose 89% e vlerës së planifikimit, Krahasuar me v.2024 paraqitet

një rritje +44.5% ose me (+) 3,302 mijë lekë më shumëse në vitin 2024. Pra, megjithëse plani nuk është realizuar plotësisht, kjo taksë ka shënuar rritje të ndjeshme krahasuar me vitin paraardhës, duke reflektuar zgjerimin e bazës së tatimpaguesve dhe përmirësimin e arkëtimeve.
Taksa mbi tokën bujqësore: për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 2,025 mijë lekë dhe është realizuar 2,611 mijë lekë ose 129% e vlerës së planifikimit, ose më shumë se në vitin 2024 prej (+) 31.9%;
Taksa mbi regjistrimin e automjeteve: për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 6,000 mijë lekë dhe është realizuar 6,965 mijë lekë ose 116% e vlerës së planifikimit, ose krahasuar me vitin 2024 me një rritje prej (+)10.9%; Analiza e këtij treguesi evidenton se ai vijon të mbetet një ndër burimet më të qëndrueshme të të ardhurave vendore.
Taksa e ndikimit në infrastrukturë: për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 7,000 mijë lekë dhe është realizuar 8,112 mijë lekë ose 116% e vlerës së planifikimit, me një rritje prej (+) 6,781 mijë lekë më shumëse në vitin 2024 ose prej 6 herë. Kjo është rritja më e lartë e evindentuar nga auditimi ndër të gjitha taksat dhe lidhet me zhvillimin e aktivitetit ndërtimor gjatë vitit 2025.
Taksa e hotelit për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 500 mijë lekë dhe është realizuar 307 mijë lekë ose 61% e vlerës së planifikimit, me (-) 193 mijë lekë më pak se plani i miratuar nga KB, por më shumë se në vitin 2024 ose prej (+)18 mijë lekë, ose + 6%. Megjithëse niveli i realizimit të këtij treguesi mbetet i ulët kundrejt planit, sektori paraqet potencial zhvillimi për periudhat në vijim në këtë Bashki.
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë: për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 500 mijë lekë dhe është realizuar 112 mijë lekë ose 22% e vlerës së planifikimit, me (-) 388 mijë lekë më pak se plani dhe 303 mijë më pak se në vitin 2024 . Ky tregues ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar uljen e transaksioneve të pronësisë gjatë vitit.

III. Të ardhura nga tarifat

Tarifat vendore u realizuan në masën mijë lekë ose 110.6% të planit. Krahasuar me vitin 2024, të ardhurat nga tarifat u rritën me 29.9%.
Treguesit kryesorë
Tarifa e pastrimit për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 13,000 mijë lekë dhe është realizuar 15,822 mijë lekë ose 122% e vlerës së planifikimit, me (+) 2,822 mijë lekë, si dhe më shumë se në vitin 2024 prej (+) 10.8%;
Tarifa urbanistike për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 1,500 mijë lekë dhe është realizuar 4,214 mijë lekë ose 281 % e vlerës së planifikimit, me (+) 2,714 mijë lekë, si dhe më shumë se në vitin 2024 ose prej (+) 279 %. Rritja shumë e lartë lidhet me shtimin e aplikimeve dhe lejeve në sektorin e ndërtimit.
Tarifa e ndriçimit rrugor për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 7,000 mijë lekë dhe është realizuar 4,358 mijë lekë ose 62 % e vlerës së planifikimit, me (-) 2,642 mijë lekë, si dhe më shumë se në vitin 2024 ose prej (+)321 mijë lekë. Ky tregues paraqet nivel të ulët realizimi krahasuar me planifikimin.
Tarifa për hapësira publike për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 1,200 mijë lekë dhe është realizuar 1,513 mijë lekë ose 126 % e vlerës së planifikimit, me (+) 313 mijë lekë më shumë, si dhe se në vitin 2024 ose prej (+) 335 mijë lekë. Treguesi paraqet rritje të kënaqshme dhe reflektim të përdorimit më të madh të hapësirave publike.
Tarifa e lëndës drusore për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 1,100 mijë lekë dhe është realizuar 1,405 mijë lekë ose 128 % e vlerës së planifikimit, me (+) 305 mijë lekë më shumë, si dhe në vitin 2024 ose prej (+)816 mijë lekë.

Tarifa MNZ, realizimi është 59 mijë lekë nga 500 mijë lekë të programuara, ose niveli i realizimit të planit është 12%. Ky tregues mbetet shumë poshtë planifikimit.

IV. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera u realizuan në masën 10,553 mijë lekë ose 90.6% të planit. Më hollësisht,
Qira trualli: për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 6,540 mijë lekë dhe është realizuar 4,862 mijë lekë ose 74% e vlerës së planifikimit, me (-) 1,687 mijë lekë më pak, por krahasuar me vitin 2024 me nj rritje prej (+) 2,044 mijë lekë. Pra, megjithëse ka përmirësim ndaj vitit 2024, niveli i realizimit mbetet nën treguesin e planifikuar.
Qira kullote: për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 2,500 mijë lekë dhe është realizuar 1,223 mijë lekë ose 73.8% e vlerës së planifikimit, me (-) 1,277 mijë lekë më pak se plani vjetor 2025, por, më shumë se realizimi faktik i këtij zëri në vitin 2024 ose prej (+) 93 mijë lekë;
*Të ardhura të tjera***:** për vitin 2025 është parashikuar në vlerën 2,400 mijë lekë dhe është realizuar 1,966 mijë lekë ose 82 % e vlerës së planifikimit, me (-) 434 mijë lekë më pak, si dhe (-) 515 mijë lekë më pak se në vitin 2024.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura ***me tejkalim paraqiten*** zërat fiskal si më poshtë:

a. "Taksa mbi regjistrimin e automjeteve" është planifikuar në vlerën 6,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 6,965,000 lekë ose realizuar në masën 116%.
b. "Taksa mbi token Bujqësore" është planifikuar në vlerën 2,025,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 2611,000 lekë ose realizuar në masën 129%.
c. "Taksa e ndikimit në infrastrukturë" është planifikuar në vlerën 7,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 8,112,000 lekë ose realizuar në masën 116%.
d. "Taksa e tabelës" është planifikuar në vlerën 400,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 41,000 lekë ose realizuar në masën 105%, etj.

Nga ana tjetër, disa prej zërave fiskal ***nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm*** të të ardhurave si më poshtë:

a. "Taksa e pasurisë, ndërtesa" është planifikuar në vlerën 12,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,720,000 lekë ose realizuar në masën 89%.
b. "Tarifë hoteli" është planifikuar në vlerën 500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 307,000 lekë ose realizuar në masën 61%.
c. "Taksë e kalimit të drejtës së pronësisë" është planifikuar në vlerën 500 ,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 112,000 lekë ose realizuar në masën 22 %.
d. "Taksë trualli" është planifikuar në vlerën 1,700,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 1,346,000 lekë ose realizuar në masën 79%.

Nga analiza e trajtuar më sipër, për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulëta dhe për disa zëra realizimi *paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave, ka rezerva në planifikim e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së plotë të situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në mospasyqrimin e* saktë pjesës takuese në realizimin *e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.*
Nga STTL-ja nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.
Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Përmet që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo

tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut.
Këto veprime janë në mospërputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika "c", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave" Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.

3..Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit në fuqi për vitin 2025 nga Bashkia Përmet miratuar me Vendimin nr.103/1, datë11.10.2024, të Kryetarit të Bashkisë me objekt "Për miratimin e rregullores *"Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Përmet dhe Njësive Administrative*", tek detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Tatimeve dhe Taksave në nenin 25, të Rregullores, *është përcaktuar detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimore dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta:*

Çdo muaj miraton akt-rakordimet e paraqitura nga Agjenti tatimor sipas informacionit të dhënë nga të gjitha strukturat e Bashkisë apo subjektet e tjera që luajnë rolin e agjentit tatimor për taksat dhe tarifat vendore, sipas ligjit apo vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Të ardhurat nga Agjentët Tatimorë (ASHK Gjirokastër) për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastër derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Përmet dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Përmet duke kuadruar edhe me akt-rakordimin vjetor.
Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga Agjentët Tatimorë paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Tabela nr. *7* *Në Lekë*

Agjenti Tatimor	**Lloji I Taksës**	**31.12.2024**	**31.12.2025**
Degën e Shfrytëzimit të Automjeteve	Taksë për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve	6,282,438	6,964,859
Drejtoria Rajonale të Tatimeve	Tatim i thjeshtuar fitimi	153,588	38,362
Drejtorinë Rajonale të ASHK-së,		97,250	111,653
Drejtoria Rajonale të Tatimeve	Renta minerare	-	43,538
SHRUKGJ	Taksa vendore popullata, biznesi		15,842,763
Total		**6,533,276**	**23,001,175**

Burimi: DZHETB Bashkia Përmet

Konstatohet se mungon një akt që ngarkon një person në strukturën e STTAL mbi caktimin e një personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

1. ***Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura***, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Gjirokastër, për llogari të Bashkisë Përmet. Akt

rakordimi me DSHTRR realizohet vetëm nëpërmjet Degës së Thesarit Përmet, referuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", të ndryshuar dhe në mbështetje të germës "b", të pikës 2, në nenin 25 "*Të ardhurat nga taksat e ndara*" të ligjit nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.
Më konkretisht nga auditimi rezulton: Për vitin 2025 ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastër janë mbajtur 2 korrespondenca *shkresore (nuk janë akt-rakordime mujore*), si më poshtë: Shkresa nr. 6812/1 prot, datë 26.11.2025 nga DRSHTRR Gjirokastër (në përgjigje të kërkesës së Bashkisë Përmet me nr.3764 datë 10.11.2025) ku vlera e taksave gjithsej janë 20,658,720 lekë. Me shkresën e Bashkisë Përmet me nr. 440, datë 02.02.2026 është kërkuar nga DRSHTRR informacion mbi pagesën e taksës së regjistrimit të automjeteve për përudhen Janar-Dhjetor 2025, rezultuar ne shumen 6,514,782 lekë (periudha 21.11.2025 deri me 31.12.2025).

2. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Gjirokastër". Në zbatim të ligjit nr. 181, datë 28.12.2016 "*Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 "*Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël*" Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qëndrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Në Bashkinë Përmet rakordimet kryhen nga Sektori i Financës dhe Buxhetit/DFBBNJ. Me ndryshimet në kuadrin ligjor Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk vilet, shfuqizuar me Ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023. (*Kreu III "Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël", i Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar kapitulli me ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013, shfuqizuar me ligjin nr. 29/2023, datë 30.3.2023).*
Më konkretisht nga auditimi rezulton: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkresa nr.110, dt. 14.01.2026 mbajtur akt rakordimi për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogël, (pagesat dhjetor 2024-dhjetor 2025), ku aktet e rakordimit janë nënshkruar rregullisht për çdo muaj ndërmjet DRT Gjirokastër dhe Bashkisë Përmet.

3. ***Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme***, dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" (ZVRPP) tani ASHK Vendore. ASHK Vendore ka bashkëpunuar me STTAL/ Bashkia Përmet, lidhur me dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Përmet me vlerën e përllogaritur. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" të ndryshuar, Drejtoritë Vendore të ASHK-së, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë komision administrimi 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.
Drejtoria Vendore e ASHK Gjirokastër, (shkresa nr.3613/1, dt. 23.11.2025 (për kërkesën e

Bashkisë Përmet me nr.3071, datë 22.09.2025), ku konfirmohet pagesa e vlerës se taksës së ndikimit në infrastrukturë, ku pjesa takuese 97 % e Bashkinë Përmet në shumën 19,584.3 lekë.
Më konkretisht nga auditimi rezulton:
Nga auditimi *rezulton se* deri në 31.12.2025 rakordimet me DPSHTRR dhe ASHK Vendore, *nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE.*

4. *Të ardhurat nga renta minerare* mblidhet nga Agjenti Tatimor DP Doganave dhe DP Tatimeve, referuar përcaktimeve të ligjit Nr.9975, datë 28.7.2008 "për taksat kombëtare" i ndryshuar:

> *Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.*

Grupi i auditimit verifikoi në Regjistrin e Lejeve Minerare të Shfrytëzimit (aktive) të administruara nga AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Nayrore)[3], dhe *rezultoi se* janë dhënë leje shfrytëzimi minerar në territorin e Bashkisë Përmet si më poshtë vijon:
Tabela nr.8

Nr. leje	Data QKR	Emri Subjektit	Nipt-i	bashkia	Vendburimi	Lloji i minerarit	admin	Sip /km²	Statusi 31.12.2025
1127/1	08.01.2008	C.F.F. shpk	K.....I	Përmet	Objekti Lipe	Ranor pllakor	I.P.	0.306	Revokuar 06.06.2024
1470/1	20.05.2010	R. shpk	J.....E	Përmet	Pranë fshatit Lipa, komuna Petran	Gur Gëlqeror	V.G.	0.015	AKTIV
1491/1	18.08.2010	F. shpk	K.....M	Përmet	Dhembel, Kelcyre, Përmet (pranë ish fabrikës se rrushit)	Gëlqeror pllakor	T.M.	0.0705	AKTIV
1607	18.01.2013	K. shpk	J.....I	Përmet	Përroi i Shën Gjonit, Mbrezhdan, Permet	Ranor silicor	A.K.	0.0096	AKTIV
1710	30.05.2014	F.shpk	K.....M	Përmet	Objekti Argova	Ranor Silicor	T.M.	0.1	AKTIV
1960	16.01.2024	B.C.shpk	L.....P	Përmet	Objekti Radovicka	Gëlqeror	I. M.	0.989	AKTIV

Burimi: AKBN, Revzona dt. 31.12.2025. Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi *rezulton* se:
- Në territorin e Bashkisë Përmet janë dhënë 6 (gjashtë) leje minerare, nga të cilat, sipas verifikimeve të grupit të auditimit, 5 (pesë) prej tyre janë aktive deri më datën 31.12.2025.
- Nga Bashkia Përmet ***rezulton*** se nuk bëhen rakordimet mujore për vjeljen e rentës minerare me DPD dhe DPT, por informacioni mbi arkëtimet e saj merret nëpërmjet Degës së Thesarit.
-Për vitin 2025 nuk ka përfituar pjesën takuese të të ardhura nga renta minerare*, (fragment nga Raporti vjetor i monitormit të të ardhurave, hartuar nga DZHEBT/Bashkia Përmet):*

3 http://www.akbn.gov.al

3	Taksa të ndara	13,090,324	11,000,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	121,538	500,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	6,964,859	6,000,000
c.	Renta minerare		
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	6,003,927	4,500,000
e	Të tjera		

Burimi: Bashkia Përmet.

Nga ana tjetër, ndryshe nga sa raportohet më sipër, referuar përgjigjeve të pyetësorit të dërguar nga e KLSH, DZHETB konfirmon se niveli i të ardhurave nga renta është **43,538 lekë,**
Janë nisur shkresat për të gjithë agjentët tatimor sipas formatit të miratuar nga MF dhe janë mbyllur rakordimet vjetore për vitin 2025. (Tabela nr. 9):

Agjenti Tatimor	Lloji I Taksës	31.12.2024	31.12.2025
Degën e Shfrytëzimit të Automjeteve	Taksë për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve	6,282,438	6,964,859
Drejtoria Rajonale të Tatimeve	Tatim i thjeshtuar fitimi	153,588	38,362
Drejtorinë Rajonale të ASHK-së,		97,250	111,653
Drejtoria Rajonale të Tatimeve	**Renta minerare**	-	**43,538**
SHRUKGJ	Taksa vendore popullata, biznesi		15,842,763

Më konkretisht nga auditimi rezulton:
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokastër, (shkresa nr.240/1, dt. 10.02.2026 (për kërkesën e Bashkisë Përmet me nr.441 datë 02.02.2026), është dërguar lista e subjekteve që kanë paguar rentën minerare Janar-Dhjetor 2025 në shumën gjithsej **870,762 lekë**, përkatësisht ndarë sipas subjekteve që kanë kryer pagesën e rentës: R.Shpk për 63,648 lekë; Subjekti A. në shumën 334,380 lekë; K. Shpk. në shumën 121,541 lekë, si dhe subjekti F. Shpk. për shumën 351,193 lekë. *Nga ana tjetër*, **Drejtoria e Përgjithshme Doganave** ka kthyer përgjigje me shkresën nr.19746/2, dt. 03.10.2025 (për kërkesën e Bashkisë Përmet me nr.3069 datë 22.09.2025), duke dërguar listën e pagesave te rentës për vitin 2025 për subjektet që kanë leje minerare dhe kanë paguar rentën, por pa përcaktuar territorin se ku ato subjekte zhvillojnë veprimtarinë e tyre. **Drejtoria e Përgjithshme Doganave/ Dega Doganore Tre Urat Përmet**, (shkresa nr.278, dt. 05.06.2025, (për kërkesën e Bashkisë Përmet me nr. 1623 datë 26.05.2025), ku konfirmohet se operatori që paguan rentën minerare në procedurë eksporti në këtë degë doganore është "F" me Nipt K.....M.
Konstatim:
Referuar të dhënave të regjistrimeve në sistemin RevZonë të AKBN dhe shkresave të dërguara nga DPD dhe DPT, nga auditimi rezulton se për vitin 2025 këto subjekte kanë pageuar rentën minerare, kurse Bashkia Përmet nuk ka përfituar pjesën takuese sipas ligjit.

5. Për ***vjeljen e detyrimeve të familjarëve*** (taksa e truallit, të ndërtesës, pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksa e tarifa vendore për NJA-të sipas Paketës Fiskale) konstatohet se Bashkia Përmet *ka lidhur marrëveshje* me SHRUK-sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor, në zbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" të ndryshuar. Konkretisht, është lidhur "Marrëveshja për kryerjen e shërbimit të arkëtimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore", me nr.215, datë 23.01.2025 Të Bashkisë Përmet dhe me nr. 697, datë 28.01.2025 të SHRUK Gjirokastër sha. Referuar pikës nr.3 të kreut "Detyrime të përbashkëta të palëve", SHRUK në cilësinë e agjentit tatimor, detyrohet që brenda dt. 10 të muajit pasardhës, të depozitojë në llogarinë e Bashkisë Përmet shumën e arkëtuar gjatë muajit.

4.Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2025

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave dhe detyrimet, viti 2025

Gjatë vitit 2025 kanë ushtruar aktivitetin e tyre gjithsej 542 subjekte, të cilat kategorizohen sipas tabelës së mëposhtme në Biznes i vogël, i vogël me TVSh, i madhe dhe institucionet. Situata e vjeljes së të ardhurave dhe krijimi i borxhit tatimor për vitin 2025 paraqitet si më poshtë;
(Tabela nr. 10)

Nr.	Lloji i Biznesit	Plani i periudhës	Fakti i periudhës	Debia	%
1	Biznes i vogël	428	361	67	84.3
2	Biznes i vogël me TVSh	21	19	2	90.5
3	Biznes i madh	72	56	16	77.8
4	Institucionet	21	21	0	100.0
	Total (numër)	**542**	**457**	**85**	**84.3**

Analizuar sipas nivelit të detyrimeve dhe debisë që paraqitet në fund të vitit 2025, rezulton:

Në 000/leke

Nr.	Lloji i Biznesit	Plani i periudhës	Fakti i periudhës	Debia	kamata	%
1	Biznes i vogël	10563334	9078751	1484583	217290	85.9
2	Biznes i vogël me TVSh	1417514	1332514	85000	13005	94.0
3	Biznes i madh	8529367	7093792	1435575	197290	83.2
4	Institucionet	2003592	2003592	0	0	100
	Total (vlerë)	**22,513,807**	**19,508,649**	**3,005,158**	**427,585**	**86.6**

Sa më sipër, debia e detyrimeve zë 13.4% të planifikimit të periudhës vjetore.

Situata e lëvizjes se subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Përmet bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë:
Tabela nr.11

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël					
		2024	366	78	26	418
		2025	418	39	9	449
2	Biznesi Madh					
		2024	70	1	3	68
		2025	68	7	4	72
(1+2)	**Gjithsej**					
		2024	436	79	29	486
		2025	**486**	**46**	**13**	**519**

Burimi: Bashkia Përmet

- ✓ Nga auditimi konstatohet se, deri më datë 31.12.2025, për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë 85 subjekte si biznes i vogël dhe biznes i madh, në vlerën 427,585 mijë lekë, nga 521 subjekte BM dhe BV të regjistruar.
- ✓ Përgjatë vitit 2025 vlerës së detyrimeve të mbartura për taksa e tarifa vendore më datë 31.12.2024 prej 30,450,900 lekë i janë shtuar debitorë në 3,432,894 lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 27,910,524 lekë. Gjendja debitore më datë 31.12.2025, është në vlerën 31,343,418, lekë e cila përbën të ardhura të munguara për Buxhetin e Bashkisë Përmet, ku niveli i dhe niveli i detyrimeve në fund të v.2025 është më i lartë për shumën +892,518 më shumë se niveli i detyrimeve se data 31.12.2024

Tabela nr. 12, Të dhënat e detyrimeve të biznesit 2024 dhe 2025:

Lekë

Nr.	Detyrimet progresive të subjekteve biznes i vogël dhe biznes i madh deri më datën 31.12.2025					
	Emërtimi i debitorëve	Lloji i Detyrimeve	Detyrimet Progresiv 31.12.2024	Pakësime 2025	Shtesa 2025	Progresivi 31.12.2025
1.	Biznes i madh	Taksa dhe tarifa vendore	**6,826,273**	**0**	**502,162**	**7,328,433**
2.	Biznes i vogël	Taksa dhe tarifa vendore	**23,624627**	**2,540,375**	**2,930,732**	**24,014,985**
Totali			**30,450,900**	**27,910,524**	**3,432,894**	**31,343,418**

Burimi: Bashkia Përmet

Detyrimet e kategorisë Popullata 2025.

Në lidhje me kategorinë e *debitorëve familjarë të regjistruara si tatimpagues* në territorin e Bashkisë Përmet për vitin 2025 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme dhe ka këtë trend pagesash dhe detyrimesh për taksat dhe tarifat vendore, si në tabelën e përfshirë ne anekse të raportit.

Sa më sipër, vlera e detyrimeve të *debitorëve familjarë për vitin 2025* zë 11.6 % te planifikimit vjetor.

Meqenëse taksat dhe tarifat vendore arkëtohen nga SHRUK Sha, për shkak të mënyrën së mbledhjes së tyre në grup, nga ana e UK sha dhe specialistëve të taksave akt rakordimi mujor bëhet po në grup dhe jo i klasifikuar sipas llojit të taksës që paguhet nga abonentët në sportelet e UK sha.

Konstatim: Nga auditimi i borxheve dhe detyrimeve vjetore për taksat dhe tatimet vjetore në Bashkinë Përmet për vitin 2025 rezultoi se:

- Numrin më të lartë ***të abonentëve*** e ka qyteti Përmet me 2,830 taksapagues në vlerën vjetore të detyrimit 10,243,666 lekë dhe numrin më të vogël të taksapaguesve e ka NJA Frashër me 66 familje dhe për vlerën vjetore të detyrimit 213,739 lekë.
  Numrin më të lartë ***të debitorëve*** e ka NJA Petran me 731 abonentë familjarë , në vlerën e debisë 1,389,714 lekë ku vetëm 48 % e numrit të familjeve kanë likuiduar taksat vendore; si dhe numrin më të vogël të debitorëve e ka NJA Frashër me 15 familje në vlerën e debisë 36,034 lekë.
- Nuk është kontabilizuar Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" vlera totale prej **2,054,221 lekë e 1,486 debitorëve familjarë,** në Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025. Si pasojë e vonesës në rakordimin e detyrimeve midis Bashkisë Përmet dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër për vjeljen e detyrimeve të familjarëve të vitit 2025, (akt rakordimi nr. 498, datë 04.03.2026 mbi detyrimet dhe likuidimet e periudhës Janar-dhjetor 20250), bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë, nuk janë pasqyruar në llogaridhënie vjetore te vitit 2025 detyrimet e popullatës në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm', në shumën 2,054,221 lekë

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (Kreu VII "Kontabiliteti i sistemit buxhetor"); Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025",* si dhe dispozita të tjera rregulluese e urdhëruese të lëshuara nga ana e Ministrisë së Financave.

Konstatim:

- Për vitin 2025 ndërmjet STTL-së Bashkisë Përmet dhe ASHK, Drejtoria Vendore Gjirokastër dhe DR Doganave nuk janë mbajtur akt-rakordime mujore. Me Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastër është mbajtur vetëm një procedurë e mbledhjes sete dhënave për pjesën e taksave të Bashkisë Përmet.

Për sa trajtuar më sipër Bashkia Përmet i referohet vetëm vlerave të arkëtuara nga agjentët tatimorë sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit Gjirokastër por nuk ka një bazë të dhënash për detyrimin e plotë që duhet të arkëtojnë agjentët tatimorë dhe vlerën e pa arkëtuar prej tyre.

Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë Bashkia Përmet duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për aplikimin e gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë, me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore", neni 117 "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave".

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese:

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifat vendore.

Paketa Fiskale e Bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.,.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Janë dërguar nga ana e DZHETB Njoftimet dhe Rinjoftimet për subjektet debitore, respektivisht me shkresat si më poshtë:

1- *Shkresa nr.532,datë 25.02.2025, «Njoftime për subjektet që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Përmet».*
2- *Shkresa nr.1641,datë 26.05.2025,"Rinjoftime për mospagesën e detyrimeve vendore".*
3- *Shkresa nr.2807,datë 02.09.2025 «Njoftim për nisjen e procedurave për vjeljen e detyrimeve me forcë».*
4- *Njëkohësisht është marrë vendim nga Këshilli i Bashkisë që debia e vitit 2025 të mblidhet me Agjentin sha Ujësjellës për të gjithë ata subjekte që kanë kontrata me SHRUK Gjirokastër sha VKB nr.77,datë 23.09.2025).*

Këto veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Kreu XI "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara", nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore".

Sipas të dhënave të administruara nga Bashkia Përmet, **borxhi i vitit 2025 është rritur për popullatën në vlerën 3,058,911 lekë**, kjo e arsyetuara nga ana e Bashkisë Përmet me arsye lëvizjes emigruese të popullsie, fakt që ka bërë të mundur që të evidentohet një numër jo i vogël i banorëve jo rezident.

- ***Kontratat për tokën bujqësore janë të pa mbledhura gjatë vitit 2025 në vlerën 131,503 lekë***

Vlen të përmendet që pagesat që janë raportuar si debitore për vitin 2025, janë likuiduar në fillim të viti 2026 si më poshtë:

A. D.	paguar në datë 03.02.2026	11,607
K. M.	paguar në datë 07.01.2026	69,836

Nuk janë llogaritur detyrim për kamat vonesë për vitin 2025, gjë që mbetet detyrë për administratën e Bashkisë Përmet të përllogaritet në faturën e vitit 2026.

- ***Asetet e dhëna me qira***

Borxhi i krijuar për asetet e dhëna me qira për vitin 2025 është në vlerën 3,799,222 lekë.
Gjatë vitit 2026 ka likuiduar subjekti si më poshtë:

L. K.	paguar në datë 04.02.2026	80,822
L. K.	paguar në datë 04.02.2026	3,412

Mbetet pa likuiduar subjekti "K "Shpk ,në vlerën 3,694,988 lekë,me të cilën Bashkia Përmet është në proces gjyqësor.

- ***Detyrimet e Sha Ujësjellës Gjirokastër***, janë të kontabilizuara në bilanc në vlerën 26,492,937 lekë, debi për taksat dhe tarifat e popullatës të vjela nga sha Ujësjellësi Përmet, të pa derdhura në Bashki.

Nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik ka patur komunikim shkresor të vijueshëm për vjeljen e këtij borxhi nga Sha Ujësjellësi Gjirokastër, borxh ky i krijuar para vitit 2023.
Janë dërguar disa shkresa për ndarje të detyrimit me këste për një periudhë 3 vjeçare sipas Programeve Afatmesme dhe sipas shkresës nr.559/1,datë 08.04.2026 sha Ujësjellës Gjirokastër është dakortësuar me Bashkinë Përmet për shlyerjen me këste 3- vjeçare të gjithë shumës së detyrimit. Gjatë periudhës janë mbajtur këto korrespondenca shkresore midis Bashkisë Përmet dhe SHRUK Gjirokastër:

- ✓ Me shkresën nr.290/1,datë 12.02.2025 i është kërkuar Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve (SHRUK) Gjirokastër dhe për dijeni AKUK, për vlerën e detyrimit dhe ndarjen me këste të detyrimit.
- ✓ Me shkresën nr.197,.datë 23.06.2025, i është kërkuar SHRUK Gjirokastër ndarja me këste e detyrimit.
- ✓ Me shkresën nr.267,.datë 19.08.2025, i është kërkuar SHRUK Gjirokastër ndarje me këste dhe shlyerje te detyrimit .
- ✓ Me shkresën nr.3977, datë 27.11.2025, i është kërkuar SHRUK Gjirokastër ndarje me këste të detyrimit.
- ✓ Me shkresën nr.4020,datë 02.12.2025, i është kërkuar nga MIE, MF dhe SHRUK Gjirokastër ndarje me këste të detyrimit dhe përfshirjen e tyre si borxh në MF.
- ✓ Me shkresën nr.875,datë 04.03.2026, kërkuar SHRUK Gjirokastër ndarja me këste e detyrimit dhe është pjesë e buxhetit të vitit aktual një pjesë e debisë.

Me agjentin tatimor SHRUK Gjirokastër rakordimi ka qenë i përmuajshëm dhe gjatë këtij viti taksat janë ndarë sipas natyrës së tyre, përfshirë edhe treguesit në fund të vitit të detajuar sipas natyrës dhe llojit të taksave dhe tarifave vendore .

Nga auditimi rezulton se**,** STTAL-ja për subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar dhe ri njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë nisur urdhër bllokimet e llogarive, por në asnjë rast nuk është ngritur padi gjyqësore dhe nuk është kërkuar kallëzim penal në zbatim të Ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995,

"Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 181 "Mos pagimi i taksës dhe tatimeve". Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.3, ku përcaktohet që:
"Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit",
Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e qeverisjes vendore", neni 35 "Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore" si dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", neni 3, pikat 9-10.

- ***Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:***

Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje me pakicë të karburanteve, njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit si dhe nga verifikimi në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, konstatohet se përgjatë vitit 2025 në territorin e Bashkisë Përmet kanë ushtruar në total 6 (gjashtë) subjekte me aktivitet tregtim me pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj.
Regjistri i subjekteve që tregtojnë karburante, të shoqëruar dhe me dosjet personale 2025, si dhe pagesa e taksës për autorizim.
-Pagesat e licencave për tregtimin e hidrokarbureve gjendje 31.12.2025
(Tabela nr. 15)

Lekë

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	"G" ShPK	K.....T	06.01.2022	05.01.2027	1,000,000	800,000	200,000 Derdh.14.04.2026
2	"K" Shpk	J.....P	06.08.2020	05.08.2025	1,000,000	1,000,000	0
3	"O" Shpk	J.....I	01.06.2021	31.05.2026	1,000,000	1,000,000	0
4	"A."shpk	L.....P	14.09.2022	13.09.2027	1,000,000	1,000,000	0
5	"S."	K.....V	30.04.2018	29.04.2023	1,000,000	200,000	800,000
6	2A. OIL Shpk	L.....M	02.05.2025	01.05.2030	1,000,000	200,000	800,000
Shuma					**56000,000**	**3,400,000**	**1,600,000**

Burimi: *Bashkia Përmet*

Për vitin 2025 është bërë kontabilizimi i 2 subjekteve debitor ,"S" e "G." në vlerën 800,000 lekë debi e pakontabilizuar në vitet paraardhëse, pasi sot ky subjekt nuk ushtron aktivitet në qytetin e Përmetit dhe "G" Shpk e cila e ka bërë pagesën në prill 2026 për vlerën e debisë 200,000 lekë.

Komisioni i Apelimit Tatimor (KAT)

Bashkia Përmet ka ngritur Komisionin e Apelimit Tatimor me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.63, datë 25.02.2025, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 7 i tij si dhe në Nenin 22/5 "Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore" të po këtij ligji.- Nga ana e komisionit janë ndjekur hapat proceduralë për zgjedhjen e kryetarit të komisionit. Komisioni organizohet dhe funksionon sipas rregullores së brendshme të funksionimit të Apelit Tatimor, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 10, datë 25.02.2019. Nga auditimi *rezulton se* gjatë vitit 2025, nuk ka patur raste të ankimeve nga subjekte apo familjarë, lidhur me detyrimet tatimore ndaj Bashkisë Përmet

Përgjegjësi për (mos)vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", neni 42 "*Administrimi i mjeteve monetare*", pika 2, ku përcaktohet se:

"*Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.*"

***Konklu**zion:* Nga auditimi i sistemit të administrimit të të ardhurave vendore të Bashkisë Përmet rezultoi se sistemi funksionon, por paraqet dobësi në administrimin dhe përditësimin e bazës së tatimpaguesve, saktësinë dhe plotësinë e të dhënave, rakordimin ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe ndjekjen e detyrimeve të paarkëtuara**.** Ekziston një nivel i lartë i detyrimet që duhet të arkëtohen dhe diferencat e paarkëtuara nga agjentët tatimorë, kufizon aftësinë e Bashkisë për të identifikuar dhe arkëtuar në kohë të ardhurat që i takojnë. Në tërësi, sistemi kërkon përmirësime në kontrollin dhe integritetin e informacionit, koordinimin ndërmjet strukturave dhe ndjekjen e arkëtimeve, me qëllim rritjen e të ardhurave vendore dhe sigurimin e administrimit të plotë e efektiv të tyre. *Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj.A.H me detyrë Kryetar i Bashkisë Përmet, zj E.M. me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Bujqësisë.*

3. Auditim i llogarive vjetore për vitin 2025.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të Bashkisë Përmet për vitin ushtrimor 2025 janë të nënshkruara nga znj. A. H. - Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe znj. E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njrëzore, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues.

PFV janë depozituar pranë Degës së Thesarit Përmet me shkresën nr. 1207 prot., datë 30.03.2026, dhe konfirmuar (nënshkruar e vulosur) nga kjo Degë me nr.122 prot, datë 31.03.2026. Pasqyrat Financiare të gjeneruara nga SIFQ janë konfirmuar zyrtarisht nga Dega e Thesarit me dt. 31.03.2026.

Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore janë të shoqëruara me inventarin e llogarive, me situacionin e shpenzimeve dhe të ardhurave, si dhe aktet e rakordimit, të hartuara mbi realizimin e buxhetit vjetor, dokumente këto të firmosura/konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Sa më sipër, nga auditimi në lidhje me përgatitjen, paraqitjen dhe depozitimin të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore për vitin kalendarik të mbyllur më 31 dhjetor 2025, evidentohet se janë zbatuar afatet e detyrueshme nga ana e institucionit brenda 31 marsit të vitit pasardhës. *Sa më sipër,* vepruar në përputhje me kërkesat e Kreut V "Procedurat e paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore", Paragrafi nr.118, të UMF nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar.

Nga auditimi rezultoi se, të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara me nr. 1207, datë 30.03.2026 janë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ, *(në këto të fundit nuk përfshihet TD e llog. 520 "Disponibilitete në Thesar"),* në përputhje me përcaktimet e Kreut V "Rakordimi dhe mbyllja e llogarive të tjera vjetore të qeverisjes së përgjithshme", pika 10 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.127, datë 19.12.2025 "Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025":

Të dhënat e pasqyrave financiare të protokolluara të jenë të njëjta me të dhënat e gjeneruara nga SIFQ.

Ditarët e mbajtur për regjistrimin e veprimeve kontabile: Nga verifikimi i pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore rezulton se, janë mbajtur ditarët për regjistrimin e veprimeve kontabile, si ditari i bankës/ thesarit *(manualisht),* ditari i shpenzimeve, ditari i magazinës *(manualisht).* Llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, kuadrojnë si shumë totale (Aktivet gjithsej = Pasivet + Fondet neto); llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, *trajtuar më hollësisht në vijim*. Veprimet kontabile janë azhurnuar periodikisht nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, janë pasqyruar veprimet në ditarë, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi.
Sa më sipër, vepruar në përputhje me përcaktimet e Kreut I, paragrafi 2.2.6, të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar:

Konstatim:
1. Nga ana e Bashkisë Përmet nuk është mbajtur centralizatori për veprimet përmbledhëse, i cili shërben për azhurnimin, përmbledhjen dhe centralizimin e veprimeve dhe llogarive nga gjithë ditarët, duke shmangur rreziqet e dublimit të tyre. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, mungon gjurma e veprimeve sistemuese dhe rakordimin e tepricave kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet dhe ato që mbarten në vitin pasardhës..
Kryerja e këtyre veprimeve dhe nxjerrja e bilancit vërtetues është kryer nga jashtë ditarëve.
Sa më sipër, jo në përputhje me Kreun II, "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Nënkreu II.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", pika 6 dhe 30, të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar:

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues, të cilët dallohen në:

- *Dokumente bazë justifikuese (faturë blerje/ shitjeje, fletëhyrje/dalje, mandatarkëtim/pagesë), të prodhuara manualisht ose nëpërmjet programeve informatike dhe shërbejnë për kryerjen e regjistrimeve fillestare të çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik në librat e kontabilitetit.*
- *Urdhërshpenzimi/urdhërpagesa që përdoren në marrëdhëniet e njësive të qeverisjes së përgjithshme me degën përkatëse të thesarit, për paraqitjen e kërkesave për kryerjen e një shpenzimi apo ekzekutimin e një pagese, nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ).*
- ***Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.***

2. Gjatë auditimit të kryer për periudhën objekt shqyrtimi, konstatohet se mbajtja e llogarive kontabile dhe nxjerrja e bilancit nga Bashkia për vitin 2025, është realizuar ***në mënyrë manuale***, *(si p.sh ditari i bankës/ thesarit, ditari i magazinës, duke krijuar riskun e gabimeve dhe* evidentohen korrigjime apo fshirje të veprimeve regjistruese apo shumave të tyre, si p.sh për regjistrimet e kryera për *urdhër-shpenzimin nr.46, datë 15.01.2025, ush nr.95, datë 05.02.2025; ush nr.118, datë 10.02.2025; ush nr.165, datë 04.03.2025; ush nr. 537, datë 27.06.2025; ush nr.543-547, datë 02.07.2025 ; ush nr.600-603, datë 04.07.2025 deri 28.07.2025; ush nr. 640-644 datë 05.08.2025; ush nr. 682, datë 06.08.2025; ush nr. 778, datë 03.09.2025; ush nr 943, datë 03.11.2025; ush nr. 1003, datë 18.11.2025, etj.*
Sa më sipër, veprime jo në përputhje me përcaktimet e Kreut 2.2 "Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik", pika nr. 6 Krei I dhe 28, Kreu III të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe

UMF nr. 30, dt. 27.12.2011, "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", që ngarkon njësitë e qeverisjes vendore të regjistrojë në ditarët e kontabilitetit të gjitha transaksionet financiare të ndodhura gjatë periudhës ushtrimore në mënyrë kronologjike dhe dokumentojnë pa korrigjime e fshirje çdo transaksion ekonomik.
Në këtë kuadër, Bashkia Përmet duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe implementimit të programeve financiare, *që garantojnë programe informatike **të pamanipulueshme** dhe të printueshme në çdo kohë.*

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:
Për vitin 2025, nga verifikimi dhe testimi i transaksioneve për çdo muaj, të ditarit kontabël të bankës për shpenzimet sipas natyrës (Klasa 6 dhe Klasa 2) me akt-rakordimin e thesarit mbi bazën e dokumentit të nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj, për shumat në çdo llogari dhe në totalin mujor e vjetor, nuk konstatohen diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës së shpenzimeve, ku janë hedhur autorizimet buxhetore (çeljet) dhe destinacionet e përdorimit të fondeve sipas llojit të shpenzimeve dhe klasave të llogarive.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit Përmet. Realizimi i buxhetit është raportuar Degës së Thesarit, si vijon:

- Situacioni i Shpenzimeve Vjetore (me burim nga granti i pakushtëzuar dhe specifik, nga të ardhurat dhe nga granti i kushtëzuar) për vitin 2025, është hartuar dhe ngarkuar në sistem nga ana e Bashkisë Përmet. Ky situacion është nënshkruar rregullisht nga zyrtarët e njësisë shpenzuese, nga Nënkryetari z.F. H. Drejtori DBFBNJ znj.E. K. me datë 28.01.2026 dhe nënshkruar nga nëpunësi i Degës së Thesarit.
- Me datën 04.02.2026 sipas shkresës nr.469 prot., është dërguar në DTH akt rakordimi për fondet e trashëguara dhe është mbajtur akti i rakordimit midis përfaqësuesve të Bashkisë Përmet, (nënshkruar nga Nënkryetari z.F. H., Drejtori DBFBNJ znj.E. K. dhe Përgjegjësi i Financës znj.V. N.) dhe Degës së Thesarit Përmet (nënshkruar nga Specialisti i DTH z.E. H.), mbi rakordimin e nivelit të realizimit të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore të periudhës Janar-Dhjetor 2025, ku janë evidentuar dhe shumat e të ardhurave që trashëgohen nga viti 2025 në vitin 2026 në PLTH.
- Me datën 28.04.2026 është mbajtur akti i rakordimit midis përfaqësuesve të Bashkisë Përmet dhe Degës së Thesarit, mbi rakordimin e mjeteve në ruajtje (llogaria 4662104 dhe llog.4665100, etj., në trajtë progresive për periudhën Janar-Dhjetor 2025), nënshkruar rregullisht nga NA dhe NZ, dhe konfirmuar nga Nëpunësi i Degës së Thesarit.

Pra, rezulton se, për periudhën e audituar, në lidhje me shpenzimet dhe të ardhurat e Bashkisë Përmet, janë mbajtur akt rakordimet periodike e vjetore, që janë kundër-firmuar rregullisht për të dhënat nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. *Për sa sipër,* është vepruar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9936, date 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 3, pika 4 dhe 6, Paragrafit nr.88 dhe 221, të Kreut IV, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Paragrafit nr.12, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme".

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

<u>Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:</u>

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Përmet për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2025, deri më datën 31.12.2025.** Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në këtë Bashki. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve të transaksioneve, proceduara analitike dhe teste thelbësore, ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2025 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2024.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2025 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike, trajtuar hollësisht në vijim.

Llogaritja e nivelit të materialitetit për vitin 2025: Treguesi i precizionit të materialitetit për auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore për Bashkinë Përmet është **10,029,433 lekë**, përllogaritur si në tabelën e përfshrë në anekset e Raportit.

Nga procesi i auditimit dhe verifikimi i vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2025, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e tyre, treguesit e aktiveve dhe aktiveve neto paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.16.

Lekë

	31.12.2025	**31.12.2024**
Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto	**1,537,872,989.00**	**1,375,459,014.00**
Aktivet	1,707,397,213.00	1,516,729,679.00
Pasivet	169,524,224.00	141,270,665.00

Lekë

	31.12.2025	**31.12.2024**
Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.	**559,762,638**	**497,342,843**
Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues"	71,144,542	62,519,908
Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra"	143,326,945	121,389,055
Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre"	345,291,151.00	313,433,880.00

Burimi: Bashkia Përmet, PFV 2025.

A. AKTIVET

I. Aktivet Afat Shkurtra

1. Llogaritë e klasës 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhen nga:
Tabela nr 17.

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	130,819,664	129,524,917	1,294,747
50	Letra me vlerë			
532	Vlera të tjera			
54	Akreditiva dhe paradhënie			
59	Provigjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)			
Totali		130,819,664	129,524,917	+1,294,747

Burimi: Bashkia Përmet, PFV 2025.

- **Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar"** paraqitet më datë 01.01.2025, në vlerën 129,524,917 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 130,819,664 lekë.

Nga të dhënat analitike sipas pasqyrave të pozicionit financiare të njësisë shpenzuese Bashkia Përmet rezulton se llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar" në fund të vitit 2025 është pasqyruar në vlerën 130,819,664 lekë që është shuma e gjendjeve analitike të kësaj llogarie. Nga auditimi i të dhënave sipas akt rakordimeve shkresore me thesarin për të ardhurat e trashëguara u konstatua se nuk ka mospërputhje midis të dhënave për të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 me llogarinë 520 "Disponibilitete në Thesar", me vlerën e tyre të regjistruar në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025. Akt rakordimi i nënshkruar nga NA dhe ZN dhe Përfaqësuesi Degës së Thesarit Përmet z.E.H për të ardhurat e vitit 2025 të disponueshme në SIFQ dhe që trashëgohen në vitin 2026 është 104,622,384 lekë, e barabartë me TD të llog.520 në bilanc në shumën 130,819,664 lekë dhe vlera e mjeteve në ruajtje (llog.466 është 26,197,280 lekë), ku këto dy këto shuma japin tepricën debitore të llogarisë 520..

Konstatim:

Llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" në vlerën 104,622,385 lekë dhe llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në vlerën 26,197,279 lekë. Sipas informacionit kontabël llogaria 520 "Disponibilitete në thesar" është e rakorduar në vlerën 130,819,664 lekë.

Më hollësisht,

- ✓ ***Llogaria 85, "Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur",*** është paraqitur në rubrikën C të Pasqyrës së Performancës Financiare 2025 (F2) që në fund të vitit 2025 është në shumën 104,622,385 lekë, e barabartë me zërin "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85)", që evidentohet në rubrikën C, të Aktiveve neto/ Fondeve neto në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (F1).

Llog.	Emërtimi	Teprica dt 31.12.2025	Teprica dt 31.12.2024
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	104,622,385	109,643,307

- ✓ ***Totali i mjeteve në ruajtje***, sipas akt rakordimit datë 28.04.2026 të mbajtur me Degën e Thesarit Përmet, është 26,197,279 lekë (ku, gjendja dt 1.1.2025 është 19,881,610 lekë, shtesat e llogarisë të rakorduara me DTH janë 10,105,158 lekë dhe pakësimet 3,789,489 lekë) përputhet me shumat e llogarisë 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" në pasqyrën F1 të Bilancit Kontabël, që është 26,197,279 lekë.

		Viti 2025	Viti 2024
520	Disponibilitete në Thesar	130,819,664	129,524,917

466	Kreditore për mjete në ruajtje	26,197,279	19,881,610
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	104,622,385	109,643,307
	Shuma (llog 466 + 85):	**130,819,664**	**129,524,917**

Burimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

Këto veprime janë në përputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 22, pika 3, germa "dh", si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafët 49-50.

2. Llogaritë e klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhen nga:

Tabela nr 18. **Lekë**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2025	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2025-2024
31	Materiale	37,736,409	12,042,889	25,693,520
32	Inventar i imët	33,408,133	50,477,019	-17,068,886
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	
34	Produkte	0	0	
35	Mallra	0	0	
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	
39	Provigjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	
Totali		**71,144,542**	**62,519,908**	**+8,624,634**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

- Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2025, paraqitet në vlerën 71,144,542 lekë dhe përbëhen nga llogaria kontabël 31 "Materiale" në vlerën 37,736,409 lekë dhe llogaria 32 "Inventar i imët" 33,408,133 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën +8,624,634 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" e cila paraqitet në të njëjtën vlerë në Formatin F2 "Pasqyra e Performancës Financiare", (grupi VIII, rreshti 120) ,

63	VIII. Ndryshimi i gjendjes se inventarit	8,624,634	5,181,055

Sa më sipër, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 4.1:

Llogaria 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Funksionimi kontabël është si më poshtë: a) Kur blihen, bëhen hyrje materialet: - Debitohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"; - Kreditohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". b) Kur bëhen dalje materialet: - Debitohet 63, "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"; - Kreditohet klasa 3, "Gjendje inventari qarkullues"

- Llogaria 31 "Materiale", ka vlerën 37,736,409 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2025	12,042,889
Shtesa (D)	25,693,520
Pakësime (K)	
Gjendja në 31.12.2025	**37,736,409**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

- **Llogaria 32 "Inventarë i imët"**, ka vlerën 33,408,133 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2025 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lekë

Lëvizjet e llogarisë	Vlera
Çelje e vitit 2025	50,477,019
Shtesa (D)	4,435,713
Pakësime (K)	21,504,599
Gjendja në 31.12.2025	**33,408,133**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Gjendja e llogarive të mësipërme materiale është e kuadruar me tepricën e tabelave të inventarizimit fizik të pasurisë. Për kryerjen procedurave të inventarizimit të pasurisë është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhrat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:

-Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm", më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 92,232,291 lekë. është shtuar gjatë vitit në vlerën 14,164,044 lekë, pakësuar nga shlyerjet e detyrimeve për 2,787,629 lekë, ndërsa gjendja më 31.12.2025 paraqitet në vlerën **103,608,706** lekë. Në këtë llogari janë evidentuar detyrimet e personave dhe subjekteve të ndryshme ndaj Bashkisë, që kanë lindur sipas raporteve të auditimit të KLSH-së, gjobat e IMTV-së¸ detyrimet nga kontratat e lidhura për tokën bujqësore, debitorët e ujësjellësit, detyrimet e subjekteve të biznesit për taksa dhe tarifa vendore të papaguara deri në 31.12.2025, etj.

Analiza e detajuar e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", më datë 31.12.2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

ekë

Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"	
Çelje e vitit 2025	**92,232,291**
Shtesa (D)	14,164,044
Pakësime (K)	2,787,629
Gjendja në 31.12.2025	**103,608,706**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Struktura e detyrimeve debitore më datën 31.12.2025 përbëhet nga këto detyrime për arkëtim:

Tabela nr 19. **Lekë**

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025	%
Aparati Bashkisë Përmet	25,732,538	3,669,254		29,401,792	
Nj Ad Piskovë	614,384	133,722		748,106	
Nj Ad Petran	60,51,085	694,911		6,745,996	
Nj Ad Frashër	1,091,158	0		1,091,158	
Nj Ad Çarshovë	126,969	1,322,537		1,449,506	
SHUMA	**33,616,134**	**5,820,424**	**-**	**39,436,558**	**38**
ALUIZNI	1,432,320	0	247,252	1,185,068	
Taksat dhe tarifat vendore subjekte	30,450,900	3,432,895	2,540,377	31,343,418	30.2
Debitor Ujësjellësi (si agjent)	26,492,937	0		26,492,937	26
Gjobë IMT	240,000	0		240,000	
Kontrata për tokën bujqësore		131,503		131,503	
Karburantet debitore		1,000,000		1,000,000	
Kontrata me të tretë		3,779,222		3,779,222	3.6

SHUMA TOTALE	**92,232,291**	**14,164,044**	**2,787,629**	**103,608,706**	**100**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Konstatim: Evidentohet një nivel i lartë detyrimeve debitore në Bashkinë Përmet në fund të vitit 2025, që kanë ardhur në rritje prej +11,376,415 lekë, ose + 12.3 % më shumë se fundi i vitit të mëparshëm, ku shtesat vjetore të llogarisë së debitorëve janë 14,164,044 lekë dhe likuidimet/ shlyerjet për 2,787,629 lekë. Gjendja e mbartur e debitorëve deri me 31.12.2024 është 92,2 milionë lekë dhe së bashku me detyrimet e vitit 2025 detyrimet debitorë të paraqitura në llogarinë 468 janë 103,6 milionë lekë. Në strukturën e përgjithshme të debitorëve, 38 % janë detyrimet e popullatës për taksat e tarifat vendore në NJ-të, 30,2% detyrimet e biznesit, 26 % debitor ujësjellësi si agjent tatimor dhe 3,6 % kontratat me të tretët, etj, etj.

I. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet një nivel i lartë i detyrimeve të mbartura e të trashëguara për taksat e tokës bujqësore, të biznesit, të ndërtesave etj., nga vitet e mëparshme (2011-2024) të NJA-ve , për të cilat nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit administrohen listat e dërguara nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë dhe Njësive Administrative Petran, Frashër, Çarshovë dhe Piskovë Grupit të auditimit nuk iu paraqit dokumentacion për pasqyrimin në mënyrë analitike të këtyre detyrimeve.

Rezulton se për 5 (pesë) Njësitë Administrative të Bashkisë Përmet, detyrimet debitore për moslikuidimin e taksës së tokës dhe të ndërtesës nga abonentët familjarë për periudhën 2011-2024 zënë 85.2 % të detyrimeve gjithsej për këtë kategori. Specialistet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik sqarojnë se kjo shumë vjen nga pasqyrat financiare të ish Komunave që nga viti 2015.Kështu, nga vera e debisë së trashëguar prej 39.4 milionë lekë, 33,6 miloonë (ose 85.% e saj e zënë detyrimet e periudhës 2011-2024) dhe 5,8 milionë e zënë detyrimet e vitit 2025 (ose 14.7% e tyre).

Ky problem është trajtuar edhe në raportet e mëparshëm të auditimit të KLSH-së, ku është rekomanduar për gjetjen e origjinës nga ka lindur detyrimi, arkëtimin e këtyre vlerave, deri në ngritjen e padive gjyqësore, por mungojnë veprimet korrigjuese për sa më sipër.

Sa më sipër, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; neni 42 pika 1-5 të ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar; Ligjin nr.9632, datë 30,10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme",* Kapitulli II, pika 6: *"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues…".*

II. Nga ana e Bashkisë së Përmetit nuk janë kryer procedurat e kërkimit të detyrimeve në rrugë administrative e gjyqësore, por llogaria "*Debitorët e ndryshëm*" (llog. 468) në fund të vitit 2025 paraqitet në shumën prej 103,608,706 lekë.

III. Në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" në Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025, nuk është kontabilizuar pasqyruar detyrimi vlera totale prej **2,054,221 lekë,** që u përket **1,486 debitorëve familjarë**, duke sjellë nënvlerësim të kësaj llogarie për këtë shumë (trajtuar më hollësisht në aktin e konstatimit të mbajtur mbi të ardhurat nga tatimet dhe taksat vendore). Si pasojë e vonesës në rakordimin e detyrimeve midis Bashkisë Përmet dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër për vjeljen e detyrimeve të familjarëve të vitit 2025, (akt rakordimi nr. 498, datë 04.03.2026 mbi detyrimet dhe likuidimet e periudhës Janar-dhjetor 20250), bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë, nuk janë pasqyruar në llogaridhënie

vjetore te vitit 2025 detyrimet e popullatës në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm', në shumën 2,054,221 lekë

IV. Nuk është pasqyruar në ditarët e kontabilitetit të Bashkisë Përmet llogaria 470 "Llogari në pritje - të ardhura për t'u marrë" që shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"", ku përcaktohet që:

Pika 7. Në rubrikën 2.3 "Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik", paragrafi 21, shtohet pika c me këtë përmbajtje:

c) Për njohjen (me konstatimin) e të drejtave për t'u arkëtuar bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

Njësitë e qeverisjes së përgjithshme që njohin të ardhurat në kontabilitet sipas paragrafit 16 (e) administrojnë të drejtat për tu arkëtuar dhe debitorët e njësisë si më poshtë:

- ✓ *Për konstatimin paraprak të të drejtave për t'u arkëtuar* debitohen llogaritë përkatëse të klasës 4 (411/468) "Debitorë të ndryshëm" dhe Kreditohet llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" në analiza shtatëshifrore sipas tipologjisë së të drejtave për tu arkëtuar.
- ✓ *Për arkëtimin e të drejtave,* në të njëjtën kohë me veprimet sipas pikës 16 (e) dhe 22, kryhet veprimi i kundërt: debitohet llogaria 470 dhe kreditohet llogaria përkatëse e të drejtave e debituar më parë (411/468).

Pika 16/e: Për të ardhurat e shfrytëzimit, në momentin e njohjes, bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë: Debitohet llogaria përkatëse financiare (klasa 5); dhe Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7).

Pika 22: Llogaritë përkatëse financiare në klasën 5 funksionojnë si më poshtë vijon: Debitohet llogaria financiare përkatëse; Kreditohet llogaria përkatëse e të ardhurave (klasa 7), "Të ardhurat sipas natyrës ekonomik

V. Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" përfshirë edhe vlera 26,492,937 lekë e cila është kontabilizuar në zërin "Debitor Ujësjellësi (si agjent)", për shumën e borxheve që Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Përmet i detyrohet Bashkisë Përmet, (e përfshirë sipas Marrëveshjes së Themelimit datë 22.07.2022 në SHRUK Gjirokastër). Sa më sipër, nuk evidentohet një listë analitike të abonentëve familjarë që janë debitorë nga taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu në disa raste janë kontabilizuar vlera me emërtimin debitorë si biznes i vogël dhe i madh të transferuara nga ish-komunat *Piskovë, Çarshovë, Petran dhe Frashër* për të cilat nuk ka një evidencë analitike ku të jetë e shoqëruar me dokumentacion justifikues përkatës. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" me kundërparti llogarinë 468 "Kreditorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 7.

Pasqyrimi i llogarive 4342 *"Operacion me shtetin (të drejta)"* dhe 4341 *"Operacione me shtetin (detyrime)"* në pasqyrat financiare të llogaridhënies vjetore:

- Gjendja e llogarisë ***4342 "Operacion me shtetin (të drejta)***" *(financim i pritshëm nga buxheti),* sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit, paraqitet në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar më datën 01.01.2025 në vlerën 29,156,764, ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, në vlerën 39,718,239 lekë, ose me një shtesë në vlerën 10,561,475 lekë ndaj vitit të mëparshëm. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 20. **Lekë**

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)	
Çelje e vitit 2025	**29,156,764**
Shtesa (K)	39,718,239
Pakësime (D)	29,156,764
Gjendja në 31.12.2025	**39,718,239**

Lekë

Operacion me shtetin (të drejta)	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Paga	18993686	16850307	18993686	16850307
Detyrime për tatim taksa	995328	1076427	995328	1076427
Sigurime Shoqërore	4653227	4982959	4653227	4982959
Sigurimet Shëndetësore	645761	686795	645761	686795
Kreditorë të ndryshëm	3868762	16121751	3868762	16121751
Totali	**29,156,764**	**39,718,239**	**29,156,764**	**39,718,239**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Referuar Planit Kontabël dhe udhëzimeve të MF, kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401, 421, 431, 435, 436, 437 dhe 467 dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit të bashkisë për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara *(grantet korrente a kapitale që merren nga buxheti i shtetit).*

Sipas UMF nr. 8, datë 09.03.2018, llogaria 4342, *"Operacione me shtetin (të drejta)"* është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla janë zëra si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo detyrimet për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

- Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, "Shpenzime sipas natyrës" dhe Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

- Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)", Kreditohet llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti".

Kjo llogari e analizuar përbëhet nga detyrimet e papaguara në fund të vitit 2025 për këtë njësi shpenzuese. Konkretisht, detyrimet përbëhen nga:

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2025, përmbledhësja e llogarive 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe llog e klasës 4-rt, janë në vlerën 0 lekë:

- Llog 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 0 lekë;
- Llog 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 16,850,307 lekë;
- Llog 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taks në vlerën 1,076,427 lekë;
- 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 4,982,959 lekë;
- Llog.436 "Sigurime shëndetësore" në vlerën 686,795 lekë;
- Llog.437,438 "Organizma të tjerë shtetërore" në vlerë 0 lekë dhe
- Llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 16,121,751 lekë me këtë përbërje:

Nr	Emri I subjektit	Objekti	Fatura/Proceset	Shuma
1	OSHEE	ne proces gjyqesor	ne proces gjyqësor	2,346,886
2	B. C.	ne proces gjyqesor	ne proces gjyqësor	302,088
3	L. VII	Rik.Pallati i Sportit	23/2025 date 26.03.2025	1,604,316
4	Z.	Rik.i shkolles "Meleq Gosnishti"	10/2025 date 22.12.2025	937,607
5	K.	Rik.Rruga Qilarisht	11/2025 date 15.12.2025	8,681,555
6	T.-R.	Mjeti zjarrfikes	78/2025 date 19.11.2025	2,160,000
7	F. S.	Kolaudim "Rehabilitim rezervuari Qilarisht"	48/2025 date 29.12.2025	89,299
		Total		**16,121,751**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Shuma e llogarive 401-467 si më sipër: 39,718,239 lekë

Sa më sipër, llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 39,718,239 lekë, *kuadron* me shumën e vlerës së llogarive të detyrimeve për detyrimet e konstatuara dhe të rezultuara në fund të vitit 2025 prej 39,718,239 lekë,

4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	39,718,239	29,156,764

Konstatim: Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 39,718,239 lekë, ***nuk kuadron me*** llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit", që janë regjistruar në PF për 104,622,385 lekë në Pasqyrën F1 të Pozicionit Financiar të kësaj Bashkie, **me një diferencë 64,904,146 lekë:**

7206	Financim i pritshëm nga buxheti	104,622,385	109,643,307

Sa më sipër, nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2025 të kësaj llogarie, në **mos përputhje** me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)" paragrafi 32 dhe si "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin", si dhe Aneksi 1.

* * *

Referuar përcaktimeve të Kreut III, nënkreu 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)", pika 8/l, të UMF nr.8, datë 09.03.2018, Llogaria ***4341, "Operacione me shtetin (detyrime)"*** është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme.

Konkretisht, trajtimi kontabël është si më poshtë: Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm për konstatimin e një të ardhure (pavarësisht raportit të pjesëmarrjes (buxhet apo institucion) dhe Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.

E ardhura që në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit duhet të konstatohet detyrimi: Debitohet llogaria 8424, "Transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm", Kreditohet llogaria 4341, "Operacione me shtetin (detyrime)".

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

- **Llogaria 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)"**, më datë 31.12.2025, paraqitet në vlerën 0 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (të drejta)	
Çelje e vitit 2025	0
Shtesa (K)	-
Pakësime (D)	-
Gjendja në 31.12.2025	**0**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Teprica e llogarisë 4341 "Operacion me shtetin (detyrime)" sipas PFV të depozituara në Degën e Thesarit për vitin 2025, paraqitet në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar në fund të v.2025 në shumën **0 (zero) lek**ë (rreshti 83 në pasiv të bilancit, grupi i Pasiveve Afatshkurtra).

reshti	Llog.	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	**0**	**0**

Nga ana tjetër, shuma e llogarive 411,423-429,468 janë në shumën, prej **103,608,706** lekë, ku përfshihet vetëm vlerat e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm".

llog	**Emërtesa**	**31.12.2025**
411	Klientë e llogari te ngjashme	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	0
468	Debitorë të ndryshëm	103,608,706
	Shuma	**103,608,706**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Sa më sipër, rezultojnë mospërputhje dhe nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2025 të kësaj llogarie, në mos përputhje me trajtimet e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*" i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 48 dhe Kreu III, paragrafi 32.

			2025	**2024**
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	**0**	**0**

Kjo llogari është në shumën zero lekë në bilanc, kur llog. 468 debitore eshte 103.6 mln lekë.

468	Debitorë te ndryshëm	103,608,706	92,232,291

Më hollësisht, llogaria 468 ka këtë strukturë:

Tabela nr 21:

Debitorë subjekte dhe individë	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Aparati Bashkisë Përmet	25,732,538	3,669,254		29,401,792
Nj Ad Piskovë	614,384	133,722		748,106
Nj Ad Petran	60,51,085	694,911		6,745,996
Nj Ad Frashër	1,091,158	0		1,091,158
Nj Ad Çarshovë	126,969	1,322,537		1,449,506
SHUMA	**33,616,134**	**5,820,424**	-	**39,436,558**
ALUIZNI	1,432,320	0	247,252	1,185,068
Taksat dhe tarifat vendore subjekte	30,450,900	3,432,895	2,540,377	31,343,418
Debitor Ujësjellësi (si agjent)	26,492,937	0		26,492,937
Gjobë IMT	240,000	0		240,000
Kontrata për tokën bujqësore		131,503		131,503
Karburantet debitore		1,000,000		1,000,000
Kontrata me të tretë		3,779,222		3,779,222
SHUMA TOTALE	**92,232,291**	**14,164,044**	**2,787,629**	**103,608,706**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Në kushtet që, nga ana e Bashkisë Përmet nuk janë përmbledhur veprimet në centralizator ose mastro (nuk është mbajtur ditari përmbledhës centralizator për përmbledhjen e llogarive vjetore nga ditarët kontabël), ndaj nuk mund të analizohet saktësia e tepricës së Llogarisë 4341

Veprime në kundërshtim me pikën 8, paragrafi 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)" (Aneksi 1), të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; nënpika 28, 29 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar:

- Teprica debitore e **Llog.486 "Shpenzimet e periudhave te ardhshme"**, sipas PFV të Bashkisë Përmet për vitin 2024 dhe 2025 janë evidentuar në vlerën zero lekë. Llogaria 486 përfshihet në grupin e llogarive rregulluese dhe përfaqëson shpenzime për blerje ose shërbime, realizimi faktik i të cilave ndodh në një vit ushtrimor të ardhshëm *(shpenzime të parapaguara).* Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 486 "Shpenzimet e periudhave te ardhshme",	
Çelje e vitit 2025	0
Shtesa (D)	0
Pakësime (K)	0
Gjendja në 31.12.2025	0

Në fund të periudhës të v.2025, llog 486 rezulton me tepricë debitore për 0 lekë, kurse llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", për 16,121,751 lekë. Nga ana e NZ janë kryer veprimet sistemuese në kontabilitet duke zbritur nga llog. 467 tepricën e llog.486, shumë e cila është evidentuar në F1 të PF, rreshti 82:

467	Kreditorë të ndryshëm	16,121,751	3,868,762

Sa më sipër, janë zbatuar përcaktimet e paragrafit 15, pika 3.1, Kreu III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të Udhëzimit Nr.5, datë 21.2.2022 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, për kryerjen e veprimeve kontabile në lidhje me *llogarinë nr. 4864, "Shpenzime të periudhave të ardhshme", (mbi ndryshimin e paragrafit 42, pika 3.1, Kreu III" Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme").*

Rakordimi i të dhënave të PFV me SIFQ:

U auditua përputhja e të dhënave mbi totalin e aktiveve, pasiveve dhe aktiveve neto sipas **PFV** të hartuara nga ana e njësisë raportuese Bashkia Përmet dhe të dorëzuara zyrtarisht në DTH dhe PF të gjeneruara nga Ministria e Financave në **SIFQ**.

Shuma e aktiveve neto sipas PFV për *vitin 2024* nga Bashkia është 1,375,459,014 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 1,245,934,097 lekë. Diferenca prej 129,524,917 lekë është e barabartë me tepricën debitore te llog.520 "*Disponibilitete në thesar*" për v.2024.

Shuma e aktiveve neto sipas PFV për *vitin 2025* nga Bashkia është 1,537,872,989 lekë, kurse sipas SIFQ vlera e aktiveve neto/fondeve neto rezulton 130,819,664 lekë***. Diferenca prej*** 130,819,664 lekë është e barabartë me tepricën debitore te llog.520 "Disponibilitete në thesar" për v.2025.

II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 "Aktive afatgjata jo materiale", 21 "Aktive afatgjata materiale", 25-26 "Aktive afatgjata financiare" dhe 23 "Investime në proces" përbëhen nga:

1. Aktivet Afatgjata Jomateriale.

- **Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"** më datë 01.01.2025, është regjistruar në PF sipas kostos historike në vlerën 29,997,508 lekë dhe vlerën neto 20194,217 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,148,486 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 12,832,424 lekë, ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 18,313,570 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë më datë 31.12.2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 22. **Lekë**

Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	29,997,508
	2	Amortizim i akumuluar	9,803,291
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**20,194,217**
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	1,148,4863
	5	Amortizim i shtesës	3,029,133
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	31,145,994
	5	Amortizim i akumuluar	12,832,424
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**18,313,570**

Analizuar sipas kostos historike, llogaria 202 "Studime dhe kërkime" për 15 zërat përbërës të saj paraqitet si vijon:

Tabela nr 23 **Lekë**

Studime-Projektime (kosto historike) **Objekte inventari**	Gjendja 01.01.2025	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2025
Projekti i Urës Biovizhde	300,000			300,000
Projekti i Urës Psillotere	390,000			390,000
Projekti i rrugës Dracove	400,000			400,000
Projekti i rrugës Iliare Pëllumbar	400,000			400,000
Projekti i rrugës Vllaho Psillotere	399,999			399,999
Projekti i kanalit ushqyes Rezervuari Kendref	399,999			399,999
Projekti sistemim asfaltim rruga Biovizhde	400,000			400,000
Projekti sistemim asfaltim rruga Zhepe	400,000			400,000
Projekte te ndryshme 2015	4,212,174			4,212,174
Projekte te ndryshme 2022	9,757,867			9,757,867
Projekte te ndryshme 2023	4,383,533			4,383,533
Projekt arkitektonik	544,065			544,065
Modele 3D	297,150	1,148,486		1,445,636
Studime dhe kerkime (ish Ndermarja e Pastrim Gjelberimit)	1,276,674			1,276,674
Projekti i ujrave te siperm Perroi i Bardhe	6,436,047			6,436,047
TOTALI	**29,997,508**	**1,148,486**		**31,145,994**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Konstatim: 1. Në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" është përfshirë vlera sipas kostos historike **18,353,574 lekë** me emërtimin *"Projekte të ndryshme"* të paidentifikuara nga viti 2015, 2022 dhe 2023 të cilat u përkasin ish-Komunave që prej vitit 2015.:

Projekte te ndryshme 2015	4,212,174
Projekte te ndryshme 2022	9,757,867
Projekte te ndryshme 2023	4,383,533
Shuma	**18,353,574 lekë**

Për këto aktive nuk ka inventar, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për aktivin, si dhe nuk ka analizë të kësaj llogarie pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projektimeve dhe viti i krijimit të tyre. Kjo situatë është e mbartur që nga viti 2015 nga ndarja e re administrative dhe bashkimi i ish/komunave me Bashkinë Përmet.

Në zbatim të rekomandimeve të auditimeve të mëparshme të KLSH-së, DFBBNJ u është drejtuar me shkresa të veçanta strukturave të Bashkisë Përmet si më poshtë:

-Me shkresën nr.129, datë 07.11.2025 me lëndën "Kërkesë për paraqitje dokumentacioni" i është kërkuar Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit Urban dhe Njësive Administrative për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të lidhur me studimet dhe projekt e Bashkisë Përmet. Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit Urban sipas shkresës nr.129/1 datë 11.11.2025 është kthyer përgjigje duke konfirmuar se nuk disponohet ky dokumentacion që kërkohet.

-Me shkresën nr.139, datë 13.11.2025 me lëndën "Kërkesë për paraqitje dokumentacioni" i është kërkuar Arkivës së Bashkisë Përmet për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të lidhur me studimet dhe projekt e Bashkisë Përmet. Nga ana e punonjëses së Srkivës sipas shkresës me nr 139/1 datë 14.11.2025 është kthyer përgjigje se nuk gjendet dokumentacioni i kërkuar.

2. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se në tepricën e llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" në fund të vitit 2025 është 31,145,994 lekë ku është përfshirë shuma prej 1,090,000 lekë që i përket vlerës së disa projekt-studime për investime, e pa shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

-llog 202 "Studime dhe projektime

Projekti i Urës Biovizhde	300,000		300,000
Projekti i urës Psillotere	390,000		390,000
Projekti i rrugës Dracove	400,000		400,000

-Llog 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" për këto projekte ka këto vlera përkatësisht,

136	Ura Biovizhde	23,730,566		23,730,566
10	Ura Vllaho Psillotere 2014	20,798,934		20,798,934
140	Rruga Dracove Zhepe	2,090,640		2,090,640

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b. d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2; si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 30-35, Kreu IV pika 75.

2. Aktivet Afatgjata Materiale

- Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" më datën 01.01.2025, është evidentuar në kontabilitet në vlerën 9,544,588 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 9,544,588 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 24. **Lekë**

Referenca	Nr.	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	9,544,588
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	9,544,588
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	**9,544,588**
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**9,544,588**

Analiza e detajuar e Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" më datë 31.12.2025 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Toka, troje, terrene (kosto historike) **Objekte inventari**	**Gjendja 01.01.2025**	**Shtesa (D)**	**Pakësime (K)**	**Gjendja 31.12.2025**
Masivi shkëmbor Zhepë	987,714			987,714
Qendra Çarshovë	985,186			985,186
Toka e terene v. 2015	3,831,167			3,831,167
Hipotekim nga zyra e aseteve viti 2020,2021,2022,2023,2024	198,000			198,000
Magazina Frashër	1,370,846			1,370,846
Toka e varrezave publike Përmet	2,171,675			2,171,675
Totali	**9,544,588**			**9,544,588**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Konstatim:

-Nga analiza në lidhje me të dhënat në pasqyrën më sipër, rezulton se në këtë llogari janë evidentuar 6 zëra /objekte në vlerën 9,544,588 lekë.

Në këtë zë janë përfshirë tek llogaria 210, ***"****Toka e terrene viti 2015",* të pa detajuara nga para vitit 2015 në shumën 3,831,167 leke. Gjithashtu, këtu është kontabilizuar vlera e artikullit "Masivi shkëmbor Zhepe" për 987,714 lekë, ku mungon dokumentacioni që është bërë hyrje ky aktiv shkëmbor.

Emërtimi llog.210	**31.12.2025**	**31.12.2024**
Masivi shkëmbor Zhepe	987,714	987,714

- **C.** Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", nuk ka përfshirë në **110 raste** në vlerën e truallit të aktiveve afatgjata materiale (llog.212) në pronësi të Bashkisë Përmet. Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së Llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", konstatohet se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të;

a) trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave që ka në administrim, kopshteve, qendrave shëndetësore, grazhdeve, Pallatit të Sportit, muzeumeve, kinemasë, çerdheve, shtëpive të kulturës si dhe të zyrave të Nj.A-ve, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione";

b) trojeve të godinave të regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë;

c) nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i tyre, për të cilën duhej bërë sistemimi dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në llogarinë (210) "Toka, troje terrene" dhe paraqitja e gjendjes së kësaj llogarie në PF është e paplotë, pasi mungojnë analizat për të.


Mungesa e informacionit kontabël për këtë llogari ndikon në informacionin që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, me efekt në procesin e inventarizimit fizik të tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30.

Nga auditimi i pasqyrimit të kësaj llogarie sipas pasqyrave individuale konstatohet se nuk ka lëvizje brenda njësive individuale në shtesa dhe pakësim pa pagesë të Llogarisë 210 "Toka, troje, terrene". Nga auditimi i pasqyrës 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" u konstatua që për vitin 2025 nuk ka as shtesa as pakësime, dhe mbetet vlera e trashëguar nga data 01.01.2025.

-Bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për ZK 2917, në lidhje me pasuritë *Godina e Bashkisë, Shkollat, Qendra Kulturore,*

*ambulancat, shkolla e mesme, shtëpia e kulturës, e*tj. vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Përmetit, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet duke filluar nga çmimi 1,015lekë/m2 për këtë zonë kadastrale. Kjo çështje konsiderohet materiale për auditimin, pasi, bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016,"Për miratimin e vlerës së hartës së tokës në Republikën e Shqipërisë", (Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 903, Bashkia Përmet për ZK 2917, vlera e pasurisë së paluajtshme të tokës truall për qytetin e Përmeti, (referuar çmimeve të vitit 2014), përcaktohet për token truall duke filluar nga **çmimi 1,015 lek/m2.**



Burimi: Harta sipas Fletores Zyrtare nr.14, viti 2016, faqe 903, Bashkia Përmet.

- **D.** Në llogarinë 210 "Toka, troje e terrene" janë ngarkuar shpenzimet e hipotekimit të aseteve, kur në fakt 18 zëra janë "apartamente" dhe duhet të ishin ngarkuar në debitim të llog 212; nuk ka analizë të shpenzimeve të hipotekimit të aseteve 2020-2024:

Hipotekim nga zyra e aseteve viti 2020,2021,2022,2023,2024	198,000		198,000

- **E**. Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2025 në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" nuk janë kontabilizuar **5 (pesë)** zëra të aktiveve me certifikatë pronësie, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika njohja e AAGJ në pasqyrat financiare dhe në kundërshtim me SKK 5 "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale i përmirësuar" pika 8.

Tabela nr 25

nr	*emërtimi*	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia Truall
19	*Varreza publike*	1589	26/19	K-34-137-(76-A)	28.07.2025	*Certifikatë*	2056
20	*Varreza publike*	1589	26/10	K-34-137-(76-A)	28.07.2025	*Certifikatë*	2860
21	*Varreza publike*	1589	26/17	K-34-137-(78-A)	14.07.2025	*Certifikatë*	3490
22	*Ndertese+truall objekti Rrugeve Rurale*	2917	8/13	PR-D-4	23.06.2025	*Certifikatë*	3533
23	*Shesh (Shkolla e Mesme "Sami Frashëri")*	2917	6/103	PR-F-3	19.06.2024	*Certifikatë*	4078
24	*Lapidari truall*	2917	16/7	PR-G-3		*Certifikatë*	396

Burimi: Bashkia Përmet

Sa më sipër, vepruar jo në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit mbi saktësinë dhe vërtetësinë e llogarive, dhe me përcaktimet e paragrafit 62, pika 3.3,"Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), Kreu III, të Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave, që përcakton shprehimisht se,

62.Aktivet paraqiten në rubrikën A të pasqyrës së pozicionit financiar. Totali i aktiveve përbëhet nga shuma e totalit të aktiveve afatshkurtra dhe totalit të aktiveve afatgjata. Rubrika I e aktiveve, që përfaqëson aktivet afatshkurtra, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

...

Rubrika e II-të e aktiveve, që përfshin aktivet afatgjata, përbëhet nga shuma e nënrubrikave që përfaqësojnë:

....

-Nënrubrika e aktiveve afatgjata materiale, që përfshin toka, pyje, ndërtesa, rezerva shtetërore, etj;

- Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione"

Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" në datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën 1,921,860 lekë me vlerë neto. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime dhe gjendja kontabël e kësaj llogarie më datë 31.12.2025, paraqitet në të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 211 "Pyje, kullota, plantacione" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	**1,921,860**
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	**1,921,860**
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	0
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	**1,921,860**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet .

Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" u konstatua se: zërat e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" janë pasqyruar në bilanc për vlerën 1,921,860 lek, por të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari si vijon:.


Emërtimi	Viti 2024	Shtesa 2025	Vlera
Pyllëzim sipërfaqe pyjore 2021,2024	1,565,760		1,565,760
Pyje ,Kullota, Plantacione (ish Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit)	316,100		316,100
Hipotekime	40,000		40,000
Shuma	**1,921,860**	**0**	**1,921,860**

Burimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Bazuar VKM-në 398, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, për transferimin në pronësi te bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së mjedisit e të ish komunave, bashkive", në pronësi të Bashkisë Përmet janë këto sipërfaqet pyjore dhe kullosore: Sipërfaqe totale: **18,433 ha**, e cila përbëhet nga: Pyje 10,771 ha, Sipërfaqe boshe:15 ha, Sipërfaqe djerrë: 20 ha, Sipërfaqe inproduktive: 110 ha, Sipërfaqe shkëmbore: 484 ha dhe, të cilat nuk janë përfshirë në asetet e kësaj NJVQV.

- Sipërfaqja pyjore e kullosore e transferuar dhe e regjistruar në ASHK është 6,790 ha ose 38% e saj, pasi sipërfaqja Pyjore+ Kullosore është 17,804 ha, (nga kjo sipas VKM sipëfaqja pyjore është në 10,771 ha dhe sipërfaqja e kullotave 7,033 ha).

- *Sa më sipër*, kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara në pronësi të kësaj Bashkie me VKM-në 398, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr. 433, dt. 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/ Bashkive", pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Përmet. Rezulton se këto pyje dhe kullota janë të pavlerësuara dhe të pa pasqyruara në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Përmet për vitin 2025.



Nr.	Qarku	Bashkia	Kodi kadastral	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra/ nëngastra	Sipërfaqja ha	Kategoria përdorimit të territorit	Shënime
1	Gjirokastër	Përmet	G704 00 001	EK Dhëmbel	1	68.62	Kullotë	
2	Gjirokastër	Përmet	G704 00 002	EK Dhëmbel	2	52.80	Kullotë	
3	Gjirokastër	Përmet	G704 00 003	EK Dhëmbel	3	78.65	Kullotë	
4	Gjirokastër	Përmet	G704 00 004	EK Dhëmbel	4	86.12	Kullotë	1 L. Plasm
5	Gjirokastër	Përmet	G704 00 005	EK Dhëmbel	5	96.63	Kullotë	2 L. Plasm
6	Gjirokastër	Përmet	G704 00 006	EK Dhëmbel	6	86.00	Kullotë	1 L. Plasm
7	Gjirokastër	Përmet	G704 00 007	EK Dhëmbel	7	96.67	Kullotë	1 L. Plasm
8	Gjirokastër	Përmet	G704 00 008	EK Dhëmbel	8	40.96	Kullotë	1 L. Plasm
9	Gjirokastër	Përmet	G704 00 009	EK Dhëmbel	9	142.31	Kullotë	
10	Gjirokastër	Përmet	G704 00 010	EK Dhëmbel	10	39.79	Kullotë	1 L. Plasm
11	Gjirokastër	Përmet	G704 00 011	EK Dhëmbel	11	152.63	Kullotë	1 L. Plasm
12	Gjirokastër	Përmet	G704 00 012	EK Dhëmbel	12	136.76	Kullotë	2L. Plasm
13	Gjirokastër	Përmet	G704 00 013	EK Dhëmbel	13	148.47	Kullotë	1 L. Plasm
14	Gjirokastër	Përmet	G704 00 014	EK Dhëmbel	14	124.11	Kullotë	3 L. Plasm
15	Gjirokastër	Përmet	G704 00 015	EK Dhëmbel	15	80.19	Kullotë	1 L. Plasm
16	Gjirokastër	Përmet	G704 00 016	EK Dhëmbel	16	2.47	Kullotë	2L. Plasm
17	Gjirokastër	Përmet	G704 00 017	EK Dhëmbel	17	169.35	Kullotë	1 L. Plas 1Bet
18	Gjirokastër	Përmet	G704 00 018	EK Dhëmbel	18	42.32	Kullotë	1 L. Plasm
19	Gjirokastër	Përmet	G704 00 019	EK Dhëmbel	19	141.16	Kullotë	1 L. Plasm
20	Gjirokastër	Përmet	G704 00 020	EK Dhëmbel	20	25.35	Kullotë	
21	Gjirokastër	Përmet	G704 00 024	EK Dhëmbel	24	47.44	Kullotë	
22	Gjirokastër	Përmet	G704 00 025	EK Dhëmbel	25	6.06	Kullotë	
23	Gjirokastër	Përmet	G704 00 026	EK Dhëmbel	26	0.74	Kullotë	
24	Gjirokastër	Përmet	G704 00 027	EK Dhëmbel	27	51.85	Kullotë	
25	Gjirokastër	Përmet	G704 00 028	EK Dhëmbel	28	6.37	Kullotë	
26	Gjirokastër	Përmet	G707 00 001	EK Frashër Koblarë	1	27.95	Kullotë	
27	Gjirokastër	Përmet	G707 00 002	EK Frashër Koblarë	2	79.30	Kullotë	
28	Gjirokastër	Përmet	G707 00 003	EK Frashër Koblarë	3	40.11	Kullotë	
29	Gjirokastër	Përmet	G707 00 004	EK Frashër Koblarë	4	3.02	Kullotë	
30	Gjirokastër	Përmet	G707 00 011	EK Frashër Koblarë	11	25.44	Kullotë	
31	Gjirokastër	Përmet	G707 00 012	EK Frashër Koblarë	12	17.13	Kullotë	
32	Gjirokastër	Përmet	G707 00 013	EK Frashër Koblarë	13	67.09	Kullotë	
33	Gjirokastër	Përmet	G707 00 014	EK Frashër Koblarë	14	82.71	Kullotë	

Burimi: Fragment i aneksit të VKM nr. 398, dt. 13.05.2020; Fletorja Zyrtare nr.89, datë 19.05.2020.

Nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik,Bujqësisë dhe Turizmit është ngritur grupi i punës për verifikimin e gjendjes faktike dhe juridike të pasurive të transferuara sipas VKM-ve ,të transferimit të pronave të Bashkisë Përmet dhe Njësive Administrative në varësi të saj, me nr.479,datë 10.11.2025. Konstatohet se, deri në dt 31.12.2025 nuk është kryer verifikim fizik për këto prona në lidhje me gjendjen e tyre për vitin 2025.
Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.

- **Llogaria 212 "Ndërtesa e konstruksione"** më datë 31.12.2025, referuar të dhënave në pasqyron 7/a të Bilancit Vjetor paraqitet në vlerën 83,870,064 lekë.

212	Ndërtesa e Konstruksione	635,322,277	559,369,753

Teprica e llog.212 sipas kostos historike ëme dt 1.1.2025 është 779,949,052 lekë (kolona nr.3 e formatit 7/b). Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 103,921,012 lekë, pakësime në vlerën 883,870,064 lekë. Amortizimi i akumuluar në fund të periudhës ushtrimore vlerësohet 248,547,787 lekë. Gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2025 paraqitet në vlerën neto 635,322,277 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 26 Lekë

Referenca	Nr.		
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	779,949,052
	2	Amortizim i akumuluar	220,579,299
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	559,369,753
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	103,921,012
	5	Amortizim i shtesës	27,968,488
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	883,870,064

	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike 31.12.25	0
	5	Amortizim i akumuluar	248,547,787
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	635,322,277

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Konstatim:

1.Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" gjatë vitit 2025 rezultoi se janë kontabilizuar dhe kapitalizuar në këtë llogari 5 (pesë) zëra shpenzimesh për investime nga ana e Bashkisë Përmet në shumën **144,456,959 lekë**:

- "Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet të favorizuara 2019, 2020, 2023", me vlerën gjithsej 45,380,213 lekë;
- "Rikualifikim i Qendrës së Qytetit fasadat, ndriçimi, lulishtja ne Qytet V.2018", me vlerën gjithsej 81,676,761 lekë;
- "Lyerje fasade", me vlerën gjithsej 2,275,273 lekë;
- Ndërtesë rezidenciale vila, me vlerën gjithsej 5,284,712 lekë;
- Gjelbërim mjedise publike 2016, me vlerën gjithsej 9,840,000 lekë.

Aktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Përmet. Këto zëra shpenzimesh në 5 (pesë) raste janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për shumën ***144,456,959 lekë*.** Këto regjistrime nuk plotësojnë kërkesat e pikës 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale", i përmirësuar, *"Aktivet afatgjata materiale (AAM) janë aktive materiale që: (a) përdoren nga njësia ekonomike për prodhimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve apo për t"ua dhënë me qira palëve të treta, ose përdoren për qëllime administrative, dhe (b) priten të përdoren në më shumë se një periudhë kontabël".*

Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me paragrafin 7, të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit Nr.5 (SKK5) i përmirësuar dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

Tabela nr 27

	Emërtimi	Vlera 2024	Shtesat 2025	Gjithsej
1.	***Rikualifikim i Qendrës se Qytetit fasadat, ndriçimi, lulishtja ne Qytet V.2018***	81,676,761		81,676,761
2.	***Projekte për përmirësimin e kushteve te banimit per komunitetet te favorizuara 2019, 2020, 2023***	38,422,946	6,957,267	45,380,213
3.	***Lyerje fasade***	2,275,273		2,275,273
4.	***Ndërtesë rezidenciale vila***	5,284,712		5,284,712
5.	***Gjelbërim mjedise publike 2016***	9,840,000		9,840,000
	Shuma			**129,332,247**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

2. Nga auditimi konstatohet se, një pjesë e objekteve ndërtimore janë të trashëguara dhe të mbartura nga ish/komunat në periudhat raportuese para vitit 2015 dhe të pa shoqëruara me kartelat përkatëse të objekteve.

- Nga ana e Bashkisë Përmet nuk është bërë një pasqyrim real dhe i drejtë në lidhje me vlerën e objekteve dhe gjendjen e tyre, pasi në shumicën e rasteve aty janë pasqyruar vetëm investimet e kryera gjatë viteve të fundit, dhe se në fakt vlerat e tyre janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të shkuara (para vitit 2000) dhe kjo tregon për mospërputhje të gjendjes

faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive..

3. Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Përmet ka në administrim **22 (njëzetë e dy)** banesa të llojit apartament të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara në pronësi të saj, me vlerë privatizimi **34,084,716 lekë** , nga të cilat me datën 31.12.2025 mbeten në pronës të kësaj Bashkie 20 (njëzetë) apartamente. Vlera e këtyre apratamenteve të regjistruara në ASHK për llogari rtë Bashkisë përmet nuk është përfshirë në llogarinë 212 «Ndërtime e rikonstruksione' dhe nuk janë përfshirë as në Regjstrin e Aktiveve të kësaj Bashkie.
Nga ana e bashkisë është procedura duke lidhur kontrata të shitjes me rezervë pa kalim pronësie për 16 apartamente, kurse për 4 apartamente nuk është realizuar lidhja ee kontratës së shitjes me rezervë me subjektet përfituese, në zbatim të vendimeve përkatëse të privatizimit.

4.Mungesa e pasqyrimit te vlerave reale të disa aseteve të Bashkisë.
- Bashkia Përmet, me krijimin e saj, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e ish-Komunave (të tilla si, harta topografike, planimetri të objekteve, koordinata të vendndodhjes së tyre, etj.). Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e aseteve të kësaj bashkie. *Bashkimi i aseteve nga ish-komunat, është realizuar nga bashkimi i vlerave te bilanceve të tyre, në të cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivit dhe pasivit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullta të vlerave të Aktiveve të Afatgjata Materiale dhe dhe Aktiveve Qarkulluese* .
Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Përmet rezulton se, mbi 22 (njëzetë e dy) aktive afatgjata/ pasuri që administrohen nga NJVQV, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të ndryshme kohore nga viti 1990 dhe kjo tregon për *<u>një pasaktësi në evidentimin e gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive, vlerësuar me çmimet e para viteve 1990</u>*. Nga titullari i Bashkisë, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit. dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk janë marrë masat e duhura për përmbushjen e kuadrit rregullator ligjor të regjistrimit të pronave dhe evidentimit të saktë në llogaritë përkatëse me vlerën e drejtë të tyre.
Sa më sipër, në kundërshtim me SKK nr.1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare – (i përmirësuar), Kreu "Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare", Paragrafi "Besueshmëria e matjes", pika 51, ku parashikohet se, "Kriteri i dytë për njohjen e një zëri është që kosto ose vlera që ai ka të mund të matet me besueshmëri. Në shumë raste, kostoja ose vlera e një zëri njihet. Në raste të tjera ajo duhet të vlerësohet. Përdorimi i vlerësimeve të arsyeshme është një pjesë thelbësore e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nuk dëmton besueshmërinë e tyre. Zëri nuk njihet në pasqyrat financiare, në rastet kur nuk mund të kryhet një vlerësim i arsyeshëm."

5. Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" (kosto historike) u konstatua se në këtë llogari, referuar analizës në nivel artikulli, vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit nuk janë shtuar vlerës së aktivit fillestar pas investimeve të kryera, për 5 (pesë) artikuj aktivesh në vlerën 37,962,272 lekë. Gjithashtu, në 2 (dy) raste është regjistruar në llogarinë 212 vetëm vlera e rikonstruksionit prej 99,454,045 lekë, pasi mungon vlera e mëparshme e aktivit, ndaj këto vlera nuk janë përcaktuar me emërtesa të plota dhe nuk janë të adresuara**.** Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të

Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1"Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" pika 2, klasa 2, "Aktivet afatgjata" dhe me Nomenklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik.

Më konkretisht, *nuk u është shtuar vlera e rikonstruksioneve këtyre aktiveve:* **Tabela nr 28**

1.	Konvikti Mejden , 2023	19,257,560
2.	Sistemi i ngrohjes konvikt	12,505,872
3.	Rikonstruksion i konviktit viti 2018	4,556,568
4.	Rikonstruksion i Qendrës Shëndetësore Kosinë	1,562,272
5.	Qendra shëndetësore Kosinë	80,000

Mungon vlera e godinës ku është kryer investimi dhe është regjistruar vetëm vlera e rikonstruksionit

1.	Rikonstruksion zyrat e bashkisë	5,791,458
2.	Rikonstruksion Shkolla e Mesme "Sami Frashëri" 2019 ,2020 , 2023	93,662,587

Në këto kushte, duke qenë se ka mospërputhje të dokumentacionit tekniko-administrativ për çdo objekt të llogarisë 212 "Ndërtesa e Konstruksione", nga Bashkia Përmet, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Burimeve Njerëzore, duhet që të bëhet hedhja në kontabilitet e objekteve dhe sipërfaqeve të regjistruara; saktësimi i objekteve, dokumentimi me kartelë objekti, inventarizimi fizik i objektit, si dhe rivlerësimi për secilin objekt. Për sa më sipër Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" nuk paraqet një pamje reale për pasqyrat financiare të vitit 2025.

- **Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore"** më datën 01.01.2025, e vlerësuar me koston historike është 1,457,307,172 lekë dhe e kontabilizuar në vlerën neto për 322,752,083 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 86,144,839 lekë, pakësime 0 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 1,150,692,693 lekë. Më datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 392,759,318 lekë.

Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 29 Lekë

Referenca	Nr.	Llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	1,457,307,172
	2	Amortizim i akumuluar	1,134,555,089
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	1,457,307,172
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	86,144,839
	5	Amortizim i shtesës	16,137,604
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,457,307,172
	5	Amortizim i akumuluar	16,137,604
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	392,759,318

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

Për sa trajtuar më sipër, u konstatua se, në gjendjen e mbetur më datë 31.12.2025, të llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në vlerën **29,697,904 lekë** është përfshirë vlera që i përket disa projekteve dhe supervizioneve, e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendjen fizike.

Të tjera	28,037,717
Supervizionet viti 2016	32,520
Projekt plane studime 2017	304,536
Supervizimet e vitit 2018	546,470
Supervizim 2021	21,000

Supervizim ujësjellësish	755,661

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet, Analiza e llogarive.

49	Rikonstruksion Guri i Qytetit, Lagjja Mejden	22,465,082
70	Ndriçimi i Gurit të Qytetit , viti 2017 dhe 2019	10,273,018

Zërat "Projekt plane dhe Studime" dhe "Supervizionet" e viteve 2016, 2018, 2021, duhet të ishin shpërndarë në aktivet përkatëse korresponduese. Gjithashtu, rezulton se nuk janë transferuar një numër zërash të kësaj llogarie për SHRUK Gjirokastër, meqenëse i përkasin ujësjellësit të transferuara. Këto vlera janë të trashëguara nga bilanci i ish-Komunave (në formë tabelore në programin Excel) dhe të pa analizuara, ndikojnë në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të aktiveve afatgjata materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit.

1	Ndërtim KUZ i Pacomit 2016	4,471,020
2	Rikonstruksion ujësjellësish rajonal 2020,2021,2023	1,028,057
3	Ndërtim ujësjellësi i Pacomit 2023	64,937,891
4	Supervizim ujësjellësish	755,661
	Etj.etj	

Nga auditimi evidentohet se disa projekte te realizuara qe mbahen ne llog 202 "Studime dhe projektime nuk janë bashkuar me aktivin përkatës në llogarinë 213 "Rrugë, rrjetë, vepra ujore":
llog 202 "Studime dhe projektime

Projekti i Urës Biovizhde	300,000		300,000
Projekti i Urës Psillotere	390,000		390,000
Projekti i Rruges Dracove	400,000		400,000

Llog 213 "Rrugë, rrjetë, vepra ujore":

135	Ura Dracove	500,000		500,000
136	Ura Biovizhde	23,730,566		23,730,566
10	Rruga Psillotere	1,299,610		1,299,610

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe pika 36 dhe Kreu III, pika 30.

Aktivet e ujësjellës kanalizimeve të pa transferuara tek Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër nga ana e Bashkisë Përmet

Nga auditimi i regjistrit të aktiveve për llogarinë 213 "Rrugë, rrjete, ujësjellësa", rezulton së janë transferuar për llogarit të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër nga ana e Bashkisë Përmet, në zbatim të VKB nr 100 datë 27.11.2024 vlera e rikonstruksionit tërrjetit të ujësjellësit rajon të fshatrave Kosinë, Bodar, Kutal, Frashër, *(Vërçisht, Gostomickë),Gjinkar, Petran, Rapckë (loti i parë), NJA Piskovë, Petran dhe Frashër, Bashkia Përmet.* Shuma e vlerës së investimit 91,408,845 lekë.
Rezultojnëtë patransferuara pë SHRUK Gjirokastër, kto zëra që janë gjendje me dt 31.12.2025 në llogarinë 213:

Rehabilitim I rrjetit te ujësjellësit dhe rrugët e brendshme fshati Piskove V.2018	20,847,575
Rikonstruksion ujësjellësish rajonal 2020,2021,2023	1,028,057
Ndërtim ujësjellës Pacomit 2023	64,937,891
Supervizim ujësjellësish	755,661

Në inventarin e llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultojnë **4 objekte në vlerën 87,569,184 lekë,** të cilat janë asete të ujësjellësit. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër Sha" , në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" Kreu II, pika 14; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, dhe VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura" kreu II pika 14,

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat, me vullnet të lirë, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, marrin masa për transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike të shoqërive aksionare ekzistuese te SKP-ja e krijuar me marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe planin kombëtar të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për riorganizimin e shoqërive ujësjellës kanalizime. Transferimi i veprimtarisë së parashikuar në këtë pikë bëhet me akt noterial, sipas formatit të parashikuar në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili, pas nënshkrimit nga shoqëritë përkatëse, bëhet pjesë e pasqyrave financiare dhe mbahet nga pala që i ka kaluar transferimi.

dhe lidhjes nr.3, të këtij vendimi, që parashikon "Objektin e kontratës"

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune"** më datën 01.01.2025, është evidentuar në vlerën neto 32,605,697 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 5,873,486 lekë, pakësime në vlerën 17,418,933 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 16,399,309 lekë ndërsa më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 30,327,759 lekë.

Tabela nr 30 **Lekë**

Referenca	Nr.	Llogaria 214 "Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	58,272,515
	2	Amortizim i akumuluar	25,666,818
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	32,605,697
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	5,873,486
	5	Amortizim i shtesës	8,151,424
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	17,418,933
	7	Amortizim nga pakësimet	17,418,933
	4	Kosto historike	46,727,068
	5	Amortizim i akumuluar	16,399,309
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	30,327,759

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

- **Llogaria 215 "Mjete transporti"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën neto 29,992,321 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 18,483,600 lekë, pakësime në vlerën 0 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 35,004,986 lekë. Më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 42,477,457 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 31 **lekë**

Referenca	Nr.	Llogaria 215 "Mjete transporti" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	58,998,843
	2	Amortizim i akumuluar	29,006,522
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	29,992,321
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	18,483,600
	5	Amortizim i shtesës	5,998,464
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	77,482,443
	5	Amortizim i akumuluar	35,004,986
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	42,477,457

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

- **Llogaria 218 "Inventar ekonomik"** më datën 01.01.2025, ka qenë në vlerën neto 10,162,710 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 6,556,495 lekë, pakësime në vlerën 19,302,689 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 18,687,058 lekë. Nga auditimi, më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet me kosto historike 33,373,721 lekë dhe në vlerën neto 14,686,663 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 32 **Lekë**

Referenca	Nr.	Llogaria 218 "Inventar ekonomik" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	46,119,915
	2	Amortizim i akumuluar	35,957,205
	3	**Gjendja në 01.01.2025**	10,162,710
	4	Shtesa gjatë vitit 2025 (D)	6,556,495
	5	Amortizim i shtesës	
	6	Pakësime gjatë vitit 2025 (K)	19,302,689
	7	Amortizim nga pakësimet	
	4	Kosto historike	33,373,721
	5	Amortizim i akumuluar	18,687,058
	6	**Gjendja më datë 31.12.2025**	14,686,663

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet

- **Llogaria 24 "Aktive të dëmtuara"** më datën 01.01.2025, ka rezultar sipas kostos historike 0 lekë dhe sipas vlerës neto 0 lekë. Gjatë vitit 2025 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa dhe pakësime. Amortizimi i akumuluar është në vlerën 0 lekë.

Nga auditimi i procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve u konstatua se njësia shpenzuese Bashkia Përmet rezulton se janë bërë vlerësimet e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Aktivet e dala nga përdormi u përkasin llogarive 214 dhe 218, si më poshtë:

36,142,472	**II. AAGJ/ MATERIALE**
16,839,783	Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune
19,302,689	Inventar ekonomik
36,142,472	**Shuma**

Për vlerat e aktiveve me kosto historike, nga ana e sektorit të financës është bërë shkarkimi nga kartelat e llogarive përkatëse bazuar në proces verbalet e komisionit të vlerësimit dhe nxjerrjes nga përdorimi.

AKTIVET FINANCIARE

- Llogaritë e aktiveve afatgjata financiare paraqiten në bilanc në vlerën 216,752,570 lekë në fillim dhe në fund të vitit 2025. Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", rezulton se më datë 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie paraqitet gjithë vlerën e aktiveve financiare:

3.Aktive Afatgjata Financiare	216,752,570	216,752,570

a. Nga auditimi rezulton se në datën 29/09/2022 është krijuar "**Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a**", e cila është regjistruar me datë 11/11/2022 me 8 aksionerë, 7 prej tyre nga organet e vetëqeverisjes vendore.

Referuar Statutit të "Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a", (protokolluar në AKUM me nr.1988 prot, datë 22.09.2022), kjo shoqëri ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkive, aksionarë të saj. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkive është:

a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
d) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
e) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Në nenin 3, pika 2 "Kapitali", përcaktohet se Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10,000,000 lekë dhe është i ndarë në 100.000 aksione me vlerë nominale 100 lekë secili"

Pika nr.2 e Statutit përcakton ndarjen e kuotave të aksioneve, "Aksionet zotërohen nga aksionaret:

- ✓ 1.Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zotëron 51.000 copë aksione me vlerë totale prej 5.100.000 lekë, ekuivalent në masën 51% te kapitalit themeltar;
- ✓ 2.Bashkia Gjirokastër zotëron 21,240 copë aksione me vlerë totale prej 2,124,000 lekë, ekuivalent në masën 21.24 % të kapitalit themeltar;
- ✓ 3.Bashkia Tepelenë zotëron 4,570 copë aksione me vlerë totale prej 457,000 ekuivalent në masën 4.57% të kapitalit themeltar
- ✓ 4.Bashkia Këlcyrë zotëron 2,810 copë aksione me vlerë totale prej 281,000 ekuivalent në masën në masën 2.81 % të kapitalit themeltar;
- ✓ 5***.Bashkia Përmet zotëron 7,650 copë aksione me vlerë totale prej 765,000 ekuivalent në masën në masën 7.65% të kapitalit themeltar;***
- ✓ 6.Bashkia Libohovë zotëron 2,460 copë aksione me vlerë totale prej 246,000 ekuivalent në masën në masën 2.46 % të kapitalit themeltar;
- ✓ 7.Bashkia Dropull zotëron 7,050 copë aksione me vlerë totale prej 705,000 ekuivalent në masën në masën 7.05 % të kapitalit themeltar;
- ✓ 8.Bashkia Memaliaj zotëron 3,220 copë aksione me vlerë totale prej 322,000 ekuivalent në masën në masën 3.22 %të kapitalit themeltar;

Edhe në ekstraktin historik të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a", përqindja e pjesëmarrjes në kapital e kësaj Bashkie është: 7,05 % të kapitalit themeltar

Vlera e aksioneve të Shoqëria Aksionare Ujësjellës Kanalizime Përmet, pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër me Nipt M.....1, që ka në pronësi Bashkia Përmet sipas Marrëveshjes "Për krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sh.a Gjirokastër është (7.65% * 10,000,000 lekë) = **765,000 lekë**).

Nga auditimet e mëparshme të ushtruara nga ana e KLSH-së në këtë bashki, janë evidentuar gjetje të ndryshme dhe janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësim, si vijon:

- ✓ Bashkia Përmet ***në vitin 2021*** në zbatim të gjetjes të lënë nga KLSH ka përfshirë në pasqyrat financiare vlerën 216 752 570 lekë në llogarinë 26 *" Pjesëmarrje në kapitalin e vet"* pasi Bashkia Përmet ka qenë aksioner i vetëm i Sh.A Ujësjellësit.

Pas ndryshimit të formës së organizimit dhe administrimit të ujësjellësve në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër me NIPT M.....L Bashkia Përmet i është drejtuar me shkresat nr.116 datë 12.01.2022, nr.2667 datë 06.10.2023, nr.343 datë 02.02.2024 dhe nr.957 datë 04.04.2024 Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër dhe për dijeni dhe AKUM për paraqitje dokumentacioni të vlerës së aksioneve që Bashkia Përmet ka, por nuk ka pasur asnjë kthim përgjigje apo përcjellje dokumentacioni nga këto institucione.Në mungesë të aktit të vlerësimit nga ekspertët e fushës Bashkia nuk kemi kryer sistemimet përkatëse në bilanc.

- ✓ Nga auditimi i kryer ***për vitin 2023***, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka evidentuar gjetjen e mëposhtme:

*"Nga auditimi i llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", u konstatua se, kjo llogari është mbivlerësuar në vlerën 20,017,100 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjellës Kanalizime Përmet me Nipt J.....I është 21,675,257 lekë, e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër me Nipt M.....L. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Përmet 1,658,157 lekë ose 7.65% (7.65*21,675,257/100=1,658,157 lekë).*
Ndërkohë që llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" më datë 31.12.2023, paraqitet ne vlerën 216,752,570 lekë (në ketë regjistrim nuk është marrë në konsideratë ndryshimi i vlerës së kapitalit te Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Përmet ku nga vlera 216,752,570 lekë aktualisht vlera e kapitalit ka shkuar në vlerën 21,675,257 lekë).

Bazuar në Marrëveshjen për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP) të Ujësjellës Kanalizimeve, neni 6 "Kontributi i palëve" pika 2, Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e aksionarëve në shoqërinë e re është përllogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktivë që këto shoqëri kanë deri në mbarimin e procesit të transferimit dhe më pas sipas pikës 5 të po këtij neni do të realizohej vlera e saktë e aksioneve në ***bazë të vlerësimit nga një ekspert kontabël***. Në mungesë të informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë, punonjësit e Bashkisë Përmet shprehen për pamundësinë e kryerjes së sistemimeve të vlerës që Bashkia ka të kontabilizuar, kur Bashkia Përmet kishte në zotërim 100%.

1. Kapitali fillestar për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a, është në masën 10.000.000 lekë. Në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901 datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me qëllim themelimin dhe regjistrimin e shoqërive të reja SKP-UK, MIE do të likuidojë vlerën e 51% të aksioneve që do të përfitojnë.
2. Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e aksionerëve në shoqërinë e re ujësjellës kanalizime (SKPUK) e Bashkive Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe Memaliaj në pronësi të të cilave janë aktualisht shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve është përllogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktive që këto shoqëri kanë duke përfshirë edhe kontratat aktive aktuale që administrohen nga vetë Bashkitë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKPUK, vlera totale e të cilave do të përbëjë 49% të aksioneve të shoqërisë se re, dhe përbëhet në përqindje si vijon: Bashkia Gjirokastër 21.24%, Bashkia Tepelenë 4.57%, Bashkia Këlcyrë 2.81%, Bashkia Përmet 7.65%, Bashkia Libohovë 2.46%, Bashkia Dropull 7.05% dhe Bashkia Memaliaj 3.22%.
3. Pas themelimit të shoqërisë së re SKP-UK, Bashkitë Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe Memaliaj do të transferojnë tek SKP-UK të gjithë veprimtarinë e shoqërive të UK, që kryejnë aktualisht veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në territoret administrative respektive në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".
4. Në Bashkitë Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe Memaliaj ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të

ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, brenda datës 31 dhjetor 2022, janë përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe transferimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sh.a.
5. Pasi procesi i transferimit të ketë përfunduar, përcaktimi i vlerës nominale të 51% të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, në Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër sh.a do të realizohet pasi vlera e saktë e aksioneve të përfituara të përcaktohen në bazë të raportit që do të hartohet nga eksperti kontabël që do të caktohet gjatë procedurave të transferimit.

- ✓ Nga auditimi i ushtruar ***në Bashkinë Përmet për vitin 2024*** është konstatuar se:

Bashkia Përmet referuar Ekstraktit të QKB -së është aksionere me 7.65% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a me Nipt M.....L, ose me 7,650 aksione me vlerë nominale 100 lekë/copa Kjo vlerë është përcaktuar referuar Marrëveshjes "Për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta te Ujësjellës Kanalizime (SKPUK) mes 7 Bashkive të Qarkut Gjirokastër dhe MIE.
Situacioni përfundimtar i punimeve të kryera në Ujësjellësin Përmet, i cili në periudhën e transferimit të kapitalit të UK Përmet-sha dhe krijimit të UKR Gjirokastër-sha ishte në proces, ende i papërfunduar është në vlerën totale 583,299,150.92 lekë:
DFB në llog. 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" të pasqyrave kontabël, ka regjistruar vlerën certifikuar të Shoqërisë audituese "H a." sh.p.k me ekspertë kontabël të miratuar në prill të vitit 2019, në Raportin e së cilës vlerësohet se kapitali i Shoqërisë UK Përmet -sha është në vlerën 216,752,570 lekë dhe zotërohet në masë të plotë 100% nga aksioneri Bashkia Përmet.

- ✓ Rekomandimi i lënë për këtë gjetje ishte: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit të marrë masa deri në mbyllje të ***vitit ushtrimor 2025***:

- Me mbylljen e llogaritjeve të kapitalit të ish UK Përmet pjesëmarrës në UK Rajonale Gjirokastër, të saktësohet dhe vlera e llog. 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet".
Nga auditimi rezultoi se nga ana e Bashkisë Përmet është vijuar me ndjekjen shkresore të kësaj çështjeje, ku ekziston një korrespondencë drejtuar SHRUK Gjirokastër (referojmë shkresat me nr.879 datë 04.03.2026 dhe 27.03.2026 drejtuar këtij subjekti, nga i cili nuk ka pasur përgjigje zyrtare deri më datë 31.03.2026 dhe sistemimi në kontabilitet nuk ka ndodhur për këtë llogari.

Vlera e raportuar nga KLSH që duhej të shtohej ishte 583,299,150.92 lekë ndërkohë që llogaria *"Pjesëmarrje në kapitale"* transferuar në SHRUK Gjirokastër rezulton në vlerën 583,637,584 lekë pra rreth 338,433.08 lekë më tepër.
Referuar korrespondencës shkresore rezulton se, SHRUK Gjirokastër dhe Asambleja e Përgjithshme kanë vendosur emërimin e një audituesi ligjor të pavarur për të kryer këtë proces për zmadhimin e kapitalit, i cili është duke vijuar.
Me anë të shkresës 697/1 prot., datë 09.04.2026, (protokolluar në Bashkinë Përmet me nr.1186/1, datë 16.04.2026), **SHRUK Gjirokastër** ka kthyer përgjigje por pa dokumentacion bashkëlidhur. Sipas kësaj shkrese, "llogaria "Pjesëmarrje në kapitale" është transferuar ne shoqërinë SHRUK Gjirokastër me datë 31.12.2022 në shumën 583,637,584 lekë, për projektin "Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Përmetit". Kjo vlerë përfaqëson investimin në kapitalin e shoqërisë Përmet duke përfshirë edhe efektet që rrjedhin nga PF të vitit 2022 të kësaj shoqërie. Duke filluar nga viti 2023, kjo pjesëmarrje është reflektuar në kuadër të strukturës së re organizative, si pjesë e një shoqërie rajonale. Procesi për zmadhimin e kapitalit është aktualisht në zhvillim dhe nuk ka përfunduar ende. Në këtë kuadër, Asambleja e Përgjithshme ka vendosur emërimin e një audituesi

ligjor të pavarur, i cili do të verifikoje dhe vlerësojë këtë proces në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatorë në fuqi".

Mos pasqyrimi i plotë dhe i saktë i vlerës së aktiveve financiare në kontabilitet, është veprim në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje", pika nr. 17:

Në lidhje me interesin e tij në një aktiv të kontrolluar bashkërisht, një sipërmarrës do të njohë në pasqyrat e tij financiare: ***(a) pjesën e tij në aktivet e kontrolluara bashkërisht, të klasifikuara sipas natyrës së ty****re; (b) të gjitha detyrimet që ai ka krijuar; (c) pjesën e tij në çdo detyrim të krijuar së bashku me sipërmarrësit e tjerë në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët; (d) të ardhurat nga shitja ose përdorimi i pjesës së tij në prodhimin e sipërmarrjes së përbashkët, së bashku me pjesën e tij në çdo shpenzim të bërë nga sipërmarrja e përbashkët; dhe (e) shpenzimet që ai ka kryer në lidhje me interesin e tij në sipërmarrjen e përbashkët.*

Kreun I, pika 3.1."Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", paragrafi nr. 31, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare paragrafi nr.62.

4. Investimet.

- **Llogaria 231 "Për aktive afatgjata materiale"** më datën 31.12.2025, ka qenë në vlerën 0 lekë, kurse teprica e kësaj llogarie në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë.

B. PASIVET (DETYRIMET)

I. Pasivet Afatshkurtra

1. Llogari të pagueshme

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Përmet më datën 31.12.2025, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2025, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.

Lekë

grupimi	Tipologjia e detyrimeve financiare	Balanca e vitit 2024	Balanca në fund të vitit 2025
I	**Pasivet Afat shkurtra**	**169,524,224.00**	**141,270,665.00**
	-Llogari te Pagueshme	65,915,518	49,038,374
	-Te tjera pasive afatshkurtra	103,608,706	92,232,291
II	**Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
	Pasivet (detyrimet) gjithsej	**169,524,224.00**	**141,270,665.00**

Burimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

Tabela nr 32:Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2025	Viti 2024	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	0	0	0
42	Detyrime ndaj personelit	16,850,307	18,993,686	-2,143,379
16,17,18	Hua afat shkurtra			
460	Huadhënës			
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,076,427	995,328	81,099
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal			
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore			
435	Sigurime shoqërore	4,982,959	4,653,227	329,732
436	Sigurime shëndetësore	686,795	645,761	41,034
437,438	Organizma të tjerë shtetërore			
44	Institucione të tjera publike			

45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike			
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë			
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	26197279	19881610	6,315,669
467	Kreditorë të ndryshëm	16,121,751	3,868,762	12,252,989
4341	Operacione me shtetin (detyrime)			
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)			
Gjendje në fund të periudhës		65,915,518	**49,038,374**	**16,877,144**

Burimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"** më datë 01.01.2025, është në vlerën 0 lekë dhe për të njëjtën vlerë pasqyrohet edhe më datë 31.12.2025, që do të thotë se Bashkia Përmet nuk ka fatura të pa likuiduara për vitin 2025.

- **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"** referuar pasqyrave financiare vlera 16,850,307lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2025 e cila mbetet për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2025	**18,993,686**
Shtesa (K)	16,850,307
Pakësime (D)	18,993,686
Gjendja kreditore në 31.12.2025	**16,850,307**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit që Bashkia Përmet ka kaluar gjatë muajit Janar të vitit 2026 në DTH, konstatohet se janë kryer këto likuidime të detyrimeve për personelin:

Tabela nr 33 **Lekë**

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
7	12.01.2026	711,669
8	12.01.2026	274,925
9	12.01.2026	743,261
10	12.01.2026	158,774
11	12.01.2026	1,319,622
12	12.01.2026	85,603
13	12.01.2026	374,177
14	12.01.2026	132,280
15	12.01.2026	73,882
16	12.01.2026	199,610
17	12.01.2026	1,061,204
18	12.01.2026	285,993
19	12.01.2026	2,547,428
20	12.01.2026	1,924,067
21	12.01.2026	386,403
22	12.01.2026	172,590
23	12.01.2026	197,022
24	12.01.2026	223,377
25	12.01.2026	253,721
26	12.01.2026	302,160
27	12.01.2026	579,247
28	12.01.2026	471,402
29	12.01.2026	32,465
30	12.01.2026	162,154
31	12.01.2026	46,210
32	12.01.2026	271,391
33	12.01.2026	42,430
34	12.01.2026	1,630,916
35	12.01.2026	315,072
36	12.01.2026	229,246
37	12.01.2026	99,105
38	12.01.2026	247,840
39	12.01.2026	612,498
40	12.01.2026	246,077

41	12.01.2026	271,810
51	02.02.2026	38,566
114	13.02.2026	126,110
Totali		**16,850,307**

Burimi i të dhënave: Bashkia P1rmet, Ditari i Bankës/ Thesarit, v.2026

- Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa", paraqitet në vlerën 1,076,427 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin Dhjetor 2025. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Degës së Thesarit të kaluara gjatë muajit Janar të vitit 2026, si më poshtë:

Lekë

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2025	995,328
Shtesa (K)	1,076,427
Pakësime (D)	995,328
Gjendja në 31.12.2025	**1,076,427**

Konkretisht, sipas dokumenteve të kaluara në Degën e Thesarit gjatë muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se janë kryer këto pagesa për këtë kategori detyrimesh:

Lekë

Nr.	**Datë**	
6	12.01.2026	1,076,427
Totali		**1,076,427**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet, Ditari i Bankës/ Thesarit, v.2026

- Llogaria 435 "Sigurime shoqërore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit 2026 dhe janë përkatësisht në vlerën 4,982,959 lekë.

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	4,653,227
Shtesa (K)	4,982,959
Pakësime (D)	4,653,227
Gjendja në 31.12.2025	**4,982,959**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
1	12.01.2026	1,897,828
2	12.01.2026	79,944
3	12.01.2026	3,005,187
Totali		**4,982,959**

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet, Ditari i Bankës/ Thesarit, v.2026

- Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2025 që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 686,795 lekë

Lekë

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2025	645,761
Shtesa (K)	686,795
Pakësime (D)	645,761
Gjendja në 31.12.2025	**686,795**

Konkretisht sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2026 konstatohet se:

Lekë

Urdhër shpenzimi		**Vlera**
Nr.	**Datë**	
4	12.01.2026	343,398
5	12.01.2026	343,397

Totali	**686,795**

Bashkia Përmet, Ditari i Bankës/ Thesarit, v.2026

- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje" sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë në fund të vitit 2025 paraqitet në vlerë 26,197,279 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Përmet sipas akt rakordimit dt 28.4.2026. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Çelje e vitit 2025	19,881,610
Shtesa (K)	10,105,158
Pakësime (D)	3,789,489
Gjendja debitore në 31.12.2025	**26,197,279**

Tabela nr 34 **Lekë**

Nr.	Objekti	Subjekti	Vlera	Ka kaluar afati (Po / Jo)
1	Rehabilitimi i rrjetit te ujësjellësit dhe rrugët e brendshme te fshatit Piskove	M.	1023573	ne proces gjyqësor për gjetje te KLSH
2	Ndërtim ujësjellësi Pacomit	I. K.	3190188	Po
3	Rikonstruksion shkolla" Nonda Bulka"	H. shpk	2943083	ne proces gjyqësor për gjetje te KLSH
4	Ngurtësim Vila e Pritjes	A. I	153000	Jo
5	Ngurtësime Banesat Piskove	N.	109338	Jo
6	Rikonstruksion Qendra Rinore	A.-CO	530224	Jo
7	Diga Pacomit	2.SHPK	2321699	Jo
8	Rehabilitim Kanali ujitës Piskove	S. SHPK	571974	Jo
9	Përmirësimin e kushteve te banimit për komunitete te favorizuara	A.	475608	Jo
10	Shkolla "Meleq Gosnishti"	Z.	5792726	Jo
11	Rik. Pallati i Sportit Përmet	L.	2249228	Jo
12	Blerje kondicioneri	A. Sh.	7250	Jo
13	Rik .Kanali Buhal	E.	2066624	Jo
14	Rehabilitim i rezervuarit Qilarisht	I. SHPK	1438103	Jo
15	Pallati i Sportit punime te jashtme	H.-94	377630	Jo
16	Rikonstruksion Rruga Qilarisht	K.	1631706	Jo
17	Blerje automjete	A. GMBH	480180	Jo
18	Blerje mjeti zjarrfikës	T.-R SHPK	336000	Jo
19	Rrethim i parcelës se varrezave	H.-94	154151	Jo
20	Përmirësimi i kushteve te banimit per komunitete te favorizuara	E.	344994	Jo
Totali			26,197,279	

Shënim: Për veprën që i ka kaluar afati "Rikonstruksion i Ujësjellësit të Pacomit" ka nisur procedura gjatë vitit 2025 por nuk ka përfunduar ende procesi për arsye të mos hartimit të certifikatës së marrjes së përhershme në dorëzim.

- Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm" paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2025, janë në vlerën në vlerën 3,868,762 lekë dhe në shumën 16,121,751 lekë më datë 31.12.2025.

467	Kreditorë të ndryshëm	16,121,751	3,868,762

Detyrimet ndaj kreditorëve janë në vlerën 16,121,751 lekë .Vlera prej 2,346,886 lekë janë vlera e energjisë elektrike per të cilën OSHEE pretendon se nuk është likuiduar nga Bashkia Përmet ne vitet 2007-2011,për të cilën Bashkia është në proces gjyqësor dhe me subjektin B. C. në vlerën 302,088 lekë për të cilin vijon procesi gjyqësor. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 35: Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" *(në lekë, dt 31.12.2025)* në lekë

Nr	Emri i subjektit	Objekti	Fatura	Shuma

1.	OSHEE	*ne proces gjyqësor*	*ne proces gjyqësor*	2346886
2.	B. C.	*ne proces gjyqësor*	*ne proces gjyqësor*	302088
3.	L.	Rik. Pallati i Sportit	23/2025 date 26.03.2025	1604316
4.	Z.	Rik.i shkollës "Meleq Gosnishti"	10/2025 date 22.12.2025	937607
5.	K.	Rik. Rruga Qilarisht	11/2025 date 15.12.2025	8681555
6.	T-R	Mjeti zjarrfikës	78/2025 date 19.11.2025	2160000
7.	F. S.	Kolaudim "Rehabilitim rezervuari Qilarisht"	48/2025 date 29.12.2025	89299
8.		Total		16,121,751

Burimi i të dhënave: Bashkia Përmet, Pasqyrat Financiare 2025.

AKTIVET NETO/FONDET NETO

-Nga auditimi i të dhënave mbi zërin **"Aktivet Neto"** (rreshti 96, kolona C e Formatit F1) del se është e kuadruar me zërin **"Fondi i Konsoliduar"** të asaj pasqyre për vitin 2025, prej 1,537,872,989 lekë, kurse për v.2024 aktivet neto janë të barazuara me fondin e konsoliduar prej 1,375,459,014 lekë, me një shtesë prej + 162,413,975 lekë.

Tabela nr 36 **Lekë**

Grupi	Emërtimi	2025	2024
C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	1,537,872,989	1,375,459,014
D	FONDI I KONSOLIDUAR :	1,537,872,989	1,375,459,014

Lekë

Grupi/llog.	Emërtimi	31.2.2025	31.12.2024
C	**AKTIVET NETO/FONDET (A-B)**	**1,537,872,989.00**	**1,375,459,014.00**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR**	**1,537,872,989.00**	**1,375,459,014.00**
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,433,250,604	1,265,815,707
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	104,622,385	109,643,307
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0

Po kështu, totali i aktiveve neto/ fondeve neto në çelje të vitit 2025 në Pasqyrën/formatin nr.4, "Pasqyra e ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto", (rreshti 20), është 1,375,459,014 lekë në fund tëv.2024, si dhe në shumën 1,537,872,989 lekë me dt 31.12.2025, vlerë kjo e barabartë me këtë grup të llogarive në Formatin nr.1. Sa më sipër, në përputhje me kërkesat e paragrafit 82, pika 3.6, "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", Kreu III, të Udhëzimit Nr. 8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton se,

Sipas rreshtave, në këtë pasqyrë financiare evidentohen:
Totali i fondeve të veta të kësaj pasqyre (Pasqyra financiare individuale e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto), duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar.

Referuar informacioni që shoqëron PFV nga Bashkia Përmet, Llogaria 101 "Fonde Bazë" është me vlerën 1,433,250,604 lekë. Janë pakësuar për konsumin e aktiveve të Qëndrueshme të vitit 2025 në vlerën 64,881,828 lekë, janë shtuar për vlerën 222,127,918 lekë për grande të brendshme

kapitale, të cilësuara në klasën 2 të aktivit të Bilancit kontabël. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike,

101	Teprica(Fondi i akumuluar) /Deficiti i akumuluar	1,433,250,604	1,265,815,707

Në lekë

Burimi: Bashkia.Përmet, PFV, Formati F4.

Tabela nr 37 **Lekë**

Fndi i konsoliduar 2024	**Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"**			
1,375,459,014	**Mbyllje më datë 31.12.2025**		**Çelje më datë 01.01.2025**	
	Debi		**Kredi**	
			1,265,815,707	Çelja gjendja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* i datës 31.12.2024
	36,721,622	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	222,127,918	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	63,317,655	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	8,624,634	Llogaria 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*
	0	Vlera kontabël neto e Aktive e dal jashtë përdorimit (36,721,622 -36,721,622)	36,721,622	Amortizimi i pakesimeve (nxj. jashtë përdorimit)
Totali	100,039,277		1,533,289,881	
1,533,289,881 - 100,039,277 = 1,433,250,604				
1,433,250,604 - 1,433,250,604 = **0**				

Burimi: Bashkia Përmet, PFV, Përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Çelja e llogarisë 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* më datë 01.01.2025, paraqitet në vlerën 1,265,815,707 lekë.
-Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* <u>kreditohet për</u> shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* në vlerën 222,127,918 lekë, për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 8,624,634
lekë sipas llogarisë 63 *"Ndryshimi i gjendjes së inventarit"* dhe amortizimin nga vlerat e nxjerra jashtë përdorimit në vlerën 36,721,622 lekë.
-Llogaria 101 *"Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"* <u>debitohet për</u> pakësimit e vitit në vlerën 36,721,622 lekë, amortizimin e vitit ushtrimor 2025 në vlerën 63,317,655 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b *"Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)"* dhe vlerën neto të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit prej 0 lekë.

Nga auditimi i informacionit kontabël të lidhur me llogaritë financiare të "Fondeve Bazë" (llog.101, rezultoi: Këto veprime janë në pajtueshmëri me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 17, ku përcaktohet që:

17. Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve që prekin llogaritë e pozicionit financiar (bilancit) ndiqet procedura e mëposhtme:
a) Llogaria 101 e klasës 1 funksionon si më poshtë:
Kreditohet për shtesat në fondet bazë që vijnë nga:

- *grantet kapitale për aktivet afatgjata të blera dhe të kapitalizuara;*
- *grantet kapitale që vijnë nga dhurimet në natyrë të aktiveve afatgjata;*
- *rivlerësimet në shtesë të aktiveve afatgjata;*
- *anulimet e detyrimeve për t'u paguar; si dhe*
- *të tjera.*

b) Debitohet për pakësimet në fondet bazë që vijnë nga:

- *shitja e aktiveve afatgjata, të vlerësuara me koston historike të blerjes së tyre*
- *nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata;*
- *transferimet e dhurimet e aktiveve afatgjata;*
- *konsumi i aktiveve afatgjata;*
- *rivlerësimet në pakësim të aktiveve afatgjata; si dhe*
- *anulimet e të drejtave për t'u arkëtuar;*
- *të tjera.*

dhe Udhëzimin e MF nr. 5, dt. 21.02.2022, Aneksi 1"Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)", Kreu 1.1 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i klasës l" :

Funksionimi i llogarisë 101 është si më poshtë vijon:

a) Llogaria 1011 "Shtesa të fondit baze" <u>*kreditohet për:*</u>

- Vlerën e aktiveve të blera apo të krijuara në njësinë e qeverisjes së përgjithshme *(për aktivet e marra në dorëzim)* me kundërparti debitin e llogarive përkatëse të burimeve (105, 106 dhe 115).
- Mbetjen kreditore të llogarisë 116 "Të ardhura nga shitja e AAGJ" me kundërparti debitin e kësaj llogarie.
- Shumat që rezultojnë me tepricë inventari në debi të llogarive përkatëse të grupeve 20 e 21 të aktiveve afatgjata.

b) Llogaria 1012 "Pakësime të fondeve bazë" <u>*debitohet për:*</u>

- Mbetjen debitore në fund të vitit të llogarisë 116 "Të ardhura nga shitja e AAGJ", me kundërparti kreditin e kësaj llogarie.
- Shumat që rezultojnë me mungesë inventari në kredi të llogarive përkatëse të grupeve 20 e 21 të aktiveve afatgjata.

c) Llogaria 1013 "Pakësim fondesh nga amortizimi i AAGJ" merr në debi amortizimin vjetor të aktiveve afatgjata me kundërparti kreditin e llogarive 209 e 219 të Aktiveve Afatgjata.

d) Llogaria 1014 "Pakësime fondi nga shitja e AAGJ" merr në debi vlerën kontabël neto (VKN) për aktivet që shiten nga institucioni me kundërparti llogaritë përkatëse të grupit 20 e 21 të Aktiveve Afatgjata.

e) Llogaria 1015 "Pakësime fondi nga nxjerrja jashtë përdorimit të Aktiveve Afatgjata" merr në debi vlerën kontabël neto (VKN) për AAGJ që dalin jashtë përdorimit me kundërparti llogaritë përkatëse të grupit 20 e 21 të Aktiveve Afatgjata.

f) Llogaria 1016 "Pakësim fondi nga transfertat brenda e jashtë sistemit të AAGJ" merr në debi vlerën kontabël neto (VKN) për transferimin pa pagesë të aktiveve afatgjata që bën institucioni tek të tretët me kundërparti llogaritë përkatëse të grupit 20 e 21 të Aktiveve Afatgjata.

Provizionimi i rreziqeve dhe shpenzimeve:

Konstatim*: N*ga ana e Bashkisë Përmet nuk janë llogaritur provizione për shpenzime e rreziqe, në një kohë që institucioni është në proces gjyqësor në shkallën e dytë për 3 (tre) vendime gjyqësore dhe vlera e tyre sipas shkallës së parë është 4,880,824 lekë. *Më hollësisht* **,**

- Paditës: OE "H" shpk, që sipas Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.8-86-2025-59) date 23.01.2025 ku është vendosur detyrimi i Bashkisë për pagimin e shumës 4,533,109 lekë;
- Paditës: OE "A." sha, që sipas Vendimit të Gjykatës Apelit Gjirokastër nr.20-2019-288/131 date 04.04.2019, ku është vendosur detyrimi i Bashkisë për pagimin e shumës 328,035 lekë;
- Paditës: zj. I. A., që sipas Vendimit të Gjykatës së Apelit nr.778 date 12.05.2025 është vendosur detyrimi i Bashkisë për pagimin e shumës 19,680 lekë;

Sa më sipër, në kundërshtim me paragrafin 34, të Kreut III "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", të UMF nr.8, datë 09.03.2018 i ndryshuar:

Provizionet për shpenzime janë ngjarje të ndodhura, të cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për t'u paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha ***vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit.*** Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë nëse:

- Njësia ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv), si rezultat i një ngjarjeje të ndodhur;
- Është e mundur që një dalje e burimeve ekonomike të jetë e nevojshme për të përmbushur detyrimin; si dhe
- Mund të bëhet një parashikim i besueshëm mbi vlerën e detyrimit.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për provizionet të bëhen si më poshtë:

a) Në momentin e njohjes së provizionit kryhen këto regjistrime:
- Debitohet llogaria 683, "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"; dhe
- Kreditohet llogaria 150, "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime".

b) Në momentin e përdorimit apo të pakësimit të provizionit kryhen këto regjistrime:
- Debitohet llogaria 150, "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"; dhe
- Kreditohet llogaria 785, "Përdorim i shumave të parashikuara për shpenzime të viteve të ardhshme".

-Nga auditimi i **llog. 85 "Teprica ose deficiti i periudhës/ rezultati i veprimtarisë së periudhës**" rezulton se, në fund të v.2024 dhe 2025 të dhënat e llogarisë në F1 dhe F2 përputhen për vlerat e tyre të regjistruara, (përkatësisht 109,643,307 lekë në F2 dhe lekë në F1 në fund të vitit 2024 dhe 104,622,385 lekë në F2 dhe lekë në F1 në fund të vitit 2025),

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 104,622,385 lekë, të rakorduara me degën e Thesarit më dt 04.02.2026, (fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2026), *kuadrojnë* me tepricën kreditore të llog.85 "Rezultat i veprimtarisë ushtrimore", në rreshtin 100, grupi D "Fondi i konsoliduar" i Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Sa më sipër në përputhje me paragrafin 57 të Kreut III, të UMF nr 8/2018 i ndryshuar:

*57. Pas përfundimit të të gjitha veprimeve të mbylljes, sipas procedurës së mësipërme, llogaria 85, "Rezultati i veprimtarisë ushtrimore" përfaqëson, si tepricë kreditore, rezultatin financiar pozitiv nga funksionimi, që rrjedh kryesisht nga të ardhurat që njësisë i mbeten (sipas dispozitave ligjore përkatëse), **për t'u trashëguar në vitin ushtrimor pasardhës**. Ndërsa, si tepricë debitore, kjo llogari përfaqëson rezultatin negativ nga aktiviteti i funksionimit, për të cilin duhet të jepen sqarime në shënimet shpjeguese.*

F1:

85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	104,622,385	109,643,307

F2:

85	Teprica ose deficiti i periudhës *(Rezultati i veprimtarisë se vitit ushtrimor)*	104,622,385	109,643,307

Llogaria 85 paraqitet në seksionin C të pasqyrës së pozicionit financiar (F1), si pjesë e aktiveve neto / fondeve neto. *Sa më sipër*, në përputhje me kërkesat e paragrafit 71, pikës 3.4, "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të performances financiare", Kreu III, të Udhëzimit Nr.8, datë 9.3.2018, i ndryshuar, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, që përcakton se,

Rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor të mbyllur, i paraqitur në rubrikën C të pasqyrës së performancës financiare, duhet të jetë detyrimisht i barabartë me zërin rezultati i veprimtarisë ushtrimore (llogaria 85), që evidentohet në rubrikën C, të aktiveve neto/fondeve neto në pasqyrën e pozicionit financiar.

Formati nr. 2. Pasqyra e Performancës Financiare:

TË ARDHURAT

1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- Llogaria 70 "Të ardhurat nga taksat e tatimet", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën **26,330,811** lekë, ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie është **43,044,094** lekë ose me një rritje në vlerën + 16,713,283 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 38.

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
70	**I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME**	**43,044,094**	**26,330,811**
700	**1. Tatimi mbi të ardhurat**	**6,047,677**	**5,203,752**
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	6,003,927	5,050,164
7001	Tatimi mbi fitimin	43,750	153,588
7002	Tatim mbi biznesin e vogël		
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat		
702	**2. Tatimi mbi pasurinë**	**13,340,588**	**9,387,512**
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	13,330,704	9,069,742
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	9,884	317,770
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë		
703	**3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit**	**23,655,829**	**11,739,547**
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Taksë mbi shërbimet specifike		
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	23,655,829	11,739,547
704	**4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare**	**0**	**0**
7040	Taksë doganore për mallrat e importit		
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë		
7049	Të tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
705	**5. Taksë e rrugës**		
708	**6. Të tjera tatime e taksa kombëtare**		
709	**7. Gjoba e kamatë vonesa**		

Burimi: Bashkia Permet

2. Të ardhurat jo tatimore:

- Llogaria 71 "Të ardhura jo tatimore", në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 22,890,226 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 27,579,159 lekë, ose me një shtesë

në vlerën +4,688,933 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 38 **Lekë**

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
71	**III. TË ARDHURA JO TATIMORE**	**27,579,159**	**22,890,226**
710	**1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia**	**5,075,705**	**3,243,476**
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare		
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare		
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	5,075,705	3,243,476
711	**2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare**	**22,503,454**	**19,646,750**
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	17,790,102	15,610,596
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1,352,267	1,905,444
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale		
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	2,280,610	1,999,610
7114	Të ardhura nga biletat		
7115	Gjoba, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	1,080,475	131,100
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
719	**3. Të tjera të ardhura jo tatimore**		

3. Grante korente:

- **Llogaria 72 "Grante korente",** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 462,246,026 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie rezulton 458,818,079 lekë ose me një pakësim në vlerën -3,427,947 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 39 **Lekë**

Llogaria	Emërtimi	31.12.2025	31.12.2024
72	**V. GRANTE KORENTE**	**458,818,079**	**462,246,026**
720	**1. Grant korent i brendshëm**	**458,818,079**	**462,246,026**
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	345,985,343	343,897,651
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)		0
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti (ISSH e ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	6,964,859	6,282,438
7205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	104,622,385	109,643,307
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	1,245,492	2,422,630
7209	Të tjera grante korente të brendshme		
721	**2. Grant korent i huaj**	**0**	**0**
	Nga Qeveri të Huaja		
	Nga Organizata Ndërkombëtare		

4. Të ardhura të tjera:

- **Të ardhura të tjera** në datën 31.12.2024, ka qenë në vlerën 0 lekë ndërsa në datën 31.12.2025, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 0 lekë.

SHPENZIMET

a.Analiza e shpenzimeve faktike kundrejtë planit vjetor të miratuar nga KB

Tabela nr 40 **Lekë**

Nr.	Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia për vitin 2025				Në lekë				
					Burimi i financimit të shpenzimit				
	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar		
							Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta kushtëzuar specifike kap 02+06	Nga transfertae kushtëzuar për funksionet e deleguara & projektet me kap 02 e 06
	Paga 600	259143201	233,314,306	90	27679323	12	137800806		67834177

	Sigurime shoqërore 601	41663999	38,351,869	92	238567	1	26669602		11443700
	ShP. Operat 602	80889354	58,243,348	72	11404350	20	26944921		19894077
	604	7170000	6,502,521	91	2877133	44	2625388		1000000
	606	9300251	7,390,029	79	1726084	23	2855020		2808925
	609	2864000							
	230	3955358	1148486	29			1148486		
	231	154564654	81755106	53	42494281	52	13072892		26187933
	Totali buxhet (I)	559,550,817	426,705,665	76	86419738		211117115		129168811
	Gjendja Civile (600)	4944868	4853988	98				4853988	
	Gjendja Civile(601)	864666	810616	94				810616	
	Ministri linje (602)	1784707	1686642	95				1686642	
	K. Q Emergjenca Civile 604	838800	528000	63				528000	
	Nd/Ekonom invalid 606	86415644	81985462	95				81985462	
	Investime 231	128213243	126710645	99				126710645	
	Totali nga i kushtëzuari(II)	223061928	216575353	97				216575353	
	Totali I+II	782,612,745	643,281,018	82				216575353	

Burimi: Bashkia Përmet, përgjigjet e pyetësorit mbi PFV

Nga krahasimi i shpenzimeve të realizuara përgjatë vitit 2025 konstatohen diferenca me planifikimin fillestar sipas parashikimit të bërë në fillim të vitit nga institucioni konkretisht të realizuara në llogaritë shpenzime operative, transferime korrente të brendshme, transferime për buxhete familjare dhe individë dhe investime. Të gjitha diferencat e paraqitura në llogaritë e mësipërme janë në tejkalim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor.

Analiza e shpenzimeve sipas artikujve të buxhetit:

- *Artikulli 600 "Paga"* është planifikuar në vlerën 259,143 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 233,314 mijë lekë ose në masën 90%, e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 27,679 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 137,801 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara dhe projektet me kap. 02 e 06 në vlerën 67,834 mijë lekë.
- *Artikulli 601 "Sigurime shoqërore"* është planifikuar në vlerën 41,664 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 38,352 mijë lekë ose në masën 92%, e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 239 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 26,670 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara dhe projektet me kap. 02 e 06 në vlerën 11,444 mijë lekë.
- *Artikulli 602 "Shpenzime operative"* është planifikuar në vlerën 80,889 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 58,243 mijë lekë ose në masën 72%, e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 11,404 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 26,945 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara dhe projektet me kap. 02 e 06 në vlerën 19,894 mijë lekë.
- *Artikulli* 604 *Transferime korente te brendshme* është planifikuar në vlerën 7,170 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 6,503 mijë lekë ose në masën 91%, e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 2,877 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 2,625 mijë lekë; dhe nga

transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara dhe projektet me kap. 02 e 06 në vlerën 1,000 mijë lekë.

- *Artikulli 606 Transferime per Buxhetet familjare e Individe* është planifikuar në vlerën 9,300 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 7,390 mijë lekë ose në masën 79%, e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 1,726 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 2,855 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara dhe projektet me kap. 02 e 06 në vlerën 2,809 mijë lekë.
- Artikulli 230 është planifikuar në vlerën 3,955 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,148 mijë lekë ose në masën 29%, e financuar tërësisht nga transferta e pakushtëzuar.
- Artikulli 231 "Investime" është planifikuar në vlerën 154,565 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 81,755 mijë lekë ose në masën 53%, e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 42,494 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 13,073 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara dhe projektet me kap. 02 e 06 në vlerën 26,188 mijë lekë.
- Totali i buxhetit vendor është planifikuar në vlerën 559,551 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 426,706 mijë lekë ose në masën 76%, e përbërë nga të ardhurat e veta në vlerën 86,420 mijë lekë; nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 211,117 mijë lekë; dhe nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara dhe projektet me kap. 02 e 06 në vlerën 129,169 mijë lekë.
- Artikulli 600 "Paga" për funksionin e gjendjes civile është planifikuar në vlerën 4,945 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 4,854 mijë lekë ose në masën 98%, i financuar nga transferta e kushtëzuar specifike.
- Artikulli 601 "Sigurime shoqërore" për funksionin e gjendjes civile është planifikuar në vlerën 865 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 811 mijë lekë ose në masën 94%, i financuar nga transferta e kushtëzuar specifike.
- Artikulli 602 "Shpenzime operative" për ministritë e linjës është planifikuar në vlerën 1,785 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,687 mijë lekë ose në masën 95%, i financuar nga transferta e kushtëzuar specifike.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika 1.3 gërma "c" dhe "ç", Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore"; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse.

b.Analiza e shpenzimeve vjetore sipas zërave

Referuar pasqyrave financiare të llogaridhënies vjetore 2025 niveli i shpenzimeve gjithsej është 442,291 mijë lekë, nga 407,004 mijë lekë që paraqitej me datën 31.12.2024 për Bashkinë Përmet**.**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

Llogaria 600 *"Pagat dhe përfitimet e punonjësve"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 201,003,503 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 238,168,294 lekë ose me një rritje në vlerën 37,164,791 lekë.

-*Llogaria 6001 "Paga personel i përhershëm"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 200,248,809 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 238,168,294 lekë ose me një rritje në vlerën 37,919,485 lekë.
-*Llogaria 6003 "Shpërblime"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 754,694 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 kjo llogari nuk paraqet gjendje, ose me një pakësim në vlerën 754,694 lekë.
Llogaria 601 *"Kontribute të sigurimeve"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 33,109,763 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 39,162,485 lekë ose me një rritje në vlerën 6,052,722 lekë.
-Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Përmet me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr 41 **Lekë**

600	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**238,168,294**	**201,003,503**
6001	Paga, personel I përhershëm	238,168,294	200,248,809
6002	Paga personel I Përkohshëm		
6003	Shpërblime		754,694
6009	Shpenzime te tjera për personelin		
601	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**39,162,485**	**33,109,763**
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	39,162,485	33,109,763
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore		

Burimi: Bashkia Përmet

2. Blerje mallra dhe shërbime:
Kjo llogari përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së Bashkisë.
Llogaria 602 *"Blerje mallra e shërbime"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 66,553,964 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 59,929,990 lekë ose me një pakësim në vlerën 6,623,974 lekë.

- *Llogaria 6020 "Materiale zyre e të përgjithshme"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 1,254,385 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 1,492,211 lekë ose me një rritje në vlerën 237,826 lekë.
- *Llogaria 6021 "Materiale dhe shërbime speciale*" në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 6,958,358 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 6,818,882 lekë ose me një pakësim në vlerën 139,476 lekë.
- *Llogaria 6022 "Shërbime nga të tretë"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 12,264,764 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 12,231,588 lekë ose me një pakësim në vlerën 33,176 lekë.
- *Llogaria 6023 "Shpenzime transporti"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 16,718,446 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 14,161,739 lekë ose me një pakësim në vlerën 2,556,707 lekë.
- *Llogaria 6024 "Shpenzime udhëtimi"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 4,800,324 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 6,000,072 lekë ose me një rritje në vlerën 1,199,748 lekë.
- *Llogaria 6025 "Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme*" në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 2,192,160 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 1,421,280 lekë ose me një pakësim në vlerën 770,880 lekë.

- *Llogaria 6027 "Shpenzime për detyrime për kompensime legale"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 11,488,491 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 575,899 lekë ose me një pakësim në vlerën 10,912,592 lekë.
- *Llogaria 6029 "Shpenzime të tjera operative"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 10,877,036 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 17,228,319 lekë ose me një rritje në vlerën 6,351,283 lekë.

Tabela nr 42 **Lekë**

602	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**59,929,990**	**66,553,964**
602	Mallra dhe sherbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,492,211	1,254,385
6021	Materiale dhe sherbime speciale	6,818,882	6,958,358
6022	Sherbime nga te trete	12,231,588	12,264,764
6023	Shpenzime transporti	14,161,739	16,718,446
6024	Shpenzime udhetimi	6,000,072	4,800,324
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	1,421,280	2,192,160
6026	Shpenzime per qeramarrje		
6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale	575,899	11,488,491
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
6029	Shpenzime te tjera operative	17,228,319	10,877,036

Burimi: Bashkia Përmet

3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Përmet nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2025 deri më 31.12.202.

4. Transferime korente:

Llogaria 604 *"Transferta korente të brendshme"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 7,495,954 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 7,030,521 lekë ose me një pakësim në vlerën 465,433 lekë.

- *Llogaria 6040 "Transferta korente tek nivele të tjera të qeverisë"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 200,000 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 190,000 lekë ose me një pakësim në vlerën 10,000 lekë.
- *Llogaria 6044 "Transferta korente tek organizatat jofitimprurëse"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 7,295,954 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 6,840,521 lekë ose me një pakësim në vlerën 455,433 lekë.

Llogaria 606 *"Transferta për buxhetet familjare dhe individë*" në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 93,660,572 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 89,375,491 lekë ose me një pakësim në vlerën 4,285,081 lekë.

- *Llogaria 6061 "Transferta paguara nga institucione të tjera dhe organe të pushtetit vendor"* në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 93,660,572 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja e kësaj llogarie është 89,375,491 lekë ose me një pakësim në vlerën 4,285,081 lekë.

Lekë

604	**1.Transferime korente te brendshme**	**7,030,521**	**7,495,954**
6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	190,000	200,000
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetsore		
6044	Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse	6,840,521	7,295,954

Burimi: Bashkia Përmet

Totali i shpenzimeve në datën 31.12.2024 ka qenë në vlerën 407,004,811 lekë, ndërsa në datën 31.12.2025 gjendja totale e shpenzimeve është 442,291,415 lekë ose me një rritje në vlerën 35,286,604 lekë.

- **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Nga verifikimi i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe në programin kompjuterik Microsoft excel. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
- Janë mbajtur të dhëna për aktivet (për një pjesë të tyre), në shumë raste mungon viti i krijimit (për aktivet e trashëguara nga ish komunat) si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por *nuk është mbajtur një libër si pjesë e dokumentacionit kontabël të mirëfilltë me të gjitha të dhënat historike të aktiveve afatgjata materiale, sipas modelit klasik të trajtuar më lart*, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 30.
- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Mbajtja e regjistrit të aktiveve.

U auditua evidenca kontabël dhe mbajtja e të dhënave lidhur me aktivet afatgjata materiale e jomateriale, si dhe ato afatshkurtra rezultoi se, nga ana e Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ishte hartuar dhe depozituar në dosjen e PFV të v.2025. Në këtë dokument janë regjistruar të dhënat mbi emërtimin e aktivit, koston fillestare dhe shtesa e pakësime, por nuk ka të dhëna per amortizmin dhe vlerën e mbetur të aktivit me dt. 31.12.2025.

Ky dokument ka filluar të hartohet nga ana e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, e cila është krijuar si Drejtori më datë 01.01.2025. Pjesë e kësaj drejtorie janë :

- ✓ Sektori i Tatim Taksave Aseteve dhe Licencave
- ✓ Sektori i Bujqësisë dhe Turizmit

Nga auditimi rezulton se, nga ana e Sektorin e Aseteve janë ndërmarrë këto masa e veprime për krijimin e databazave të regjistrit të aktiveve, dhe ndjekur sa vijon:

- ✓ Janë hedhur në format exel pasuritë e transferuara me vendime të Këshillit të Ministrave, për Bashkinë Përmet dhe katër njësitë e tjera administrative.
- ✓ Ka filluar puna për hedhjen në regjistra të të gjitha pronave që janë në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Përmet. Aktualisht konstatohet se, është krijuar regjistri me pronat e njësisë Administrative Përmet dhe Piskovë dhe po punohet për regjistrin e pronave të NJA Petran.
- ✓ Sipas Urdhër nr.479,datë 10.11.2025,të kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës për verifikimin në terren i të gjithë pronave, gjendjen faktike dhe juridike, për t'u bërë përditësimi i inventarit të pasurive në përputhje me gjendjen reale dhe pajisjen e tyre me certifikata pronësie, duke reflektuar ndryshimet nga legalizime, privatizime, kthime/ kompensime apo vendime gjyqësore.
- ✓ Ka filluar verfikimet në terren të pasurive sipas blloqeve kadastrale, të transferuar me VKM përkatëse për çdo njësi administrative, duke i rakorduar me të dhënat e ASHK-së

Vlen të përmendet se deri në datën e mbajtjes së raportit të auditimit nuk ka një regjistrim të plotë të aseteve të Bashkisë Përmet, e kushtëzuar edhe nga fakti se ka ndryshim të sipërfaqes dhe llojit të pronave, ndërmjet atyre që janë transferuar me VKM përkatëse, krahasuar me ato që janë regjistruar në ASHK.

Për sa më sipër rezulton se, kjo Bashki është në hapat e parë të krijimit të regjistrave të aseteve dhe këto janë në formate Excel duke mos garantuar një sistem të unifikuar, ashtu siç sot kanë Sektorët e Financiarë.


Tabela nr 43 **Lekë**

Regjistri i aktiveve 2025, Administrata Përmet *(fragment)*

	Lloji I pronës	Emri I pronës	(m2) Sip totale	Çmimi lek	Vlera	Shtesa	Pakesime	Total	Vlera amortizimit	Vlera mbetu
1	Administrate				9057565			9057565		
2	Kulture+Sport				108195283	13353953		121549236		
3	Shendetesi				457			457		
4	Varezat				6513812	3517451		10031263		
5	Strehim+Mbrojtje Civile				675			675		
6	Sherbime Sociale				1044			1044		
7	Infrast. Sherbime Publike				146472780	6957267		153430047		
9	Arsim				320058568	79888458		399947026		
	TOTALI				**590300184**	**103717129**		**694017313**		
	Infrast+troje sheshe				157031663			157031663		
	Infrast rrugore				205351561			205351561		
	Totali				**362383224**			**362383224**		
					1542983592	207434258		**1388034626**		

Burimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Bujqësisë

Regjistri i aktiveve 2025, NJA Piskovë



Nr	Lloji I pronës	Emri I pronës	Sip totale (m2) Sip totale (m2)	Çmimi lek	viti nderti	Vlera fillestare	Shtesa	Pakesim	Total	Vl Ar im
212	**Ndertesa**									
1	Administrata	ndertesa				11818356			11818356	
2	Kultura	ndertesa				29896			29896	
3	Arsimi	ndertesa				43860353			43860353	
4	Shendetsi	ndertesa				6031441			6031441	
5	Varreza					14812			14812	
	Total					**61754858**			**61754858**	
213	rruge rrjete etj									
1	Sheshe					148747			148747	
2	Rruge					99314308			99314308	
3	Ujesjellesa					71192629			71192629	
4	Ujitje kullim					129898713			129898713	
5	Lera pyjore					33456848			33456848	
6	Ndricimi					1664934			1664934	
	TOTAL					**335676179**			**335676179**	

Burimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Bujqësisë

Konstatim:

Nga ana e Bashkisë Përmet nuk është kryer kontabilizimi i të gjithë pronave publike në pronësi të saj dhe të regjistruara në ASHK.

a. Nga ana e Bashkisë Përmet deri në fund të vitit 2025 janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, **3,126** zëra të pasurive të marra në pronësi, me emërtime të ndryshme si, ndërtesa, sheshe, truall, etj, por që nuk janë përfshirë në regjistrin e aseteve dhe si të tilla, të pa kontabilizuara në inventarin e AAGJ të kësaj bashkie.

Kontabilizimi **me vlerë simbolike 1 (një) lek** përdoret zakonisht për asete që dhe janë amortizuar plotësisht, por janë ende në përdorim, ose për transferime asetesh me vlerë të papërfillshme materialiteti. *Kjo shënon mbajtjen e asetit në inventar për qëllime kontrolli*, pa ndikuar në pasqyrat financiare, shpesh duke debituar llogarinë e shpenzimeve dhe kredituar arkën/bankën.

b. Nga përgjigja e pyetësorit të dërguar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, evidentohet se janë **22 apartamente në pronësi të Bashkisë Përmet, që nuk rezultojnë** të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve (analiza e llogarisë 212)

Tabela nr 44 **Lekë**

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
							Truall	Ndert
	Përmet							
1	*Apartament*	2917	*25/80+1-8*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		88.6
2	*Apartament*	2917	*28/55+1-10*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		83.5
3	*Apartament*	2917	*25/80+1-3*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		*87.4*
4	*Apartament*	2917	*28/55+1-3*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		*84.2*
5	*Apartament*	2917	*28/55+1-15*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		*84.2*
6	*Apartament*	2917	25/80+1-1	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		87.4
7	*Apartament*	2917	*25/80+1-10*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		88.6
8	*Apartament*	2917	*25/80+1-3*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		87.4
9	*Apartament*	2917	*25/80+2-10*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		87.1
10	*Apartament*	2917	*25/80+2-3*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		88.7
11	*Apartament*	2917	*25/80+2-4*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		87.4
12	*Apartament*	2917	*25/80+2-6*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		87.1
13	*Apartament*	2917	*25/80+2-7*	PR-H-4	*19.05.2023*	*Certifikatë*		88.7
14	*Apartament*	2917	*28/55+1-1*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		83.5
15	*Apartament*	2917	*28/55+1-2*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		49.6

16	*Apartament*	2917	*28/55+1-4*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		83.5
17	*Apartament*	2917	*28/55+1-8*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		49.6
18	*Apartament*	2917	*28/55+1-9*	PR-J-5	*19.05.2023*	*Certifikatë*		84.2
19	*Varreza publike*	1589	26/19	K-34-137-(76-A)	28.07.2025	*Certifikatë*	2056	
20	*Varreza publike*	1589	26/10	K-34-137-(76-A)	28.07.2025	*Certifikatë*	2860	
21	*Varreza publike*	1589	26/17	K-34-137-(78-A)	14.07.2025	*Certifikatë*	3490	
22	*Ndertese+truall objekti Rrugeve Rurale*	2917	8/13	PR-D-4	23.06.2025	*Certifikatë*	3533	556
23	*Shesh (Shkolla e Mesme "Sami Frashëri")*	2917	6/103	PR-F-3	19.06.2024	*Certifikatë*	4078	
24	*Lapidari truall*	2917	16/7	PR-G-3		*Certifikatë*	396	

Burimi: Bashkia Përmet, DZHEBT

c. Nga auditimi mbi regjistrimin e pasurisë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës na ana e Bashkisë Përmet, konstatohet se nuk ka një regjistrim të plotë të aseteve të Bashkisë Përmet, kjo për arsye se ka ndryshim të sipërfaqes dhe llojit të pronave, ndërmjet atyre që janë transferuar me VKM përkatëse, krahasuar me ato që janë regjistruar në ASHK. Gjithashtu, në lidhje me Ish-Komunën Frashër sot Njësia Administrative Frashër - Bashkia Përmet janë miratuar listat e inventarit sipas VKM nr.240, datë 25.04.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Frashër të Qarkut Gjirokastër", pra pa e përcaktuar as si listë paraprake as si përfundimtare dhe në VKM nuk ka të detajuar nr. e pronave në përdorim apo në pronësi.
Më hollësisht,

- ***Bashkia Përmet:*** me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009"Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Përmet ", i është miratuar lista inventarit me në total 415 prona.
- ***Ish Komuna Petran, sot Njësia Administrative Petran e Bashkisë Përmet:*** me VKM nr.806, datë 06.10.2010 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Petran të Qarkut .Gjirokastër", i është miratuar lista inventarit me 1090 prona, nga të cilat 1042 prona në pronësi dhe 48 prona në përdorim.
- ***Ish Komuna Frashër, sot Njësia Administrative Frashër e Bashkisë Përmet:*** me VKM nr.240 datë 25.04.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Frashër të Qarkut Gjirokastër" i është miratuar lista inventarit me në total 156 prona., nga të cilat prona në pronësi dhe prona në përdorim.

Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. rendor 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) dhe përbëhet nga 33 (tridhjetë e tre) fletë ndryshuar me;

- VKM nr. 264 datë 12.05.2021 "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Përmet të njësisë administrative Frashër të disa pronave me vendndodhje në zonën kadastrale 2822" i janë transferuar 8 prona sipas listës së inventarit bashkëlidhur, gjithsej 1(një) fletë.
- VKM nr. 525 datë 29.07.2022 "Për transferimin në pronësi të Bashkisë Përmet të njësisë administrative Frashër të disa pronave me vendndodhje në zonën kadastrale 1637 dhe 3744" i janë transferuar 3 prona sipas listës së inventarit bashkëlidhur, gjithsej 2(dy) fletë.

Në lidhje me Ish-Komunën Frashër sot Njësia Administrative Frashër - Bashkia Përmet me VKM nr.240,datë 25.04.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në Komunën Frashër të Qarkut Gjirokastër", por pa e përcaktuar as si listë paraprake as si përfundimtare dhe në VKM nuk ka të detajuar nr. e pronave në përdorim apo në pronësi.

- ***Ish Komuna Çarcovë, sot Njësia Administrative Çarcovë e Bashkisë Përmet:*** me VKM nr.70 datë 20.10.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike,

shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Qendër Piskovë të Qarkut Gjirokastër" i është miratuar lista inventarit me në total 1108 prona; nga të cilat prona në pronësi 952 prona dhe 156 prona në përdorim.
Në formë të përmbledhur për Bashkinë Përmet rezulton:

Tabela nr 45

Nr.	Bashkia/ Njësitë	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara deri në Dhjetor 2025	Nr. Praktikave te Certifikuara 2023-2025	Prona të pa Riregjistruara
1	Bashkia	400	35	30	365
2	NJA Piskovë	454			454
3	NJA Petran	1042	2	1	1040
4	NJA Carcovë	1108			1108
5	NJA Frashër	167	8	8	159
	Gjithsej	**3,171**	**45**	**39**	**3,126**

Burimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit

Sa më sipër, mungesa e regjistrimit dhe e kontabilizimit me çmimin simbolik 1 (një) lek i këtyre aktiveve në PF të llogaridhënies vjetore, në kushtet e mungesës së vlerës së tyre reale, ndikon në krijimin e pasaktësive në lidhje me dokumentimin dhe njohjen e vlerës së drejtë aktiveve, duke vepruar në kundërshtim me SKK nr.5 "Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale" – përditësuar (2023), pika 8:

"Njësia ekonomike njeh koston e një zëri të AAM-ve si një aktiv nëse dhe vetëm nëse: (a) aktivi kontrollohet nga njësia ekonomike; (b) është e mundur që nga përdorimi i aktivit do të hyjnë në njësinë ekonomike përfitime të ardhshme ekonomike; (c) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Standardet e Kontabilitetit për Sektorin Publik, pika 5.2,

"*japin një pikë fillestare për regjistrimin, klasifikimin dhe grumbullimin e të dhënave dhe veprimtarisë ekonomike në një mënyrë që u jep përdoruesve informacione që përmbushin objektivat e raportimit financiar dhe arrijnë karakteristikat cilësore të raportimit financiar duke marrë parasysh kufizimet në informacionin e përfshirë në RFQP-të.*

pasi këto informacione:
Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"' i ndryshuar Kreu III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", paragrafi 26:

"Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar."

Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV, neni 37, pika 1, 2, germa a, b, Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, " Për inventarizimin dhe hipotekimin e ë gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI, Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme".

Konstatim: Regjistri i aktiveve nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe afatshkurtra (*vlerën e plotë të tokës, pyjeve dhe kullotave, apo llogaritë e pjesëmarrjes në kapital)* dhe nuk është i plotësuar me sipas kërkesave të Paragrafit nr.30 e 109, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Në regjistrin e aktiveve mungojnë të dhënat mbi vlerën fillestare të aktivit në momentin e blerjes, data e hyrjes në përdorim,*(në shumë raste vendosur shënimi para vitit 2015),* vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, datën e skadencës, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.

Inventarizimi i pronës shtetërore

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 11 pika 4, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, neni 74, parashikojnë që, çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)", Pasqyrën nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)", kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj.,

Më hollësisht, procedura e inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata trajtohet në vijim:

- Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë znj. A. H., me nr.459, datë **31.10.2025**, të është ngritur Komisioni i Inventarizimit të Vlerave Materiale e Monetare të Bashkisë Përmet dhe NJA-të e saj për vitin 2025, me këtë përbërje: znj. K. G., Kryetar i Komisionit dhe z.A. I., z.S. Ç., z.S. S. dhe z.M. Ç., anëtarë.

Komisioni i Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve të ambienteve të zyrave, të ambienteve të përbashkëta, të MNZSH, në kopshte, shkolla, konvikte, çerdhe, Njësitë Administrative, rrugët rurale si dhe automjeteve. Komisioni ka hartuar pasqyrat përkatëse duke bërë edhe rakordimet me gjendjen kontabile dhe nuk janë konstatuar diferenca. Nuk janë konstatuar pajisje zyrash dhe inventar i imët i amortizuar gjatë vitit 2025 (përveç llogarisë 215).

- Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë znj.A.H., me nr. 33, datë **03.02.2025**, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve Materiale dhe Aktiveve të tjera të dëmtuara për Bashkinë Përmet, i përbërë nga znj. E. K., Kryetar i Komisionit dhe anëtarët zj.E. M., z.Z. J., z.F. L., znj.K. G., dhe z.Gj. T. dhe respektivisht përfaqësues të NJA-ve si vijon: A. Z., NJA Frashër), S. Ç., (NJA Petran), F. K., (NJA Çarshovë), M. Z., (NJA Përmet).

Ky vlerësim aktivesh i është realizuar përgjatë vitit 2025, por përket procesit të inventarizimit të vitit 2024.

Për shkak të punës voluminoze si dhe periudhës së gjatë të mosvlerësimit të aktiveve të dëmtuara nga ana e Komisionit është kërkuar shtyrja e afatit të përfundimit të këtij procesi, ku me anë të Urdhrit nr.33/1 , datë 30.04.2025 të Kryetarit të Bashkisë ky afat i kryerjes së vlerësimeve është shtyrë nga data 30.04.2025 në datën 16.06.2025. Komisioni i Vlerësimit të Aktiveve ka hartuar listën e inventarëve të dëmtuar për llogarinë 327 në shumën 20,832,874 lekë; llog. 218 në shumën 19,302,689 lekë, llog.214 për 16,839,783 lekë dhe i ka shpërndarë tek njësitë administrative për të kryer vlerësimin fizik në prezencë të punonjësve me përgjegjësi materiale. Rezulton se janë hartuar

proces verbalet e vlerësimit ku është theksuar se baza materiale e dëmtuar nuk mund të përdorej më për funksionin e saj fillestar apo për qëllime të tjera dytësore. Dëmtimi i materialeve kishte ardhur nga përdorimi për një kohë të gjatë të tyre. Materialet e dëmtuara janë pasqyruar për çdo zë në fletë inventari, në sasi dhe në vlerë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.
Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, komisioni i sipërpërmendur ka hartuar raportin e vlerësimit drejtuar titullarit të institucionit.

- Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 88, datë **22.10.2025** është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit e materialeve të dëmtuara nga përdorimi i tyre në një periudhë shumë të gjatë. (që nuk janë nxjerrë jashtë përdorimit që prej vitit 2011).

Me Urdhrin Kryetar i Bashkisë znj.A. H., me nr.458, datë 31.10.2025, është krijuar Komisioni i Nxjerrjes Jashtë Përdorimit të Aktiveve Materiale dhe Materialeve të tjera të Dëmtuara", i përbërë nga z. D.M.- Kryetar i komisionit dhe anëtarët znj. K. G., P. Ç. , Th. A., L. K., dhe përfaqësuesit e NJA-ve M. S.,
I. J., J. P., dhe K. I.
Ky proces i nxjerrjes nga përdorimi i aktiveve, *lidhet me aktivet që kanë rezultuar të dëmtuara nga inventarizimi i vitit 2024*. *Pra nuk ka nxjerrje nga përdorimit të aktiveve të dëmtuara sipas inventarit të vitit 2025.*
Në përfundim rezultoi se vlera e materialeve të dala jashtë përdorimit dhe pasqyruar në PF 2025 është në total **36,142,472** lekë". Në pasqyrën nr. 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në rubrikën nxjerrje jashtë përdorimit është kryer pakësimi i llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" në vlerën 16,839,783 lekë dhe llog.218 "Inventar ekonomik" në vlerën 19,302,689 lekë.

Konstatim***:*** **1.**Në përfundimin e procesit të Inventarizimit, komisioni i Inventarizimit ka hartuar relacionin për mbylljen e inventarit për Kryetarin, por ky raport / relacion nuk ka miratim nga ana e Kryetarit të Bashkisë Përmet. Referuar këtij relacioni, rezulton se nuk për pjesën e inventarit të Qendrës Kulturore nuk është kryer ***inventarizimi për materiale të pikturave dhe kompozimeve*** me vlerë kontabile 20,080 lekë, për arsye se këto materiale i kanë kaluar Prokurorisë për ndjekje. Edhe zëri ***"litar çeliku ",*** që figuron si gjendje kontabile në magazinë me peshë 1,200 kg dhe vlerë 3,000,950 lekë,) nuk ekziston si gjendje fizike dhe bërë kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër me nr. 2522 prot, datë 26.09.2023. Për ***materialet në bibliotekën e Qytetit*** nuk është kryer inventarizimi i fondit të saj (libra, revista, etj.) që nga viti 2016, me pretendimin se, personi materialisht përgjegjës refuzon nënshkrimin me arsyetimin se nuk ka kryer marrjen e detyrës me procesverbal ku te jenë identifikuar artikujt me numër serie dhe me sasi e emërtim, por vetëm në vlerë. Këto çështje janë prezantuar edhe në raportet e inventarizimit të pasurisë në vitin 2023 dhe 2024, por pa i adresuar ato.
2. Rezulton se znj K. G. është pjesë e Komisionit të Inventarizimit, Vlerësimit dhe Nxjerrjes Jashtë Përdorimit të aktiveve.
3.Procesi inventarizimit fizik të aktiveve, ka evidentuar disa mangësi të evidentuara në zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, lidhur me saktësinë dhe rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm.

- Nuk ka gjetur *dokumentim paragrafi nr.83 i UMF nr. 30/2011 " Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proçesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës.* Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material."

- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të **llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214** përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Nuk i janë nënshtruar inventarizimit zërat ***Ndërtesa dhe Rrugë, rrjete e ujësjellësa***, por vetëm janë përfshirë si një zë i vetëm në përmbledhësen e inventarëve të vitit 2025, pa u zbërthyer analitikisht në zëra të veçantë.
- Nuk është kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, ***(llogaria 203 "Koncesione, licenca, patenta e të ngjashme")***, që paraqitet në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare me vlerën 20,194,217 lekë në fillim të vitit 2025 dhe 18,313,570 lekë në fund të kësaj periudhe). Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale.

4. Nga DFB dhe DEBT është hartuar vetëm **regjistri elektronik i aktiveve,** i cili nuk përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81, të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar;

Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo kanë administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar.

-Nuk janë përfshirë në regjistrin e aktiveve, ***aktivet të cilat gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital***, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu III, paragrafi 28;

28. Regjistri i aktiveve të një njësie, duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.

dhe Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, paragrafi 4/c:

. Të gjitha aktivet e dhëna me qera, enfiteozë, koncesion, nga pjesëmarrja në kapitalin e shoqërive tregetare, apo forma të tjera të përcaktuara me ligj të përdorimit të pronës publike e të cilat krijojnë të ardhura.

5.- Nga ana e Bashkisë Përmet është hartuar dhe miratuar "Manuali i Procesve për Menaxhimin e Aktiveve vendore", (protokolluar në këtë Bashki me nr. 308 prot, datë 31.01.2025), mirëpo nuk është miratuar "Rregullore për menaxhimin e aktiveve" dhe Strategjia për mbrojtjen dhe menaxhimin e aktiveve**,** në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar

c) miratimin e sistemeve të menaxhimit të informacionit; ç) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave neni 8, "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 8/ç:

ç*) miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, sipas udhëzimeve të nxjerra nga Ministri i Financave;*

Manualit të MFK-së*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu II, pika 17-25;

5.Titullari i njësisë publike është përgjegjës ***për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave*** *për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.*

6.Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh *me rregulla të qarta dhe të dokumentuara.* Çdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë.

dhe pika 119:

119. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme, në bazë të kritereve të mësipërme, caktojnë rregulla të hollësishme për nxjerrjen nga përdorimi të llojeve të ndryshme të aktiveve...

Kreu I, Pika 16 "Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik":

16. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me menaxhimin e aktiveve të njësisë dhe riskut të lidhur me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis manaxherëve, i parashtrohen Grupit për Menaxhimin Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe *miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre*.

dhe Kreu X "Kontabiliteti dhe raportimi", neni 52, i ligjit nr.68/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore":

"1. Nëpunësi autorizues i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjigjet për funksionimin dhe zbatimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. 2. ***Procedurat dhe rregullat për menaxhimin e aktiveve miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore****, sipas legjislacionit në fuqi. Informacioni në lidhje me transferimin dhe asgjësimin e aktiveve të trupëzuara bëhet pjesë e dokumentit të buxhetit dhe e raportit vjetor. 3. Procedurat standarde për ruajtjen, arkivimin dhe asgjësimin e dokumenteve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore bëhen sipas dispozitave ligjore në fuqi.*

6. Nuk janë kërkuar dhe administruar të dhënat brenda muajit Qershor të vitit 2025, nga shoqëritë tregtare në të cilat Bashkia zotëron kuota apo të drejta si dhe nga shoqëritë koncesionare me të cilat ka kontrata koncesioni, kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit, në *kundërshtim* me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu III, pika 32 dhe 33:

32. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në regjistër, njësia publike, brenda muajit Qershor të çdo viti, i kërkon shoqërive tregtare në të cilat shteti zotëron kuota apo të drejta të tjera e që janë në administrim të njësisë publike, kopje të pasqyrave financiare vjetore të vitit paraardhës si dhe të vendimit të asamblesë se përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare, rezultatit vjetor dhe destinacionin e fitimit.

33. Për nevoja të plotësimit të të dhënave në rregjistër, dhe analizës njesia publike, brenda muajit Qershor të çdo viti, i kerkon shoqërive koncesionare me të cilat ka kontrata koncesioni, të depozitojnë në autoritetin kontraktor një kopje të pasqyrave financiare vjetore, pasqyrën e llogaritjes dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj shtetit, të shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pagesën si dhe llogaritjen e parashikimit të detyrimeve për vitin ushtrimor në vazhdim.

Përfundime:

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin e përgjithshëm të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në Bashkinë Përmet, sipas kërkesave të legjislacionit mbi menaxhimin e sistemit buxhetor dhe atij financiar e të kontrollit dhe kontabilitetit, etj. ka rezultuar se përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në këtë njësi shpenzuese buxhetore, është realizuar në mbështetje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare*).

Nga ana tjetër, krahas punës së bërë kanë rezultuar devijime të vogla dhe disa mangësi e parregullsi, të identifikuara në aktin e konstatimit, në lidhje me mos kontabilizimin e vlerës së truallit, apo kreditorëve të lidhura me njohjen në afat të vendimeve gjyqësore; risku i parashkrimit të të drejtave për arkëtim nga debitorët; mangësi në hartimin e regjistrit të aktiveve apo procedurave të inventarizimit të pasurisë, etj., që duhet të jenë në vëmendjen e strukturave menaxheriale të institucionit për përmirësimet e nevojshme në të ardhmen.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj.A. H., me detyrë Kryetar i Bashkisë Përmet, zj.E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

4. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 323/1 prot., datë 10.03.2025, me objekt *"Auditim financiar dhe përputhshmërie"* është zhvilluar auditimi:

- për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2024, deri me datën 31.12.2024 për auditimin financiar dhe
- nga data 01.01.2023, deri me datën 31.12.2024 për auditimin e përputhshmërisë.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me Vendim nr. 208, datë 20.10.2025 dhe Raporti Përfundimtar është dërguar në këtë subjekt me shkresën nr.323/9, datë 22.10.2025, (protokolluar në këtë institucion me nr. 3526, datë 23.10.2025).

Në kryerjen e verifikimit u kërkuan përgjigje nga subjekti i audituar për secilin rekomandim shoqëruar me dokumentacion përkatës. Nga verifikimi rezultoi si më poshtë:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, *në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna*:

Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Përmet ka kthyer përgjigje mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve si dhe planin e veprimit ku të pasqyrohen rekomandimet e lëna, strukturat përgjegjëse si dhe afatet e përcaktuara për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 3526/1 prot., datë 12.11.2025, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 323/10 prot., datë 14.11.2025. Me Urdhrin nr. 449, datë 29.10.2025, Bashkia Përmet ka ngritur grup pune për ndjekjen e procedurave administrative dhe ligjore për zbatimin e rekomandimeve dhe në zbatim të këtij urdhri është hartuar Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve me nr 3783 prot., datë 12.11.2025.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, *për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30 pika 2 e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*:

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Përmet ka dërguar informacion në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna me shkresën nr. 1510/1 prot., datë 22.04.2026, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 323/11 prot., datë 23.04 2026.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit janë rekomanduar gjithsej:

a. Janë rekomanduar **24 masa organizative**; (17 prej tyre te lidhura me AF)

b. Janë rekomanduar **4 masa shpërblim dëmi** (0 prej tyre te lidhura me AF)

c. Janë rekomanduar **4 masa për uljen e borxhit tatimor;**

d. Janë **2 dy** rekomandime per Kryetarin e Bashkisë Përmet që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e **masave disiplinore për 21 pesrona** të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH (Tabela nr 46)

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar (Bashkia Përmet)	Pa pranuar	A eshte objekt i auditimit financiar?
1	Organizative	24	24	-	
	Nga këto financiare	***17***	*17*		po
	Nga këto perputhshmeri	*7*	*7*	-	**jo**
2	Shperblim dëmi	4	4	-	
	Nga këto perputhshmeri	*4*	*4*	-	**jo**
3	Për uljen e borxhit tatimor	**4**	4	-	po
4	Masa 3 E *perputhshmeri*	4	4	-	**jo**
4	Masa Disiplinore (21 persona)	**2** rek	2	-	po

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara, **që i përkasin auditimit financiar** paraqitet si më poshtë: **Tabela nr 47**

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	**17**	9	4	2	2
2	Për uljen e borxhit tatimor	**4**	1	1	2	0
3	Masa Disiplinore	**2**	2	-	-	-

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 10 (dhjetë) procedurave të prokurimit, të përzgjedhura për auditim u konstatua se:

Në 7 (shtatë) procedura prokurimi, për periudhën 01.01.2023 -31.12.2024, me vlerë totale të fondit limit 320,032,598 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 269,460,916 lekë pa TVSH, janë aplikuar kritere të paargumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e objektit të kontratës çka ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën midis B/OE pjesëmarrës në garë.

- Në 3 (tre) raste për vlerën e 28,300,285 lekë të fondit limit, Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar fondin limit. Konkretisht për 2 (dy) procedurat me obiekt *"Blerje karburanti"* për vitet 2023-2024 dhe 1 (një) procedurë me objekt *"Blerje ushqimesh për kopshtin konviktin/çerdhen"* për vitin 2023. Në lidhje me sasinë e përllogaritur të karburantit përvec

dokumentacionit të paraqitur, nuk ka një analizë të detajuar e cila duhet të ketë të përcaktuar kërkesat e paraqitura nga grupet e punës në terren, kërkesat nga shofer
ët që kanë në ngarkim mjetet, analizën mbi aktivitetin e punës së vitit të kaluar, parashikimin e volumeve të punës te vitit pasardhës bazuar në programin vjetor programeve mujore të miratuara, numrin e mjeteve si dhe verifikimi i gjendjes teknike mjeteve. Në hartimin e kërkesës për ushqime dorëzuar për komisionit për llogaritjen e fondit limit u konstatua se, nuk dokumentohet mënyra se si janë përcaktuar normat ditore.
- Në 8 procedura, me vlerë totale të fondit limit 325,436,368 lekë pa TVSH dhe vlerë totale të kontratave 274,382,156 lekë pa TVSH, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kritereve të DST të miratuara nga AK Bashkia Përmet.
-Në 1 (një) procedurë me fond limit 5,403,770 lekë dhe me vlerë kontrate 4,921,420 lekë pa TVSH, me objekt prokurimi *"Blerje ushqimesh për kopshtin /konviktin/çerdhen për vitin 2023"* është konstatuar mos zbatim i kushteve të kontratës me nr. 584 prot., datë 20.02.2023, gjithashtu, marrja në dorëzim e mallrave është kryer jo në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Nga auditmi u konstatua se, nuk paraqitet dukumentacion sikurse përcaktohet ne nenin 1 "Objekti i Kontratës" ku mallrat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 1 të kontratës "Objekti i kontratës" pika 1.2 ku është kërkuar që për mallrat që do të dorëzohen duhet të jenë sipas sasisë në dokumentet e tenderit dhe specifikimeve teknike. Nuk janë paraqitur Proces Verbalet me të dhënat treguesit cilësor sipas specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit (shtoica 5) nuk ka evidentuar nëse mallrat e furnizuara janë të cilësisë së parë, nëse ambalazhi i tyre është në përputhje me kërkesat e prokurimit, nëse furnizimi është në përputhje me treguesit cilësorë sipas standardit shtetëror të miratuar. Nga auditimi u konstatua se, mungon fleta e shoqërimit e cila dorëzohet nga furnitori ku përcaktohen minimalisht të dhënat e mjetit me të cilin po transportohen ushqimet, nëse i plotëson kushtet higjeno-sanitare, ose transportohen me mjetin frigoriferik i cili përcaktohet në dokumentat e tenderit. Në pikën 6.3 të nenit 6 të kontratës me nr. 584 prot., datë 20.02.2023, specifikohet se, mallrat do të dorëzohen nga administratori i firmës ose nga një përfaqësues i firmës autoizuar me shkrim shoqëruar me raport analizën për çdo produkt, lidhur me këtë kërkesë u konstatua se, jo çdo produkt është shoqëruar me rapor analizën përkatëse
Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 258, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, neni 2, me pikën 4 të nenit 39, nenin 78, nenin 107 i ndryshuar. Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, *"Për prokurimin publik"*, neni 1, neni 3, neni 21, pika 1 dhe pika 5, neni 83, pika 2, gërma "b", neni 98, pika 1/b neni 124, UMF Nr. 30 datë 27.12.2011 *"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njesitë e Sektorit Publik"*, neni 43. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 98-135 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*
1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, të marrë masa që zyrtarët e përfshirë në procesin prokurues (Grupi për Hartimin e Fondit Limit, Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, Komisioni i Vlerësimit te Ofertave dhe Grupi i Monitorimit të Kontratës) të jenë specialistë të fushës, me qëllim që argumentimi i kritereve të vendosura të jetë në përputhje me tipologjinë e procedurës së prokurimit, që gjatë vlerësimit të ofertave të sigurohet konkurrencë e drejtë dhe e paanshme, si dhe gjatë zbatimit të kontratës të garantohet plotësimi i Specifikimeve Teknike dhe kushteve të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

2. Gjetje nga auditimi: Në **3 (tre) raste,** nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike për objektet përkatësisht:
- "Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza" me nr. 79 prot., datë 09.01.2023. fituar nga shoqëria "H" SHPK me vlerë të kontratës 38,063,788 lekë me TVSH,
-"Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Permet" me nr. 79 prot., datë 09.01.2023, fituar nga BOE "E." SHPK & "C" SHPK me vlerë të kontratës 12,564,245 lekë me TVSH,
-"Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskove" me nr. 107 prot., datë 11.01.2023, fituar nga OE "S" SHPK me vlerë të kontratës 11,439,482.70 lekë me TVSH, u konstatua se: Nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Permet **nuk është kryer Oponencë Teknike,** veprim ky në mospërputhje me **pikën 1 të nenit 6** të ligjit **nr. 8402,** datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Ligjin Nr. 120/*2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998"*, me **Ligiin nr. 107/2014** *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"* **neni 52**, me **VKM Nr. 610, datë 22.9.2022** *"Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe menyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa që të pajiset me ***Oponencë Teknike*** çdo projekt zbatimi, për t'u siguruar mbi hartimin e studimeve të projekteve të zbatimit, në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe zhvillimit të territorit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike të projektimit dhe standardet në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, u konstatua se në 5 (pesë) raste ka mangësi në dokumentacionin shoqërues. Në të gjitha rastet janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu, në 1 (një) rast u konstatua se dokumenti i ljies së ndërtimit nuk respekton përcaktimet ligjore në lidhje me përmbajtjen e tij Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektet: -Leje ndërtimi "Banesë një familjare në pronë të familjes "X", miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, me zhvillues A. X.; -Leje ndërtimi "Ndërtim objekt dy kat me çati + një kat podrum (bujtinë)", miratuar me Vendim nr. 2732/5, datë 18.10.2024, me zhvillues S. B.; -Leje ndërtimi "Banesë individuale një kat + bodrum dhe çati", miratuar me Vendim nr. 2540/1, datë 20.11.2023, me zhvillues V. G.; Leje ndërtimi "Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë", miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29.03.2023, me zhvillues A. N.; -Leje ndërtimi "Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat banim në godinë ekzistuese 2 kate", miratuar me Vendim nr. 1103/1, datë 05.06.2023, me zhvillues J. P.; -Çertifikatë përdorimi "Mbingritje 1 kat me çati në objekt ekzistues me funksion banimi", miratuar me Vendim nr. 2319/1-5, datë 03.04.2024, me zhvillues A. K.; Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr, 408, datë 13.05.2015 *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, i ndryshuar, neni 16, pika l, nënpika b); nenin 20; neni 15, pika 1, nënpika b) ë) g); nenin 27; nenin

27/2, pika 1, nënpika i; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 155-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit të shqyrtojë dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, të mos miratojë leje ndërtimi apo çertifikata përdorimi në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm ligjor, si dhe të sigurojë plotësimin e saktë dhe të plotë të dokumentit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në viiimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 5 (pesë) raste u konstatua se, Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Teritorit, Bashkia Përmet nuk ka respektuar detyrimin ligjor për të marrë mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Rezulton se lejet e ndërtimit pë 5 objektet:

-Leje ndërtimi "Banesë një familjare në pronë të familjes "X", miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, me zhvillues A. X.,

-Leje ndërtimi "Ndertim objekt dy kat me çati + një kat bodrum (bujtinë)", miratuar me Vendin nr. 2732/5, datë 18.10.2024, me zhvillues S. B.

-Leje ndërtimi "Banesë individuale një kat + bodrum dhe çati", miratuar me Vendim nr. 2540/1, datë 20.11.2023, me zhvillues V. G.,

-Leje ndërtimi "Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë", miratuar me Vendim nr. 2846/2. datë 29.03.2023. me zhvillues A. N.,

-Leje ndërtimi "Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat banim në godinë ekzistuese 2 kate", miratuar me Vendim nr. 1103/1, datë 05.06.2023, me zhvillues J. P.,

janë miratuar në heshtje, pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, i ndryshuar, neni 21, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 155-163 të Raportit përfundimtar të Auditimit),*

4.1. Rekomandimi: Nga ana e Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Teritorit, Bashkia Përmet, të merren të gjitha masat për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në mënyrë të dokumentuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se, në 2 (dy) raste, nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë, lartësia maksimale e lejuar, e matur me numër katesh, si dhe distanca urbane nga kufiri i pronës. Në (1) një rast është konstatuar se, parcelat e përfshira në funksion të zhvillimit të të njëjtit objekt ndërtimi, nuk kanë lidhje fizike ndërmjet tyre. Këto parcela kufizohen me pasuri të tjera që ndodhen ndërmjet tyre dhe për rrjedhojë, nuk përbëjnë një njësi të pandërprerë territoriale (truall të përbashkët) në funksion të zhvillimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet:

-Leje ndërtimi "Banesë një familjare në pronë të familjes “X", miratuar me Vendim nr. 1145/2, datë 21.07.2023, me zhvillues A. X.; -Leje ndërtimi "Prishje dhe rindërtim objekti 2 kat me një kat nëntokë", miratuar me Vendim nr. 2846/2, datë 29,03.2023, me zhvillues A. N.. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-në nr, 408, datë 13.05.2015 *"Per miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, neni 14, neni 30, neni 35, Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me Vendimin e KKT nr.3, datë 10.06.2020, neni 20, pika 4; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 155-163 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit të marrë masa që, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të sigurojë respektimin e kushteve ligjore dhe urbane për zhvillim, konkretisht:

- Të verifikojë përputhshmërinë e aplikimit me kushtet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe të miratojë vetëm ato aplikime që i respektojnë këto kushte, në përputhie me parashikimet ligiore dhe nënligiore në fuqi:

- Të pranojë për shqyrtim vetëm ato aplikime në të cilat objektivat zhvillohen mbi parcela që kanë lidhje fizike midis tyre; ose, kur parcelat nuk kanë lidhje fizike, të jetë siguruar dokumentacioni që vërteton marrëveshje të ligjshme për akses në pronë përmes parcelave ndërmjetëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkisë Përmet i janë transferuar me VKM-të përkatëse 3,250 pasuri, nga të cilat 3,015 janë në pronësi dhe 235 në përdorim. Nga këto pasuri, rezultoi se vetëm 39 janë të pajisura me çertifikatë pronësie, ndërsa 2,976 mbeten të paregjistruara. Gjatë vitit 2024, është aplikuar për regjistrim në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës vetëm për 4 pasuri, nga të cilat nuk është çertifikuar asnjëra. Bashkia Përmet nuk ka ndërmarrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike dhe juridike të këtyre pronave dhe nuk ka kryer veprimet e nevojshme ligjore për regjistrimin e pasurive të transferuara me qëllim pajisjen e tyre me certifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me: Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”,* Kreu IV, neni 37, pika 1, 2, germa a, b, Ligjin nr. 139/2015*, “Për vetëqeverisjen vendore”,* nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, *“Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”,* Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar, pikat 26-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtartë Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin e gjendjes faktike dhe juridike të pasurive të transferuara sipas VKM-ve, si dhe për të bërë të mundur rakordimin me Drejtorinë Vendore të ASHK, me qëllim përditësimin e inventarit të pasurive në përputhje me gjendjen reale dhe pajisjen e tyre me çertifikata pronësie, duke reflektuar ndryshimet nga legalizime, privatizime, kthime/kompensime apo vendime gjyqësore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Në zbatim të këtij rekomandimi janë hedhur në format Excel të gjitha pasuritë e transferuara me vendime të Këshillit të Ministrave, për Bashkinë Përmet dhe të katër njësitë e tjera administrative. Është ngritur grupi i punës me Urdhrin nr. 479, datë 10.11.2025, për verifikimin në terren të të

gjitha pronave, gjendjes faktike dhe juridike, për t'u bërë përditësimi i inventarit të pasurive në përputhje me gjendjen reale dhe pajisjen e tyre me çertifikata pronësie, duke reflektuar ndryshimet nga legalizimet, privatizimet, kthimet/kompensimet apo vendimet gjyqësore. Gjatë periudhës në vazhdim është aplikuar për regjistrimin e pasurive si më poshtë:

- *ZK.1589 N.B Përmet 2, nr. pas. 26/19, vol. 3, fq. 61, arë me sip. 2056 m2, varrezat publike*
- *ZK.1589 N.B Përmet 2, nr. pas. 26/17, vol. 3, fq. 59, arë me sip. 3490 m2, varrezat publike*
- *ZK.1589 N.B Përmet 2, nr. pas. 26/10, vol. 2, fq. 240, arë me sip. 2860 m2, varrezat publike*
- *ZK.2917 Përmet, nr. pas. 8/13, vol. 22, fq. 120, truall me sip. 3533 m2, nga e cila ndërtesë 556 m2, MRF.*
- *ZK.2917 Përmet, nr. pas. 16*/7, vol. 22, fq. 243, lapidari, për të cilat kanë dalë edhe çertifikatat e pronësisë.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Përmet ka në administrim 22 apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara në pronësi të saj, për të cilat ka detyrimin të lidhë kontratat e shitjes me rezervë me subjektet përfituese, në zbatim të vendimeve përkatëse të privatizimit. Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se Bashkia Përmet nuk i ka pajisur me çertifikatë pronësie apartamentet me nr. 28/55+1-8, nr. 28/55+1-3, nr. 25/80+1-3 dhe nr. 25/80+2-5, ndodhur në Zonë Kadastrale 2917. Pajisja me çertifikatë pronësie është e domosdoshme për lidhjen e kontratave të shitjes me rezervë me subjektet përfituese nga privatizimi. Këto veprime janë në kundërshtim me Vendimin Nr. 898, datë 18.11.2020 *"Për Rregullat, Kushtet, Kriteret e Procedurat e Privatizimit të Banesave dhe të Objekteve të kthyera në Fond Banese të Paprivatizuara",* Kreu V – Lidhja e Kontratës, , si dhe si dhe VKB nr.36, datë 30.05.2022 *"Për miratimin e privatizimit të banesave sociale në Qytetin Përmet si dhe vlerën e privatizimit të tyre në favor të përfituesëve". (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtartë Auditimit).*
7.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa të menjëhershme për pajisjen me çertifikatë pronësie apartamentet e miratuara për privatizim me nr. 28/55+1-8, nr. 28/55+1-3, nr. 25/80+1-3, nr. 25/80+2-5, me qëllim finalizimin e procesit të privatizimit, duke siguruar lidhjen e kontratës së shitjes me rezervë me subjektet përfituese në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit
Në zbatim të këtij rekomandimi janë pajisur me çertifikatë pronësie apartamenti 28/55+1-8 më datë 30.11.2022, nr. 28/55+1-3 është pajisur me çertifikatë më datë 19.05.2023, nr. 25/80+1-3 është pajisur me çertifikatë më datë 19.05.2023, dhe për apartamentin me nr. 25/80+2-5 është aplikuar dhe nuk është pajisur me çertifikatë.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi.**

8. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e siguruara nga Regjistri i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, konstatohet se gjatë periudhës 01.01.2024,

deri më 31.12.2024, në territorin e Bashkisë Përmet ka ushtruar aktivitet në fushën e burimeve natyrore subjekti "E" sh.p.k i cili disponon një HEC në Qarkun Gjirokastër, në Njësinë Administrative Çarshovë. Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit nuk disponon dokumentacionin përkatës, përfshirë raportin teknik, kontratat e qirasë, si dhe dokumentacion tjetër shoqërues të nevojshëm.
Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor",* i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007*, "Për Fondin kullosor",* pikat 3, 7, 9,10,11, dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, *"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor"*, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008*, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor".(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.1, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtartë Auditimit)*
8.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet t'i drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, - Në rastet kur nuk realizohet zbritja e kësaj sipërfaqeje nga fondi pyjor dhe kullosor, Bashkia të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ndërprerjen e përkohshme të veprimtarisë së subjektit privat përkatës, deri në përmbushjen e detyrimit ligjor për zbritjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së shfrytëzuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Në zbatim të këtij rekomandimi po ju dërgojmë gjithë korrespondencën që kemi pasur me subjektin "E" shpk dhe institucionin e Zonave të Mbrojtura.
Me shkresë nr. 374 prot., datë 06.02.2025, i është kërkuar subjektit "E" shpk të vinte në dispozicion të Bashkisë Përmet gjithë dosjen me dokumentacionin e nevojshëm për nënshkrimin e kontratës midis tyre dhe institucionit tonë.
Ka ardhur përgjigje nga subjekti me shkresën nr. 14/4, datë 25.03.2025, në të cilën subjekti shprehej se brenda 7 ditëve do të sillte gjithë dokumentacionin e kërkuar në bashki. Deri më sot, nga subjekti nuk është vënë në dispozicion të institucionit tonë dosja me dokumentacionin e kërkuar.
Me shkresën nr. 207, datë 21.05.2025, është vënë në dijeni institucioni ynë se, në zbatim të VKM-së nr. 1631, datë 17.12.2008, "Për shpalljen Park Kombëtar të ekosistemit natyror "Bredhi i Hotovës-Dangëlli" me sipërfaqe të zgjeruar", sipërfaqja ku është ndërtuar HEC-i Carshovë u përfshi brenda zonës së mbrojtur P.K. Bredhi i Hotovës-Dangëlli.
Në zbatim të VKM nr. 102, datë 04.02.2015, gjithë aktiviteti administrohet dhe kontrollohet nga zonat e mbrojtura. Ky hidrocentral paguan në Bashkinë Përmet vetëm të ardhura nga taksat vendore, jo tarifa që përdoren sipas legjislacionit të fondit pyjor dhe kullosor të Bashkisë Përmet.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Me shkresën nr. 1780 prot., datë 19.05.2025, Bashkia Përmet i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe për dijeni Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore me qëllim evidentimin dhe verifikimin e sipërfaqes së shfrytëzuar nga subjekti privat, në mënyrë që kjo sipërfaqe të zbritet nga fondi pyjor dhe kullosor.
Sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2024, u konstatua se, në Bashkine Përmet funksioni i kontrollit të territorit, kryhet nga zyra e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nmë

varësi të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, në varësi direkte nga organi ekzekutiv i Bashkisë. Sa i përket numrit të punonjësve në zyrën e kontrollit u konstatua se nuk është në përputhje me përcaktimet e kuadrit regullator, pasi nga 3 punonjës minimalisht që duhet të ketë kio strukturë, ka vetëm 1 punonjës Kryeinspektori i zyrës së kontrollit nuk ka miratuar asnjë akt-kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, sipas fazave të punimeve, gjitashtu nuk ka përgatitur informacionin periodik 3-mujor për IKMT për masat e marra, gjatë ushtrimit të detyrave. Programi vjetor i punës për zyrën e kontrollit nuk është miratuar nga organi ekzekutiv i Bashkisë. Nga auditimi ka rezultuar se, ndërmjet zyrës së kontrollit dhe drejtorisë së urbanistikës, ka munguar bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të veprimtarisë së zhvillimit të territorit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "a" në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9,1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar; Pikat 1,2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar; Nenin 5, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat "a" dhe "c" në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.201 1 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë;* Nenin 11 të Ligjit nr.10296 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën "b", pikat 4 dhe 6 në VKM nr 394, datë 04.11.2015 *"Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorat kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore".(Me hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 163-166. të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për: Krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel inspektorati dhe jo si zyrë kontrolli.

Mbajtjen e akt-kontrolleve për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

Rritjen bashkëpunimit me Drejtorinë e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, për shkëmbimin e informacionit midis tyre.

-Përgatitjen e planeve vjetore dhe mujore të punës dhe informacionin periodik tre mujor ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi aktivitetin e saj, procedurat mbajtura gjatë kësaj kohe dhe vendimet e marra.

Menjëherë

<u>Qëndrimi i audituesve të KLSH-së</u>

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV, konstatohet se, në të gjitha rastet, edhe pse është lënë detyrë për prishjen e punimeve pa leje dhe/ose të dorëzimit të dokumentacionit, konstatohet se nuk administrohet dokumentacioni i dorëzuar si dhe nga zyra e kontrollit nuk është kryer inspektim për verifikimin e plotësimit të detyrave të lëna, pra të prishjes së punimeve të ndërtimeve pa leje. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet

e bëra në nenin 3, gërma "a", nenin 4, 5, nenin 11, pika 5, 6, 7 dhe 8 si dhe nenin 12 dhe 13, të Ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*,i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 163-166, të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

10.1.Rekomandimi: Nga struktura e kontrollit dhe mbrojtjes së territorit Bashkia Përmet, të kryhen inspektime për verifikimin e plotësimit të detyrave të lëna bazuar në akt konstatimet e mbajtura, në lidhje me punimet për ndërtimet pa leje.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

11. Gjetje nga auditimi: Mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit të llogarive kontabël për vitin 2024 në pasqyrat financiare të vitit 2024, sipas sipas UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*" *ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022,"*, u konstatua si më poshtë vijon:

-Shuma e llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*" është nënvlerësuar me 5,724,449 lekë, pasi informacioni i ardhur në Sektorin e financës për borxhin tatimor dhe numrin e tatimpaguesve që janë debitorë ndaj Bashkisë Përmet, nuk ka qenë i plotë dhe si pasojë vlera 5,724,449 lekë nuk rezulton e kontabilizuar [4];

- Nga analiza e llog.218 "*Inventar ekonomik*" rezulton se kategoria "*Pajisje kompjuterike*" nuk është ndarë si nënkategori më vete [llog. 2186], duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj.

- Vlera e amortizimit në llog. 209 & 219 "Amortizimi i AAGJM & AAJM" është në vlerën 64,881,828 lekë. Nga auditimi rezulton se amortizimi nuk është llogaritur për çdo aktiv, por në grup, duke mos patur kështu informacion mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero dhe si rrjedhojë as të paturin nën kontroll të nevojës për rivlerësimin e atyre që janë në gjendje pune;

- Llogaritë e klasës 20 "AAJM"/llog. 202 "Studime e projektime" paraqitet në shumën 20,194,217 lekë ku përfshihen 15 projekte. U konstatua se nga ana e DFB nuk janë marrë masat që për projektet e hershme kryesisht të atyre të vitit 2015 në shumën 4,212,174 lekë, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 AAM: llog.212 dhe llog.213. tek investimi respektiv.

- Nga analiza e llog.218 "Inventar ekonomik" rezulton se kategoria "Pajisje kompjuterike" nuk është ndarë si nënkategori më vete [llog. 2186], duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj, për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit.

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 nuk janë përfshirë gjithë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Përmet, pasi proçedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i tyre. U konstatua se këto asete janë të pa kontabilizuara;

- Llog. 26 "pjesëmarrje në kapitalin e vet" paraqitet në vlerën 216,752,570 lekë.

Bashkia Përmet referuar Ekstraktit të QKB -së është aksionere me 7.65% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër" Sh.a me Nipt- M.....L, ose me 7650 aksione me vlerë nominale 100 lekë/copa. Kjo vlerë është përcaktuar referuar Marrëveshjes

[4] Trajtuar gjerësisht në nënpikën 2.6 të programit *"burimi i krijimit të të ardhurave"*

“Për krijimin e subjektit të konpetencave të përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime [SKPUK]” mes 7 Bashkive të Qarkut Gjirokastër dhe MIE;
Situacioni përfundimtar i punimeve të kryera në Ujësjellësin Përmet (pas vitit 2019), i cili në periudhën e transferimit të kapitalit të UK Përmet–sha dhe krijimit të UKR Gjirokastër-sha ishte në proces, ende i papërfunduar është në vlerën totale 583,299,150.92 lekë;
DFB në llog. 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" të pasqyrave kontabël, ka regjistruar vlerën e certifikuar të shoqërisë audituese "H a." sh.p.k me ekpertë kontabël H.M të miratuar në prill të vitit 2019, në Raportin e së cilës vlerësohet se kapitali i Shoqërisë UK Përmet -sha është në vlerën 216,752,570 lekë dhe zotërohet në masë të plotë 100% nga aksioneri Bashkia Përmet;.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 80-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit të marrë masa që deri në mbyllje të vitit ushtrimor 2025:
- Të sistemohet llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për vlerën 5,724,449 lekë që përbën vlerën e detyrimit progresiv nga të ardhurat vendore e cila nuk rezulton e kontabilizuar nga DFB;
- Për nëntë projektet e hershme të periudhës deri në vitin 2015 në vlerën totale 7,302,172 lekë që përfshihen në llog.202 “*Studime e projektime*”, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 “AAM”: llog.212 apo llog.213 sipas rastit tek investimi respektiv;
- Në llog. 218 “*Inventari ekonomik*” të klasifikojë veçmas llog.2186 “*Pajisje kompjuterike”* në regjistrin e aktiveve të njësisë dhe pasqyrat financiare, sipas nomenklaturës së llogarive;
- Me mbylljen e procedurave të pajisjes me titull pronësie të aseteve të transferuara me VKM, të parashikohet në PBA fond për rivlerësimin e tyre, me qëllim kontabilizimin në llogaritë respektive të klasës 21 “AAM”;
- Të llogarisë amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv, për të patur në çdo kohë informacion të saktë mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero, të cilat nga rivlerësimi do rezultojnë në gjendje pune;
- Me mbylljen e llogaritjeve të kapitalit të ish UK Përmet pjesëmarrës në UK Rajonale Gjirokastër, të saktësohet dhe vlera e llog. 26 *“Pjesëmarrje në kapitalin e vet”*

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2025

Shpjegimet e subjektit

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, të rakordojë të dhënat me Sh.A. Ujësjellësin dhe Njësitë Administrative, ka depozituar me anë të shkresës nr. 22/1, datë 17.02.2026, pranë Drejtorisë së Buxhet Financës listën e debitorëve me SHUSHK Gjirokastër deri në vitin 2024, listën e debitorëve për karburantet, si dhe debitorët për asetet. Drejtoria e Buxhet Financës, me anë të shkresës së brendshme nr. 129, datë 07.11.2025, i ka përcjellë të dhënat sipas kontabilizimeve të bëra për llog. 202 “Studime e projektime” Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, që në bashkëpunim me Njësitë Administrative të gjejnë informacionin e nevojshëm dokumentar. Me anë të shkresës nr. 129/1, datë 11.11.2025, Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit ka bërë me dije se nuk disponon dokumentacion. Më pas, Drejtoria e Financës i është drejtuar me shkresën nr. 136, datë 13.11.2025, Arkivës, e cila me shkresën nr. 136/1, datë 14.11.2025, ka kthyer përgjigje se nuk ka gjetur dokumentacion. Në këto kushte nuk janë kryer sistemime.
Të kryhet procedura për vlerësimin dhe regjistrimin e aseteve sipas zërit buxhetor të parashikuar në buxhetin e vitit 2026

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit është në proces për hapjen e kartelave, por për shkak të mungesës së të dhënave, llogaritja e amortizimit edhe për vitin 2025 nuk është sistemuar.
Pas shkresave të përsëritura me nr. 879, datë 04.03.2026 dhe 27.03.2026, drejtuar SHUSHK Gjirokastër, nuk kemi pasur përgjigje brenda datës 31.03.2026 dhe sistemimi në kontabilitet nuk ka ndodhur për këtë llogari.
Me anë të shkresës 697/1, datë 09.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1186/1, datë 16.04.2026, SHUSHK Gjirokastër ka kthyer përgjigje, por pa dokumentacion bashkëlidhur. Theksojmë se vlera e raportuar nga KLSH, që duhej të shtohej, ishte 583,299,150.92 lekë, ndërkohë që llogaria "Pjesëmarrje në kapitale", transferuar në SHUSHK Gjirokastër, rezulton në vlerën 583,637,584 lekë, pra rreth 338,433.08 lekë më tepër. Procesi për zmadhimin e kapitalit është në proces, shprehet SHUSHK Gjirokastër, dhe Asambleja e Përgjithshme ka vendosur emërimin e një audituesi ligjor të pavarur për të kryer këtë proces.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi.**

12. Gjetje nga auditimi: - Nga analiza e llog. 466 *"Kreditorë për mjete në ruajtje"*, rezulton se për 30 projekte "investime" apo *"*mallra e shërbime*"* është ngurtësuar vlera e garancisë prej 19,872,610 lekë, nga të cilat: janë në proces gjyqësor dy OE për vlerën totale 3,967,642 lekë dhe për katër OE në vlerën totale 1,528,145 lekë ka kaluar afati sipas kontratës. Nga ana e DFB nuk janë marrë masa për zhbllokimin e kësaj llogarie, pasi Drejtoria e Urbanistikës nuk ka vijuar me procedurat për përmbylljen dokumentare të investimit dhe marrjen në dorëzim të tyre, duke patur parasysh dhe faktin që janë projekte të hershme (2016, 2019 dhe dy janë 2021), këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, pika 34, pika 35/a,b; Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018*, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.02.2022, nënkapitulli 2, seksioni 2.2, pika 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, në faqet 80-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandimi: Në Bashkinë Përmet, GMS, Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Zyrën Juridike të marrin masa konkrete për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara konform kuadrit ligjor përkatës dhe për zhbllokimin e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" veçanërisht për 4 projekt investimet e hershme në vlerën totale prej 1,528,145 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit
Gjatë procesit të auditimit, Drejtoria e Urbanistikës, në bashkëpunim me Sektorin Juridik, u ka dërguar shkresë subjekteve të cilët kanë kryer investimet në Bashkinë Përmet dhe më pas është vijuar me procedurën e marrjes në dorëzim përfundimtar të objekteve. Drejtoria e Buxhet Financës ka kryer çngurtësimet e fondeve menjëherë pasi dokumentacioni i nevojshëm për ç'ngurtësim është depozituar pranë kësaj drejtorie.
Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

13. Gjetje nga auditimi: mbi procedurën e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Përmet, u konstatua si më poshtë vijon:
- Në përfundim të procedurës së inventarizimit të aktiveve të njësisë, në Bashkinë Përmet nuk është hartuar nga Nëpunësi Zbatues dhe miratuar nga Nëpunësi Autorizues Regjistri i unifikuar i aktiveve të Bashkisë. Nga DFB, është hartuar vetëm regjistri elektronik i cili përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26,27,28 dhe Paragrafi IV pika 81 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar;
- Nuk është miratuar "Rregullore për menaxhimin e aktiveve" dhe Strategjia për mbrojtjen dhe menaxhimin e aktiveve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *"Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike",* Kreu II pika 17-25;
- Komisioni i inventarizimit fizik dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve nuk ka përpiluar proces verbalet për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit, në kundërshtim me pikën 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, por ka hartuar vetëm Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës.

13.1.Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit të marrin masa për të ndjekur rigorozisht hapat e procedurës së inventarizimit të aktiveve të dokumentuar më informacion të plotë dhe përzgjedhje të anëtarëve të komisioneve , sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi;
- Komisionet e inventarizimit të plotësojnë praktikat me dokumentacionin e plotë në formë dhe në përmbajtje, konform kuadrit ligjor në fuqi për procedurën e inventarizimit të aktiveve kryesisht përpilimin e procesverbaleve në çdo fazë të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Me anë të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 33, datë 03.02.2025, është ngritur komisioni "Për krijimin e komisionit të vlerësimit të aktiveve materiale dhe materialeve të tjera të dëmtuara". Për shkak të punës voluminoze, si dhe periudhës së gjatë të mosvlerësimit të aktiveve të dëmtuara, u shty afati i mbylljes së këtij procesi me anë të Urdhrit nr. 33/1, datë 30.04.2025, nga data 30.04.2025 në 16.06.2025. Me anë të VKB-së nr. 88, datë 22.10.2025, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit të inventarëve të dëmtuar. Me anë të Urdhrit të Kryetares është ngritur komisioni i asgjësimit dhe po vijohet me procesin.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar.**

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e strukturës përgjegjëse për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, u konstatua se informacioni tatimor përpunohet në paketën *"Microsoft Office 2013"* programi *"Excel"*, në mungesë të një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore. Mungesa e këtij sistemi sjell vështirësi në administrimin e informacionit tatimor për subjektet tatimpaguese, klasifikimin sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, etj; në mos përmbushje të kërkesave të Ligjit nr. 10296 /2010, datë 08.07.2010 *"Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin"* neni 22; Manuali i

MFK, Kap. III, Paragrafi 3.2 dhe, 3.3 pika*"*; *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2,6 faqe 54-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë dhe Sektori i taksave e tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit, të marrin masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukturore, për mirëadministrimin dhe mos kompromentimin e informacionit tatimor, si dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave;

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Bashkia Përmet nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me zbatimin e këtij rekomandimi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Nga auditimi i kryer rezulton se, nga ana e Bashkisë Përmet nuk ka një program kompjuterik të miratuar për regjistrimin e sistemit të tatim-taksave dhe regjistrimi i të dhënave të tatimpaguesve mbahet në programin "Excel", trajtuar më hollësisht në aktkonstatimin mbi të ardhurat dhe tatim-taksat.

Sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pazbatuar.**

15. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2024, u konstatua se:

- Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 9,880 mijë lekë dhe është vjelë 7,418 mijë lekë ose në masën 75% të saj, por vlera e saj ka ardhur në rënie prej (-) 1,833 mijë lekë më pak se në vitin 2023 ose me (-) 19%;
- Taksë tabele është parashikuar në vlerën 300 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 301 mijë lekë ose në masën 100%, krahasuar me vitin 2023 rezulton në rënie në vlerën prej (-) 79 mijë lekë ose (-) 28%;
- Të ardhura nga tarifa e pastrimit për vitin 2023 janë planifikuar 13,220 mijë lekë dhe janë realizuar 14,284 mijë lekë ose në masën 108%, krahasuar me vitin 2023 ka në rënie të realizimit të të ardhurave prej (-) 519 mijë lekë ose me (-) 3.5%;
- Të ardhura nga tarifa e ndriçimit janë planifikuar 4,550 mijë lekë dhe janë realizuar 4,037 mijë lekë ose 89%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie prej (-) 322 mijë lekë ose me (-) 7.4%;
- Tarifë e gjelbërimit për vitin 2024 është planifikuar 1,970 mijë lekë dhe realizuar 1,955 mijë lekë ose në masën 99%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 155 mijë lekë ose me (-) 6%;
- Tarifë për lëndët drusore për vitin 2024 është planifikuar 810 mijë lekë dhe realizuar 589 mijë lekë ose në masën 73%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 23 mijë lekë ose (-) 3.8%;
- Tarifë kullotë bagëtije për vitin 2024 është planifikuar 1,230 mijë lekë dhe realizuar 1130 mijë lekë ose në masën 92%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-) 148 mijë lekë ose (-) 11.6%;
- Tarifë parkimi për vitin 2024 është planifikuar 250 mijë lekë dhe realizuar 60 mijë lekë ose 24%, krahasuar me vitin 2023 ka rritje me 7 mijë lekë ose me 11.7%.

Mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e GMS për të ardhurat e (mos) realizuara në vitin 2023, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlera jo reale të pastudiuara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë.

- Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2024 rakordimet me DPSHTRR, ASHK Vendore, DPD dhe DPT, nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MF, këto veprime janë në kundërshtim me. Ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*" i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, ligjin nr. 9920/2008 datë "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ligjin nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar, UMF nr. 26 datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12 datë

04.04.2017 etj, *"Për Taksat Kombëtare"*. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2,6 faqe 54-80 të Raportit Përfundimtartë Auditimit).*

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Ekonomike dhe STT të analizojnë me vëmendje të shtuar shkaqet që kanë sjellë mosrealizimin e të ardhurave nga taksat e tarifat përkatëse sipas parashikimit vjetor, si dhe të marrin masa për hartimin e planeve strategjik e vjetor jo vetëm për rritjen e të ardhurave nga arkëtimi i detyrimit vjetor të tatimpaguesve, por edhe për minimizimin e vlerës së debisë progresive.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit

Planifikimi i të ardhurave është kryer pas konsultimesh të shumta me GMS dhe sektorët e realizimit të të ardhurave. Mosrealizimi në nivelet e një viti më parë nuk lidhet me mosplanifikimin e drejtë, por me ndryshimet e bazës së taksueshme, si dhe me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura. Shkresa nr. 3036 prot., datë 19.09.2025, me lëndë "Raportim për detyrimet e prapambetura", drejtuar GMS. Në zbatim të këtij rekomandimi kemi marrë masat e mëposhtme për të ulur borxhin tatimor të vitit 2025 dhe detyrimet e prapambetura të viteve 2015-2024.

Kemi marrë masë duke çuar te Sh.A. Ujësjellës vlerën e detyrimit të vitit 2025, për të gjithë subjektet që kanë kontrata uji me këtë institucion, e cila nuk është mbledhur deri më sot dhe, në bazë të një analize që është bërë për pritshmëritë deri në fund të vitit, duke analizuar gjithë bazën e të dhënave për të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Përmet, konform VKB-së nr. 77, datë 17.09.2025, janë nisur listat e subjekteve debitore me shkresë nr. 3762 prot., datë 10.11.2025. Po kështu, vlera e debisë së prapambetur nga viti 2015-2024, për të gjithë subjektet aktive, do të vilet po nga Sh.A. Ujësjellës Gjirokastër, në bazë të marrëveshjeve me këste të nënshkruara midis Bashkisë Përmet dhe subjekteve debitorë.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar dhe afatit të përcaktuar "menjëherë" për zbatimin e rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

15.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit, Drejtorinë Ekonomike dhe Sektorin e të Ardhurave nga taksa e tarifa vendore, dhe gjithë strukturat që sigurojnë të ardhura nga aktiviteti i tyre të marrin masa:

- Për planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshme dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;
- Për të kryer rakordim periodik mujor dhe vjetor me agjentët tatimor DRSHTRR Gjirokastër, DRT Gjirokastër, DPD/Dogana "Tre urat" Përmet dhe ASHK Vendore Gjirokastër, sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Përmet nga taksat që mblidhen nga këta agjentë.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit

Faktikisht, në planifikimin vjetor të të ardhurave jemi mbështetur konkretisht në realizimin e vitit të mëparshëm për të qenë sa më afër një planifikimi realist dhe kjo ka qenë motoja e punës sonë për të mos fryrë buxhetin e vitit me shpenzime të cilat nuk realizohen për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, gjë e cila vërtetohet me faktin që në fund të vitit 2024 nuk kemi fatura të palikuiduara të paraqitura në bilanc përveç faturave të muajit Dhjetor 2024 të cilat paguhen në muajin Janar

të vitit 2025. Janë nisur shkresat për të gjithë agjentët tatimorë sipas formatit të miratuar nga MF dhe janë mbyllur rakordimet vjetore për vitin 2025.

Agjenti Tatimor	Lloji I Taksës	31.12.2024	31.12.2025
Degën e Shfrytëzimit të Automjeteve	Taksë për rregjistrimin e përvitshëm të automjeteve	6,282,438	6,964,859
Drejtoria Rajonale të Tatimeve	Tatim i thjeshtuar fitimi	153,588	38,362
Drejtorinë Rajonale të ASHK-së,		97,250	111,653
Drejtoria Rajonale të Tatimeve	Renta minerare	-	43,538
SHRUKGJ	Taksa vendore popullata,biznesi		15,842,763

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa i përket zbatimit të këtij rekomandimi, bazuar në tabelën "Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Përmet për vitın 2025", treguesi i të ardhurave mbi taksat dhe tatimet është në vlerën 105.3%, pra në tejkalim të realizimit të planit vjetor miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe analiza e informacioneve mbi aktivitetin dhe taksat e kategorisë biznes, u konstatua se në Bashkinë Përmet rezultojnë 11 subjekte të cilat ushtrojnë më shumë se një aktivitet në territorin e biznesit të tyre me të njëjtin Nipt, por që paguajnë detyrime ndaj Bashkisë vetëm për një aktivitet të deklaruar. Këto veprime janë kundërshtim me kuadrin ligjor/nënligjor për taksat dhe tarifat në Republikën e Shqipërisë ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar dhe ligjin nr. 9723/2007 "*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2,6 faqe 54-80 të Raportit Përfundimtartë Auditimit).*

16.1.Rekomandimi: Drejtoria ekonomike dhe e të ardhurave vendore dhe Njësitë Administrative, dhe gjithë strukturat e Bashkisë që nga funksioni i tyre sigurojnë të ardhura për buxhetin e Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit dhe Zyrën Juridike të marrin masa për të riverifikuar në terren çdo subjekt që ushtron aktualisht aktivitet në territorin e Bashkisë Përmet, duke:

- identifikuar subjektet që ushtrojnë më shumë se një aktivitet të pa deklaruar,
- të rillogarisin vlerën e saktë të detyrimeve vjetore të pa paguara të këtyre subjekteve, referuar kuadrit ligjor dhe vlerës së përcaktuar në VKB që ka miratuar "paketën fiskale të vitit ushtrimor 2025"

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit

Në 11 subjektet e sipërshënuara, vetëm 2 subjekte e ushtrojnë aktivitetin në godina të ndryshme. Subjektet e tjera e ushtrojnë aktivitetin në të njëjtin objekt me të njëjtat hyrje.
Për të dy subjektet janë nisur faturat si më poshtë:
-Subjekti A. M. Fatura nr.47, datë 11.11.2025 dhe fatura nr.45, datë 11.11.2025
-Subjektit R. N. Fatura nr.46, datë 11.11.2025.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Bashkia Përmet ka marrë masa për të riverifikuar në terren çdo subjekt që ushtron aktualisht aktivitet në territorin e saj dhe si rezultat i këtyre verifikimeve shprehet se, vetëm 2 subjekte e ushtrojnë aktivitetin në godina të ndryshme. Megjithatë, grupit të auditimit nuk i janë vendosur në

dispozicion informacione dhe dokumentacion në lidhje me vaprimtarinë dhe aktivitetin e 9 subjekteve të tjera, me qëllim kryerjen e verifikimit për to.
Sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

17. Gjetje nga auditimi: Mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë për vitin 2024, u konstatua se, në buxhetin vjetor të vitit 2024 nuk është planifikuar Fond kontigjence, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 "*Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" neni 6 ku përcaktohet se këto fonde [FR] dhe [FK] llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara; Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me një diferencë prej 4,103 mijë lekë;*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 34-54 të Raportit Përfundimtartë Auditimit).*
17.1.Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të planifikohen në buxhet Fondi i kontigjencës; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta mbi arsyet e realizimit dhe mosrealizimit të buxhetit në total dhe për çdo zë buxhetor, sipas programeve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Në vijimësi

Shpjegimet e subjektit:

Ky rekomandim nuk qëndron, pasi Bashkia Përmet ka pasur çdo vit fond kontigjence dhe fond rezervë të planifikuar në buxhet sipas specifikimeve ligjore.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së
Ky rekomandim nuk është kundërshtuar gjatë fazës sëpunës në terren dhe pas dërgimit të dokumentacionit përkatës të auditimit (akt konstatimet dhe projekt raporti i auditimit) si dhe me pergjigjen për zbatimin e rekomandimit, ndaj nuk merret parasysh.
Sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i pa zbatuar**.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuiditeteve dhe informacionit të pasqyruar në tabelën "detyrime të prapambetura*"*, nëpjesën narrative të materialit rezulton se, kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2024 në shumën 13,956,508 lekë, krahas vlerës së trashëguar nga viti 2023 në shumën totale progresive 30,119,149 lekë për "investime" dhe "mallra e shërbime". Gjatë vitit 2024 janë paguar 41,426,683 lekë duke e mbyllur vitin 2024 me një vlerë të detyrimit progresiv të hershëm prej 2,648,974 lekë.
Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE. Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin përkatës 04960, do të rezultonte me një menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetuar, në rast se nuk do të ishin reduktuar numri i programeve buxhetore nga MFE nëpërmjet Udhëzimeve përkatëse të përgatitjes së PBA-ve nga Njësitë e Vetëqeverisjes vendore.
- Bashkia Përmet *ka detyrime të* mbartura nga viti 2024 dhe trashëguar për t'u likuiduar në vitin 2025 për *"shërbime*" në shumën 2,346,886 lekë;
- Ka detyrime për Vendime gjyqësore dëmshpërblim, në shumën 302,088 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 *"Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 "Për proçedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"* shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 6 datë 28.02.2023 *"Për përgatitjen e*

programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026", UMF nr. 6 datë 28.02.2023 *"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026",* VKM nr. 50 datë 05.02.2014 *"Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shhlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*" i ndryshuar, Udhëzimi nr. 5 datë 27.02.2014 *"Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*" i ndryshuar*,.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet 34-54.të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e riskut dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrit të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjes së detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/mallra apo vendimeve gjyqësore; për të paguar detyrimet sipas planit të miratuar dhe raportuar në MFE për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën 2,648,974 lekë deri në fund të vitit 2025; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre në afat dhe sipas radhës; si dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të prapambetura në periudhat e ardhme;

- Drejtoria e Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më real të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

Në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Gjatë vitit 2024, Bashkia Përmet nuk ka krijuar detyrim të ri. Moslikujdimi i këtyre detyrimeve vjen, jo për mungesë likujditeti apo parashikimi, por për pasojë të shtyrjes së proceseve gjyqësore.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **zbatuar pjesërisht.**

19. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Përmet për zbatimin e rekomandimeve të KLSH përcjellë në RPA me shkresën e saj nr. 493/6 prot., datë 30.07.2024, rezultoi se: nga Bashkia Përmet është bërë raportimi në KLSH për miratimin e Planit të veprimit brenda afatit 20 ditor; është bërë raportimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor; është bërë raportimi në Këshillin Bashkiak mbi gjetjet dhe rekomandimet e KLSH-së përcjellë në RPA; konstatohet se, është një masë e konsiderueshme e tyre (përfshirë edhe ato të rikërkuara), për të cilat në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit",* rikërkohet marrja e masave për zbatimin e atyre rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe të pa zbatuara.

a. Masa Organizative janë lënë 27 masa që janë pranuar 26 masa nga subjekti, nga të cilat: 13 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proçes zbatimi, 0 masa pa zbatuar**;**

b. Masa për eleminimin e efekteve negative në përdorimin me 3E të fondeve publike/ administrimin e të ardhurave të munguara janë lënë 4 masa që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat: 2 masa janë zbatuar, 1 masë në proces zbatimi, 1 masë është pjesërisht zbatuar, 0 masa pa zbatuar;

c. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara) janë

lënë 6 masa në vlerën totale 51,106 mijë lekë që janë pranuar nga subjekti nga të cilat: 2 masa janë zbatuar, 2 masa janë në proces zbatimi, 0 masa pa zbatuar dhe 2 masa pjesërisht zbatuar;
d. Masa disiplinore, janë lënë 2 masa, nga të cilat masa E1 është zbatuar dhe masa E për 2 punonjës është e pazbatuar; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqe 167-196 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrolli të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa Organizative

11.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori Juridik dhe i Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin e Tatim-Taksave të marrë masa në vijimësi, për të gjithë subjektet që kanë lidhur kontratë investimesh me bashkinë, pajisjen e tyre me nipt sekondar dhe përllogaritjen e taksave dhe tarifave vendore deri në momentin e përfundimit të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1. Rekomandim: Nga Drejtoria e Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve, të marren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.
Me përfundimin e vlerësimit të kapitalit nga "UKR Gjirokastër" Sha

23.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa që me grup pune, të cilët të jenë specialist të fushës, të hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht, nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Mbi bazën e evidentimit në regjistrin e aktiveve, të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në terren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

23.2. Rekomandim: Bashkia Përmet të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarisë 210 "Toka, troje, Terrene", 211 "Pyje, Kullota Plantacione", 212 "Ndërtesa e konstruksione" dhe 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave (të transferuara), sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. Masa për Elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.

25.1/2.1. Rekomandimi (e njëjtë me 12.1 Rekomandim / MO) Bashkia Përmet, Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Tatim Taksave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve prej 2,000,000 lekë nga 2 subjektet, respektivisht:
-**Vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti "S.G" shpk",
-**Vlera 1,000,000 lekë** nga subjekti "G.G." shpk.

Menjëherë

C. Masa për Uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)

2.2. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave në bashkëpunim me Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Urbanistikës dhe Shërbimeve për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Gjirokastër vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1. Rekomandim: Bashkia Përmet, Sektori i Tatim-Taksave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e ndërtesave/objekteve në total në vlerën 2,808,417 lekë duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë

C. Masa Disiplinore

E. Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Përmet t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes, për 2 punonjës, respektivisht:

1. Znj. E. K, me status nëpunësi civil me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës-Buxhetit, Taksave dhe Tregjeve në cilësinë e nëpunësit zbatues, nënshkrues i pasqyrave financiare.

2. Z. D. M. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mos mbajtjen e regjistrave për abonentët familjarë, mos mbajtjen e akt rakordimeve me agjentit tatimor UK Sh.A Përmet.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit

Në zbatim të Ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për Përpunimin, Transportimin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre", Vendimit Nr. 970, datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për Përcaktimin e Procedurave dhe të Kushteve për Dhënien e Licencave për Tregtimin e Naftës Bruto dhe Nënprodukteve të Saj", i ndryshuar, si dhe detyrave të lëna nga KLSH për vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga subjektet:

1. *SUBJEKTI: "G" SHPK, NIPT K.....T.*

Objekti: Tregtim me pakicë i karburanteve e lubrifikantëve, pikë gazi dhe transport i tij. Referuar QKB-së, ka filluar aktivitetin më datë 06.01.2022, me adresë: Pikë karburanti, pranë zonës së ish-Parkut, aksi Këlcyrë – Përmet, krahu i djathtë në hyrje të qytetit të Përmetit.

Me shkresën nr. 1366 prot., datë 29.04.2022, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit "G" SHPK me objekt: Njoftim për pajisje me licencë për ushtrim aktiviteti.

Me shkresën nr. 3402 prot., datë 08.11.2022, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit "G" SHPK me objekt: Njoftim për pajisje me licencë për ushtrim aktiviteti.

Po me shkresën nr. 2373 prot., datë 12.09.2023, Bashkia Përmet i është drejtuar përsëri subjektit "G" SHPK me objekt: Njoftim për pajisje me licencë për ushtrim aktiviteti.

Me shkresën nr. 3381 prot., datë 22.12.2023, Bashkia Përmet i është drejtuar Inspektoriatit Shtetëror Teknik, Drejtorisë së Inspektimit të Naftës dhe Gazit, si dhe për dijeni subjektit "G" SHPK, me objekt: Kërkesë për bashkëpunim institucional në bazë të Vendimit nr. 344, datë 19.04.2017 (pika 15.1), për marrjen e masave dhe bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me licencë për ushtrim aktiviteti. Inspektoriati Shtetëror Teknik, me shkresën nr. 11143/1, datë 27.12.2023, me objekt: Kthim përgjigje, thekson se ky subjekt do të inspektohet.
Me shkresën nr. 2127 prot., datë 22.08.2024, Bashkia Përmet i është drejtuar përsëri Inspektoriatit Shtetëror Teknik, Drejtorisë së Inspektimit të Naftës dhe Gazit, si dhe për dijeni subjektit "G" SHPK, me objekt: Kërkesë për bashkëpunim institucional në bazë të Vendimit nr. 344, datë 19.04.2017 (pika 15.1), për marrjen e masave dhe bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa u pajisur me licencë për ushtrim aktiviteti. Inspektoriati Shtetëror Teknik, me shkresën nr. 12323/1, datë 09.09.2024, me objekt: Kthim përgjigje, thekson se ky subjekt është inspektuar nga ana e tyre.
Në përgjigje të shkresave drejtuar këtij subjekti nga Bashkia Përmet:
Subjekti "G" SHPK, NIPT K.....T, në datën 03.09.2024 ka regjistruar kërkesën me nr. prot. 2250 pranë Bashkisë Përmet për t'u pajisur me licencë për tregtimin e karburanteve dhe gazit të lëngshëm për konsumatorët fundorë.
Subjekti "G" SHPK, NIPT K.....T, ka kryer katër pagesa:
Pagesa 1, sipas faturës nr. 119, datë 03.10.2024, në vlerën 200 000 lekë për periudhën 06.01.2022 – 06.01.2023, e arkëtuar në datën 03.10.2024.
Pagesa 2, sipas faturës nr. 144, datë 26.11.2024, në vlerën 200 000 lekë për periudhën 06.01.2023 – 06.01.2024, e arkëtuar në datën 26.12.2024.
Pagesa 3, sipas faturës nr. 149, datë 17.12.2024, në vlerën 200 000 lekë për periudhën 06.01.2024 – 06.01.2025, e arkëtuar në datën 26.12.2024.
Pagesa 4, sipas faturës nr. 63, datë 10.11.2025, në vlerën 200 000 lekë për periudhën 06.01.2025 – 06.01.2026, e arkëtuar në datën 10.11.2025.
Në total, subjekti "G" SHPK, NIPT K.....T, ka kryer likuidimin në vlerën 800 000 lekë për periudhën 06.01.2022 – 06.01.2026.
Me shkresën nr. 1285 prot., datë 03.04.2026, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit "G" SHPK me objekt: Njoftim për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Pagesa 5, sipas faturës nr. 14, datë 08.04.2026, në vlerën 200 000 lekë për periudhën 06.01.2026 – 06.01.2027, e arkëtuar në datën 14.04.2026.
Në total, subjekti "G" SHPK, NIPT K.....T, ka kryer likuidimin në vlerën 1 000 000 lekë për periudhën 06.01.2022 – 06.01.2027.

2. *SUBJEKTI: "S" SHPK, NIPT K.....V.*

Ka filluar aktivitetin më datë 30.04.2018 dhe ka përfunduar (mbyllur) aktivitetin më datë 29.04.2023. Subjekti ka qenë i pajisur me licencë me nr. 1, datë 01.10.2021, e cila ka përfunduar më datë 25.09.2022. Subjekti ka kryer pagesë për një periudhë 1-vjeçare në vlerën 200 000 lekë. Subjekti është debitor në vlerën 800 000 lekë.
Me shkresën nr. 1190 prot., datë 13.04.2022, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit "S" SHPK me objekt: Njoftim për shlyerje detyrimesh dhe pajisjen me licencë për ushtrim aktiviteti.
Me shkresën nr. 3401 prot., datë 08.11.2022, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit "S" SHPK me objekt: Njoftim për pajisjen me licencë për ushtrim aktiviteti.
Me shkresën nr. 3766 prot., datë 10.11.2025, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit "S" SHPK me objekt: Njoftim për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Me shkresën nr. 1286 prot., datë 03.04.2026, Bashkia Përmet i është drejtuar subjektit "S" SHPK me objekt: Njoftim për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Hapat e ndjekura për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 2,808,417 lekë:
Subjekti "R" SHPK ka paguar më datë 22.02.2024 vlerën 129,000 lekë. Subjekti "R" SHPK ka paguar më datë 23.01.2024 vlerën 129,000 lekë.
Gjithsej: 258,000 lekë.
"V.A" ka paguar vlerën 341,487 lekë më datë 04.01.2024.
Gjithsej: 602,686 lekë.
Nuk është realizuar vlera 2,208,930 lekë për kontratën me subjektin "K", me të cilin jemi në proces gjyqësor.
b. Kontratat për tokat bujqësore, në vlerën 69,367 lekë:
Qiramarrësi A. D. – 11,607 lekë, paguar më datë 08.04.2025.
Qiramarrësi "G" SHPK – 48,360 lekë, paguar më datë 01.10.2025.
Bashkëlidhur gjeni aktet e pagesave të mësipërme.
Është ngritur grupi i punës me Urdhër nr. 479, datë 10.11.2025, për verifikimin në terren të të gjithë pronave, gjendjes faktike dhe juridike, për t'u bërë përditësimi i inventarit të pasurive në përputhje me gjendjen reale dhe pajisjen e tyre me certifikata pronësie, duke reflektuar ndryshimet nga legalizime, privatizime, kthime/kompensime apo vendime gjyqësore. Ka filluar puna e grupit në terren për verifikimin e pasurive sipas blloqeve kadastralë të transferuar me VKM përkatëse për çdo njësi administrative. Sipërfaqet e verifikuara po rakordohen me hipotekën.
Vlen të përmendet se deri më sot nuk ka një regjistrim të plotë të aseteve të Bashkisë Përmet, kjo për arsye se: Ka ndryshim të sipërfaqes dhe llojit të pronave ndërmjet atyre që janë transferuar me VKM përkatëse, krahasuar me ato që janë regjistruar në ASHK.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, për zbatimin e rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Përmet nuk ka hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për implementimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm sipas komponentëve të MFK. Për periudhën objekt auditimi rezultoi se: nuk ka krijuar një strukturë efektive konform kuadrit ligjor, nuk ka përditësuar formularët e përshkrimit të punës për pozicionet me Kod Pune si dhe nuk bëhet shpallja e tyre në AKPA; nuk ka planifikuar dhe zhvilluar programe trajnimi për stafin, përfshirjen e gjithë stafit në trajnimet e zhvilluara nga ASPA me qëllim njohjen nga ana e tij me Ligjin dhe Manualin e MFK; nuk ka miratuar regjistrin e unifikuar dhe strategjinë e riskut, gjurmët standarde të auditimit, rregullore të menaxhimit të aktiveve; nuk ka takime të dokumentuara të GMS, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike, duke zbehur rolin e tij për arritjen e objektivave të njësisë publike; nuk ka hartuar dhe miratuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës; mosimplementim të sistemeve dhe programeve IT të avancuara veçanërisht në procesin e vjeljes së të ardhurave vendore dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese për të minimizuar riskun e kompromet imit të të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë; plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacion të përditësuar. Mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar; Manualin MFK miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54 datë 15.07.2010 i ndryshuar me atë nr. 108 datë 17.11.2016. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 15-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për përmirësimin e komponentëve të MFK dhe veçanërisht për forcimimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, nëpërmjet: rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të Kordinatorit të MFK dhe Kordinatorit të riskut; plotësimit të kuadrit rregullator me krijimin e një strukture efektive, miratimin e proceseve të punës, rregullores për menaxhimin e aktiveve dhe të gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; forcimit dhe standardizimit në implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT të avancuara, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në Bashki.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Në zbatim të këtij rekomandimi, gjatë kësaj periudhe janë miratuar:

- *Me anë të Urdhrit nr. 44, datë 11.02.2025, është krijuar GMS.*
- *Me anë të Udhëzimit të Brendshëm nr. 1166, datë 07.04.2025, janë hartuar të gjithë hapat për mbledhjet e GMS.*
- *Regjistri i riskut është miratuar me Vendimin nr. 45/1, datë 08.04.2025.*
- *Manuali i proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore është miratuar me nr. 308, datë 31.01.2025.*

Në buxhetin e vitit 2026 është miratuar zëri për krijimin e një serveri, pasi aktualisht Bashkia Përmet nuk ka sisteme të veta, përveç atyre të nivelit qendror.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar dhe afatit të përcaktuar "në vijimësi" për zbatimin e rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

20.2.Rekomandimi: GMS, Kordinatori i MFK si dhe Kordinatori i riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor të tij për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojnë dhe grafikun e takimeve që do realizojnë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësisë publike në tërësi, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Me anë të Urdhrit nr.44, datë 11.02.2025 është Krijuar GMS. Me anë të Udhëzimit të Brendshëm nr.1166, datë 07.04.2025 janë hartuar të gjithë hapat për mbledhjet e GMS.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar dhe afatit të përcaktuar "në vijimësi" për zbatimin e rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

20.3.Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit dhe specialistit IT, si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj duke zbatuar procedurat ligjore të punësimit, përditësimin e formularëve të përshkrimit të punës për pozicionet me Kod pune dhe dosjeve të personelit me dokumentacion të përditësuar, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që bashkisë i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Ju bëjmë me dije se nga ana e sektorit të Burimeve Njerëzore janë marrë masa duke bërë përditësimin e të gjitha dosjeve të personelit me dokumentacionin përkatës.
Me shkresën nr 3016/1 datë 10.11.2023 janë përcjellë nevojat për trajnim për vitin 2024 dhe me shkresën nr.2770/1 datë 27.10.2024 janë përcjellë nevojat për trajnim për vitin 2025 drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktivitetin e NJAB u konstatua se, Bashkia Përmet e ushtron aktivitetin e saj në mungesë të NJAB, pasi NJAB e miratuar është me vende vakante. Deri në 31.12.2024 nga ana e saj nuk është mundur të plotësohen vendet vakante në strukturën e NJAB si dhe nuk ka arritur të realizojë bashkëpunim me NJVQV të tjera për të siguruar ofrimin e shërbimit të auditit të brendshëm të tyre nëpërmjet Akt marrëveshjeve, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "*Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*" i ndryshuar me atë nr. 2 datë 02.02.2023; Manualin e AB mirtatuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 100 datë 25.10.2016.i ndryshuar me atë nr. 4 datë 10.01.2020; VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "*Për miratimin e kritereve për themelimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik*" të ndryshuar me VKM nr.353, datë 05.11.2016 etj; *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 32-34 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*.

21.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të marri masa për plotësimin e strukturës me auditues të brendshëm, ose të sigurimit të ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet akt marrëveshjeve me Bashkitë Fqinje.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit

Nga ana e sektorit të Burimeve Njerëzore janë bërë disa shpallje për pozicionin Specialist Audit, por nuk ka patur asnjë kandidat:
Shpallja me nr. 284 prot., datë 29.01.2025, për pozicionin Specialist Audit i Brendshëm.
Shpallja me nr. 1756/1 prot., datë 05.06.2025, për pozicionin Specialist Audit i Brendshëm.
Shpallja me nr. 2169 prot., datë 04.07.2025, për pozicionin Specialist Audit i Brendshëm.
Shpallja me nr. 3438 prot., datë 14.10.2025, për pozicionin Specialist Audit i Brendshëm.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.1 1.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"* neni 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligiin nr. 44/2015, datë 30.04,2015 *"Kodi procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë"* nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *"Per vetëqeverisjen vendore"* nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30. datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, pika 93, nga Titullari i Niësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllin shpërblimin e dëmit në vlerën 2,639,733 lekë pa TVSH, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me nr. 4027 prot., datë 28.12.2022 te lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H. dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "E" SHPK me NIPT J.....0 dhe, Lic. Nr. NZ. 3374/7 përfaqësuar nga Administratori Z. H. M. dhe OE "C" SHPK me NIPT J.....S dhe, Lic. Nr. NZ. 0005/24 me përfaqësues ligjor Z. F. C. me vlerë të kontratës 12,564,245 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 60 (gjashtëdhjetë) ditë, nga nënshkrimi kontratës nga data e lidhjes së kontratës me mbikëqyrësin e punimeve, kjo sipas afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit dhe të pranuar nga operatori ekonomik në tender, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt - preventiv, përkatësisht: [Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva; F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham; FV Fikse zjarri me Co2, destinacioni për mbrojtje e pajisjeve elektrike nga zjarri, kapaciteti 6 kg:], me **pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Përmet në vlerën **664,487 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligiin nr. 8402, datë 10,09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Me hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **664,487 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE "E" SHPK & "C" SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 4027 prot., datë 28.12.2022 me obiekt "Termoizolimi dhe përmirësimi i sistemit të ngrohjes i konviktit Përmet".

Menjëherë

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 107 prot., datë 11.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet përfaqësuar nga Kryetari Znj. A. H. dhe shoqërisë "S" SHPK me NIPT K.....S dhe, Lic. Nr. NZ. 8082 përfaqësuar nga Administratori Znj. A. B. me vlerë të kontratës 11,439,482.70 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 3 (tre) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt - preventiv, përkatësisht: [Nënshtresë zhavorri; F.V Tuba çeliku 0>200 të pa izoluar për uiësiellësa të iashtëm (tubi i thithies 1-25 m): F.V Valvula moskthim eliku me fllanxha. Pn deri 25 bar. 0250 (Valvula e thithies): F.V Valvula moskthimi çeliku me llanxha. Pn deri 25 bar. 0 200 mm: F.V Saraçineska gize me fllanxha, Pn deri 16 bar 0>200; Shkallë metalike me hekur dhe profile (për të zbritur tek vepra e marries); Hekur betoni (për bazamentin e tij); Rrethim me kollona b/a + rrjetë teli (paneli + kabina + pompa)], **me pasojë dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Përmet, në **vlerën 1,241,795 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në piken 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,241,795 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "S" SHPK, për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 107 prot datë 11.01.2023 me objekt "Rehabilitimi i kanalit ujitës Piskovë", Bashkia Përmet.

Menjëherë

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H.

dhe shoqërisë "2." SHPK me NIPT K.....M dhe, Lic. Nr. NZ3455/15 përfaqësuar nga Administratori Z. A. S. me vlerë të kontratës 46,434,882 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, përkatësisht: [Shtresë stabilizanti t=10 cm; Struktura të holla monolite betoni C 16/20 (betone kthesat)], **me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Përmet, në vlerën 405,500 lekë pa TVSH.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Me hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),*

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **405,500 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "2." SHPK, për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 me objekt: "Rehabilitimi i digës së rezervuarit Pacomit, Bashkia Përmet".

Menjëherë

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me nr. 79 prot., datë 09.01.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet,. përfaqësuar nga Kryetari Znj. A. H. dhe shoqërisë "H." SHPK me NIPT J.....O dhe, Lic. Nr. NZ. 1246/12 përfaqësuar nga Administratori Z. A. H. me vlerë të kontratës 38,063,788 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 6 (giashtë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve të parashikuara në projekt - preventiv, përkatësisht: [Trotuar, me 6 cm, me pllaka], **me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Përmet, në vlerën 327,951 lekë pa TVSH.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Me hollësisht trajtuar në piken 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit),*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **327,951 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "H" SHPK për punime të pa kryera, parashikuar në kontratën me nr. 79 prot., datë 09.01.2023 me objekt: "Sistemim asfaltimi i rrugës Spital - Varreza".

Menjëherë

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore, u konstatua se deri në datën 31.12.2024, borxhi tatimor progresiv është në vlerën totale 97,956,740 lekë, nga e cila vlera totale progresive e debisë (e kontabilizuar) është 92,232,291 lekë dhe përbëhet si më poshtë vijon:

- Detyrime nga kategoria “biznes”, në vlerën 24,682,418 lekë për 133 debitorë (pa kamatë);
- Detyrime nga kategoria “institucione” në vlerën 1,519,500 lekë për 6 debitorë;

Kamata e llogaritur nga vlera e debisë është 4,248,982 lekë

- Detyrime nga TNI, në vlerën 1,432,320 lekë për 60 debitorë;
- Detyrime nga taksa e tarifa vendore debitorë familjarë dhe biznes nga ish komunat (deri në 31.12.2015), në vlerën 33,616,134 lekë për një numër të pacaktuar debitorësh;
- Detyrime nga "UK Përmet"–sha në vlerën 26,492,937 lekë për arkëtime të periudhës 2017-2019 të pa derdhura në buxhetin e Bashkisë Përmet;
- Detyrime të gjobave të vendosura nga IMT në vlerën 240,000 lekë;
- Debitorë *pa shpresë arkëtimi* janë 191 subjekte në vlerën e debisë 13,805,893 lekë;

Në Bashkinë Përmet gjatë vitit 2024 nga Drejtoria e Financës, buxhetit dhe treg nuk është shtruar për diskutim në takimet e GMS, mosarkëtimi i shumës progresive debitore të periudhës deri në 31.12.2024 prej 92,232,291 lekë në total, veçanërisht për 191 debitorët problematik në shumën 13,805,893 lekë si dhe analizës së shumës 33,616,134 lekë e taksave të hershme nga ish komunat. Si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, deri tani nuk ka një plan masash konkret për arkëtimin e tyre. Mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920/2008 datë 19.5.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*" i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 54-80 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të marrin masat për verifikimin e listës së debitorëve të trashëguar nga ish komunat për saktësimin e numrit dhe të debitorëve si dhe arkëtimin e vlerës debitore 33,616,134 lekë.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit

Të hartohen listat e debitorëve nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik,Bujqësisë dhe Turizmit dhe t'iu shpërndahen njësive Administrative. Brenda datës 31.12.2025 ky informacion të përcillet në Drejtorinë e Financë Buxhet. Borxhi tatimor për periudhën 2015–2024 për subjektet e kategorisë biznes ka qenë në vlerën 24,682,418 lekë, për institucionet ka qenë 1,519,500 lekë, pa kamatë, ndërsa kamata e llogaritur ka qenë në vlerën 4,248,982 lekë. Gjatë vitit 2025, borxhi tatimor për këtë periudhë është ulur në total në vlerën 2,034,333 lekë, i ndarë si më poshtë:

-Kategoria biznes: principali në vlerën 1,200,147 lekë dhe kamata në vlerën 148,246 lekë. Kanë paguar gjithsej 48 biznese.

-Kategoria institucione: principali në vlerën 677,984 lekë dhe kamata në vlerën 7,956 lekë. Kanë paguar 5 institucione nga 9.

Detyrimet nga TNT, borxhi i periudhës deri në vitin 2024, janë në vlerën 1,432,320 lekë për 60 debitorë. Gjatë vitit 2025 ky borxh është ulur me 247,252.5 lekë. Kanë paguar 9 persona.

Detyrimet që SHA Ujësjellës Gjirokastër ka ndaj Bashkisë Përmet janë në vlerën 26,492,937 lekë. Borxhi nuk është ulur dhe mbetet në të njëjtën vlerë. Bashkëlidhur gjeni shkresat që Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka nisur për Agjentin Tatimor SHA Ujësjellës Gjirokastër, AKUK dhe Ministrinë e Infrastrukturës:

Shkresa nr. 89, datë 13.01.2025, Kthyer përgjigje me shkresën nr. 107/1, datë 16.01.2025
Shkresa nr. 290/1, datë 12.02.2025, Kthyer përgjigje me shkresën nr. 290/2, datë 02.04.2025
Shkresa nr. 1973, datë 23.06.2025
Shkresa nr. 2676, datë 19.08.2025
Shkresa nr. 3977, datë 27.11.2025
Shkresa nr. 2676/2, datë 17.04.2025
Shkresa nr. 4020, datë 02.12.2025

Shkresa nr. 437, datë 02.02.2026, Kthyer përgjigje me shkresën nr. 559/1, datë 08.04.2026
Shkresa nr. 1603, datë 30.04.2026
Shkresa nr. 437, datë 02.02.2026
Detyrimet nga taksat dhe tarifat vendore për debitorë familjarë dhe biznese nga ish-komunat dhe Bashkia Përmet, para vitit 2015, në vlerën 33,616,134 lekë, nuk kanë pasur ulje të borxhit tatimor. Detyrimi i gjobave nga IMT në vlerën 240 lekë nuk ka pasur arkëtim për këtë periudhë.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Bashkia Përmet ka kryer verifikimin e listës së debitorëve të trashëguar nga ish komunat për saktësimin e numrit të debitorëve, por nuk ka arritur të realizojë arkëtimin e vlerës debitore 33,616,134 lekë. Sa më sipër, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, rezulton se janë aktive gjithsej 52 kontrata për dhënien me qira të aseteve në administrim të Bashkisë Përmet. Referuar këtyre kontratave, konstatohet se Bashkia Përmet nuk disponon titull pronësie për pasuritë e dhëna me qira, gjë që cenon sigurinë juridike të administrimit dhe dhënies në përdorim të aseteve publike.
Gjithashtu, Bashkia Përmet ka në administrim 22 apartamente të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave, të cilat i janë dorëzuar për qëllime privatizimi. Sipas vendimeve përkatëse, Bashkia ka detyrimin të lidhë kontrata shitjeje me rezervë me subjektet përfituese nga privatizimi. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se janë lidhur kontrata me 18 prej këtyre subjekteve, ndërsa 4 kontrata mbeten ende të pakonkluduara.
Në lidhje me detyrimet financiare, deri më datë 31.12.2024 rezultoi se:
-Vlera e detyrimeve të papaguara nga kontratat e qirasë është 1,641,667 lekë;
-Vlera e detyrimeve të papaguara nga këstet e kontratave të shitjes me rezervë është 343,261 lekë.
Për sa më sipër konstatohet se nga titullari i institucionit nuk janë marrë masa për ngritjen e grupeve të punës që të ndjekin dhe monitorojnë kontratat e qirasë dhe kontratat e shitjeve me rezervë, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve nga përdoruesit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, *"Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore",* i ndryshuar, si dhe me detyrimet kontraktuale të përcaktuara në kontratat përkatëse të privatizimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5.2, faqe 148-155 të Raportit Përfundimtartë Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për monitorimin dhe ndjekjen e kontratave të qirasë, me qëllim zbatimin e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara në shumën totale prej **1,641,667 lekë**, që rrjedhin nga dhënia me qira e aseteve publike, si dhe të merren masat për ndjekjen e pagesave të kësteve të kontratave të shitjes nga procesi i privatizimit, në shumën totale prej **343,261 lekë**.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit

Hapat e ndjekura për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 1,641,667 lekë:
"A.T" Qilarisht – Petran, datë 17.04.2025, në vlerën 136,000 lekë, zbritur vlera prej 24,000 lekë për afatin e kontratës.
"A.T" Çarçovë, datë 13.03.2025, në vlerën 160,000 lekë.
"T.A" Çarçovë, datë 27.03.2025, në vlerën 216,000 lekë.
"T. A" Petran, datë 22.09.2025, në vlerën 300,000 lekë.

Gjithsej: 836,000 lekë. Nuk është realizuar vlera 736,310 lekë për kontratën me subjektin "K", me të cilin jemi në proces gjyqësor. Bashkëlidhur gjeni aktet e pagesave të mësipërme.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar dhe afatit të përcaktuar "menjëherë" për zbatimin e rekomandimit, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **pjesërisht i zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Përmet me efekt të ardhura të munguara, u konstatua se, deri në datën 31.12.2023, borxhi tatimor ka qenë 51,105,727 lekë për 17,584 debitorë. Vlera debitore e krijuar gjatë vitit 2024 ka qenë 9,976,242 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në mënyrë progresive deri në datën 31.12.2024, janë 97,956,740 lekë. Grupi i auditimit ka vlerësuar se detyrimi i papaguar (progresiv) deri në datën 31.12.2024 për disa nga taksat dhe tarifat vendore kryesore të cilat njihen si detyrime nga strukturat përkatëse të vjeljes së tyre, por për mos dërgim të informacionit në Sektorin e Financës është **5,724,449 lekë** e pa kontabilizuar dhe përbëhet si më poshtë:

- Detyrime nga taksa familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) në vlerën totale është në shumën 27,346,796 lekë, nga e cilat vlera 26,792,937 lekë është vlerë debitore (e kontabilizuar) dhe vlera 853,859 lekë është detyrim i me efekt në të ardhura të munguara i pa kontabilizuar;
- Detyrime nga kontratat e qirave, në vlerën 3,270,590 lekë për 9 debitorë;
- Detyrime nga subjektet që tregëtojnë hidrokarbure , në vlerën 1,600,000 lekë për 2 debitorë;
- Në Bashkinë Përmet nuk janë zhvilluar takime të GMS, ku të trajtohen problematikat për moskontabilizimin dhe pa/mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, deri tani nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin dhe kontabilizimin e tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, Kreu XI, "*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*", nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 9 "*Të drejtat dhe përgjegjësitë*", pika 1.3. dhe Ligjin nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", neni 35, "*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 54-80 të Raportit përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës debitore progresive 97,956,740 lekë për 210 debitorë dhe veçanërisht për arkëtimin e debisë prej 13,805,893 lekë të 191 debitorëve problematik të kategorisë "biznes".

- Drejtoria Financës dhe e Buxhetit të kontabilizojë vlerën totale të borxhit tatimor prej 5,724,449 lekë që përfaqëson: diferencën e borxhit tatimor nga taksat familjare në vlerën 853,859 lekë; vlerën 3,270,590 lekë për 9 debitorë nga kontratat e qirasë dhe vlerën 1,600,000 lekë për 2 debitorë nga subjektet që tregëtojnë hidrokarbure.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Me anë të shkresës nr. 22/1, datë 17.03.2026, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit ka përcjellë listën e debitorëve për dy subjektet e hidrokarbureve në Drejtorinë e Financë-Buxhetit. Këto vlera janë kontabilizuar.
Me anë të shkresës nr. 22/1, datë 17.03.2026, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit ka përcjellë listën e debitorëve familjarë deri në vitin 2024 dhe kjo shumë është kontabilizuar nga Drejtoria e Buxhet-Financës.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe e të Ardhurave, të hartojë një plan masash periodik dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB si për familjarët dhe për biznesin, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit

Në Vlerësimin Afatmesëm të të Ardhurave të Veta të Bashkisë Përmet janë përcaktuar të gjitha të ardhurat që do të vilen gjatë vitit 2025. Është bërë një analizë për situatën e dy viteve paraardhëse, si dhe për situatën e dy viteve pasardhëse. Në relacion janë përcaktuar një sërë masash që do të merren nga administrata e bashkisë për zgjerimin e bazës së taksapaguesve.
Njëkohësisht, vlen të përmendet se gjatë vitit 2025 është aplikuar, me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 23.09.2025, mbledhja e detyrimeve vjetore për vitin 2025 me SHA Ujësjellës Gjirokastër, për subjektet që nuk i kishin paguar detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vjeljen e tyre.
Nga 129 subjekte të cilat rezultonin debitore për vitin ushtrimor 2025, 96 subjekte kishin kontrata uji me ujësjellësin dhe për to u krye faturimi me SHA Ujësjellës Gjirokastër.
Nga këto 96 subjekte, deri më datë 31.12.2025 kanë paguar 46 subjekte, ndërsa deri më sot, në momentin e raportimit, kanë paguar edhe 26 subjekte të tjera. Pra, në total kanë paguar 70 subjekte, në vlerën totale 1,565,239 lekë.
(Bashkëlidhur gjeni një kopje të formatit Excel të subjekteve që kanë paguar, si dhe VKB nr. 77, datë 23.09.2025.)
Bashkëlidhur gjeni aktet e pagesave të mësipërme.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **në proces zbatimi**.

E.MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENSË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me nr. 2814 prot., datë 20.10.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkisë Përmet përfaqësuar nga Kryetari Znj. A.H. dhe shoqërisë "2T" SHPK me NIPT K.....M dhe, Lic. Nr. NZ3455/15 përfaqësuar nga Administratori Z. A. S. me vlerë të kontratës 46,434,882 lekë me TVSH dhe afat të realizimit të kontratës 8 (tetë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera jo në përputhje me specifikimet teknike dhe normat dhe kushtet teknike ë projektimit dhe zbatimit, në shumën **696,800 lekë pa TVSH, vlerë e cila përfaqësor përdorim të fondeve publike pa Eficence dhe Efektivitet.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402. datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit",* i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4 faqe 135-148 të Raportit Përfundimtartë Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet, të marrë masa për të ngritur një grup pune me specialistë të fushës në bashkëpunim me mbikëqyrësin dhe, kolaudatorin e punimeve, për të vlerësuar dhe analizuar situatën, bazuar nga fakti i auditimit në terren ku rezultuan se Tubi metalik Ø 300 mm për kalimet në rrugë kanali vaditës, nuk provohet me dokumentacionin përkatës justifikues/provues se është sipas specifikimeve teknike,

Dalja e përgjegjësive, realizimi i zërit të punimeve sipas PZ dhe ST në shumën **696,800 lekë** të konfirmohet zyrtarisht nga palët, Autoriteti Kontraktor Bashkia Përmet, Mbikëqyrësi dhe Kolaudatori i punimeve, si dhe nga Sipërmarrësi i punimeve, brenda periudhës 6-mujore të realizimit të rekomandimeve të KLSH-së. Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit te Zbatimit dhe specifikimeve teknike, Auditit të brendshëm të Bashkisë Përmet, i lihet detyrë të gjejë referencën e çmimit për tubin e çelikut ekzistues dhe, diferenca do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Deri më datë 30 Dhjetor 2025

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Rekomandimi i mësipërm nuk do të shqyrtohet në kuadër të këtij auditimi, pasi trajton çështje që lidhen me auditimin e përputhshmërisë.

F. MASA DISIPLINORE

1. Për punonjësit në marrëdhënie pune

Mbështetur në Nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSh-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Përmet, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

a.*"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", gërma "c" e nenit 58, për 19 punonjës., si më poshtë*:

1. Znj. P. M., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kritereve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur;

2. Znj. M. K., në cilësinë e nëpunësit pranë Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara;

-Në cilësinë e Njësisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kritereve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur; për veprime në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar.

3. Z F. H., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kritereve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur; për veprime në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar.

4. Z. B. M., në cilësinë e Njësisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kritereve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur; për veprime në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar.

5. Znj. B. K., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik për procedurën me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" për veprime në kundërshtim me Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80.
6. Znj. M. T., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik për "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" për veprime në kundërshtim me Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80.
7. Znj. K. M., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" dhe "*Punime shtesë për sistemime të brendshme dhe të jashtme në objektin Pallati i Sportit Përmet*". Për veprime në kundërshtim me me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80.
8. Znj. D. D., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në mënyrë të përsëritur; Për veprime në kundërshtim me Sa më sipër rezulton se KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80.
9. Znj. K. G., në cilësin e anëtarit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit në procedurën me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"
10. Z. A. T., në cilësinë e anëtarit të komisionit dhe marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit në procedurën me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" Për veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik"
11. Z. A. J., në cilësinë e anatarit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit në procedurën me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" Për veprime në kundërshtim UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"
12. Z. S. K., në cilësin e anëtarit të komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, për mangësitë në marrjen në dorëzim të mallit në procedurën me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" Për veprime në kundërshtim UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"
13. Z. E. R., në cilësinë e përgjegjësit të konviktit, pjesë e grupit të punës për monitorimin e kontratës, për mangësitë në monotorimin e kontratës në procedurën me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" Për veprime në kundërshtim me Vkm Nr. 511, Datë 27.7.2022 "*Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa në Vendimin Nr. 666, Datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për Kuotat Financiare të Ushqimit në Mensa e Konvikte Dhe Përcaktimin e Kritereve për Përfitimin e Bursave e të Pagesave për Nxënësit e Arsimit Parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike*", të Ndryshuar.

14. **Znj. M. Sh.**, në cilësinë e përgjegjëses së çerdhes, pjesë e grupit të punës për monitorimin e kontratës, për mangësitë në monotorimin e kontratës në procedurën me objekt "*Blerje ushqime për Kopshtin me drekë, Çerdhen dhe Konviktin në Bashkinë Përmet për vitin 2023*" Për veprime në kundërshtim me me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80.

15. Z. L. B., Në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit miratuara;

-Në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat e kualifikimit të operatorëve ekonomik në 2 raste . Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80.

16. Z. B. I., në cilësinë e inspektorit të IMTV për mangësitë e konstatuara për subjektet të cilët kanë kryer kundravajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e marra. në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "a" në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve 159 të ndërtimit",* i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",* i ndryshuar*;* Nenin *5*, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat "a" dhe "c" në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";* Nenin 11 të Ligjit nr.10296 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën "b", pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015

17. Z. Dh. P., në cilësinë e inspektorit të IMTV për mangësitë e konstatuara për subjektet të cilët kanë kryer kundravajtje administartive dhe procedura e ndjekur për vendimet e marra.

Për veprime në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën "a" në nenin 3, nenin 4, nenin 5, nenin 11, pikat 5, 6, 7, 8 në nenin 12, nenin 13, në Ligjin nr.9780, datë 16.7.2007 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar; Nenin 1, në Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve 159 të ndërtimit",* i ndryshuar; Pikat 1, 2, dhe 4 në nenin 51 në Ligjin nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit",* i ndryshuar*;* Nenin *5*, pikën 1 në nenin 9, pikën 3 të nenit 24, shkronjat "a" dhe "c" në pikën 1, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 31, pikat 4 dhe 5 në nenin 48 në Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 *"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";* Nenin 11 të Ligjit nr.10296 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii, pikën 2, shkronjën "b", pikat 4 dhe 6 në VKM nr. 894, datë 04.11.2015.

18. Znj. A. P., në cilësinë e KVO për mangësitë e konstatuara në procedurat me objekt:*"Rikonstruksion i Pallatit të Sportit, Qytet Përmet"* "*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara*" dhe "*Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Meleq Gosnishti Përmet*" Për veprime në kundërshtim me me kërkesat e ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "*Për Prokurimin Publik*", neni 80.

19. Znj. E. K., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së financës, buxhetit dhe treg deri në 31.12.2024 në cilësinë dhe të NZ, për mospërmbushje plotësisht të detyrave të caktuara në ligjin nr. 10296/2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin*" neni 11, neni 12 pika 2/d,dh,f,g,gj dhe pika 3/1; Udhëzimit nr. 30 /2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar lidhur me:

- Për mos hartimin e një plani masash për verifikimin e numrit të debitorëve dhe të vlerës së borxhit tatimor progresiv, kryesisht të atyre të trashëguar nga ish komunat me qëllim kontabilizimin dhe

pasqyrimin në vlerë të saktë të tij në pasqyrat financiare, si dhe për arkëtimin në masë të kënaqshme të detyrimit vjetor nga taksat e tarifat vendore;
- Për mos evidentimin e mungesës dokumentare në procedurën e inventarizimit të aktiveve, të mos llogaritjes së amortizimit për çdo aktiv dhe mos miratimin e regjistrit vjetor të aktiveve në përfundim të çdo procedure të inventarizimit vjetor.

F2. Për punonjësit e larguar:

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore, sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre:

1. Zj. H. Dh., në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të çertifikatave të përdorimit të miratuara, aktualisht i larguar nga puna.

2. Z. G. I., në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, aktualisht i larguar nga puna.

-Në cilësinë e Njësisë së Prokurimit, për mangësitë e konstatuara në hartimin e Kritereve të kualifikimit në mënyrë të përsëritur;

Shpjegimet e subjektit

Për punonjësit e mëposhtëm nuk mund të merret masë disiplinore, pasi janë liruar nga detyra:

- *Z. S. K., liruar nga detyra me urdhrin nr. 293, datë 30.08.2024.*
- *Z. A. T., liruar nga detyra me urdhrin nr. 294, datë 30.08.2024.*
- *Zj. B. K., liruar nga detyra me urdhrin nr. 300, datë 02.09.2024.*
- *Z. B. I., liruar nga detyra me urdhrin nr. 264, datë 14.07.2025.*
- *Zj. M. T., liruar nga detyra me urdhrin nr. 381, datë 23.09.2025.*
- *Z. E. R., liruar nga detyra me urdhrin nr. 400, datë 01.10.2025.*
- *Zj. M. Sh., liruar nga detyra me urdhrin nr. 511/1, datë 15.12.2025.*
- *Urdhri me nr. 17, datë 19.01.2026, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" vjetor.*
- *Urdhri me nr. 17/1, datë 19.01.2026, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" për NP Zj. D. D.*
- *Urdhri me nr. 20, datë 19.01.2026, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" për NP Zj. K. L.*
- *Urdhri me nr. 21, datë 19.01.2026, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" për NP Zj. P. M.*
- *Urdhri me nr. 22, datë 19.01.2026, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" për NP Z. L. B.*
- *Urdhri me nr. 23, datë 19.01.2026, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" për NP Zj. A. P.*
- *Urdhri me nr. 25, datë 19.01.2026, "Për ngritjen e komisionit disiplinor" për NP Zj. M. K.*
- *Vendim nr. 93, datë 18.03.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje me shkrim" për Z. F. H.*
- *Vendim nr. 94, datë 18.03.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje me shkrim" për Z. B. M.*
- *Vendim nr. 94/1, datë 18.03.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje me shkrim" për Z. Dh. P.*
- *Vendim nr. 17/3, datë 16.02.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje" për nëpunësen civile Zj. D. D.*

- *Vendim nr. 20/2, datë 06.02.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje" për nëpunësen civile Zj. K. L.*
- *Vendim nr. 21/2, datë 06.02.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje" për nëpunësen civile Zj. P. M.*
- *Vendim nr. 22/2, datë 06.02.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje" për nëpunësin civil Z. L. B.*
- *Vendim nr. 23/2, datë 06.02.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje" për nëpunësen civile Zj. A. P.*
- *Vendim nr. 25/2, datë 06.02.2026, për dhënie mase disiplinore "Vërejtje" për nëpunësen civile Zj. M. K.*

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

F3. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TËSHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit pjesë e shërbimit civil, për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Përmet, Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "*Për Nëpunësin Civil*", i ndryshuar.

Shpjegimet e subjektit

Në zbatim të rekomandimit F3, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve për masat disiplinore, ju bëjmë me dije sa më poshtë:
Duke qenë se DAP është njësia përgjegjëse për administratën shtetërore, është njoftuar Komisioneri i Mbikëqyrjes të Shërbimit Civil në mënyrë elektronike, ku i janë vënë në dijeni të gjitha materialet._Gjithashtu, vërejtjet janë vendosur në dosjet personale të secilit nëpunës dhe administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore në Bashki.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Referuar dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar**.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: znj.A.H., me detyrë Kryetar i Bashkisë Përmet, si dhe strukturat përgjegjëse të saj.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programeve buxhetore rezultoi se nga 20 programe buxhetore të miratuara nga Ministria e Financave për përgatitjen e PBA 2025-2027, ka disa programet buxhetore të lidhura me funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe

shërbimeve publike si dhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit që nuk janë marrë në konsideratë nga Bashkia Përmet për të parashikuar fonde në buxhet, në moszbatim të Udhëzimit nr.7, datë 25.05.2022 "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*" (shtojca 1) dhe Udhëzimit të MF nr.3, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", (shtojca 4).

-Nga auditimi i shpenzimeve buxhetore konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Përmet së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2025 kanë diferenca me vlerën e planifikuar. Për vitin 2025 niveli i shpenzimeve të planifikuara në buxhetin fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifike është në vlerën 514,848 mijë lekë, buxheti i rishikuar ka vlerën 559,550 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 426,705 mijë lekë ose në masën 76%, me një mosrealizim të fondeve prej -132,845 mijë lekë.

-Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore (600 dhe 601) është realizuar në masën 90 %; zëri shpenzime operative (602) dhe zëri transferta në buxhete familjare (604) është realizuar në masën 74 %. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2025 (artikulli 230-231) është realizuar në nivelin 52%. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9, pika 1.3, germa "c" dhe "ç"; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe VKB përkatëse.*(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.1, faqe 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për rishikimin dhe plotësimin e strukturës së programeve buxhetore në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), duke siguruar përputhje të plotë ndërmjet programeve të planifikuara për buxhetim dhe funksioneve/nënfunksioneve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore. Në mënyrë të veçantë, të studiohet përfshirja në procesin e planifikimit buxhetor e programeve që lidhen me funksionet dhe nënfunksionet e paplanifikuara aktualisht, në fushën e infrastrukturës e shërbimeve publike si dhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke përcaktuar objektiva, produkte dhe fonde përkatëse, me qëllim garantimin e një planifikimi buxhetor të plotë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe përgjegjësitë funksionale të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit buxhetor, duke bazuar parashikimin e të ardhurave vendore në analiza reale dhe mbi kapacitetin faktik të arkëtimit të taksave, tarifave dhe burimeve të tjera financiare. Strukturat përgjegjëse të Bashkisë të marrin masa për të realizuar plotësisht arkëtimin e të ardhurave referuar në planifikimit të tyre, realizimin e investimeve publike të programuara, nëpërmjet planifikimit real të burimeve financiare, përgatitjes në kohë të projekteve të investimeve dhe monitorimit të vazhdueshëm të ecurisë së tyre, në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarive financiare të detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Përmet rezultoi se: Më datën 01.01.2025 *detyrime të prapambetura* progresive kanë pasur si çelje të vitit shumën prej 2,648,974 lekë, ndërsa më datën 31.12.2025 janë në shumën 4,253,290 lekë, me një rritje e stokut të këtyre detyrimeve krahasuar me të dhënat në çelje të vitit ushtrimor, për + 1,604,316 lekë. Pra, detyrimet e prapambetura janë rritur 1.6 herë krahasuar me gjendjen e tyre në fillim të periudhës ushtrimore 2025.
-Nga shqyrtimi i planit të buxhetit vjetor për vitin 2025, rezultoi se Bashkia Përmet ka programuar fonde në buxhet, por nuk ka parashikuar një grafik të detajuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të cilat përbëjnë detyrime të mbartura nga viti 2024, në kundërshtim me parashikimet sipas dokumentit *"Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për tre vitet në vazhdim*" (Aneksi nr. 2 i tabelave të vetëvlerësimit financiar për 4-mujorin e tretë të vitit 2024), dërguar në Ministrinë e Financave, ku detyrimet e mbetura janë planifikuar për t'u shlyer deri më datën 31.12.2025.
-Raportimi i detyrimeve të prapambetura si në strukturë dhe në vlerë totale nuk përputhet me detyrimet e prapambetura në fakt, pasi shuma e detyrimeve në vlerën **4,880,824 lekë** e lidhur me vendime gjyqësore të formës së prerë nuk është kontabilizuar më datën 31.12.2025 si shtesë e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm", duke nënvleftësuar për këtë shumë vlerën e kësaj llogarie.
- Si rrjedhojë, përllogaritja e vështirësisë financiare nuk është e saktë, ngaqë stoku i detyrimeve të prapambetura nuk është i plotë. Sa më sipër, shuma e detyrimeve të prapambetura *(e korrigjuar)* arrin në 9,134,114 lekë, duke ndryshuar raportin e stokut të detyrimeve ndaj shpenzimeve vjetore kësaj Bashkie. Për këtë arsye dhe masa e vështirësisë financiare ndryshon nga **1% në 2.14 %,** pavarësisht se Bashkia Përmet konsiderohet në situate normale të gjendjes financiare. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura" pikat 20-22 dhe 27-29; UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 186; Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", pikat 106-110, dhe pikat 81, 148 dhe 148/1. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.1, faqe 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për evidentimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të prapambetura, përllogaritjen dhe monitorimin periodik të stokut të tyre në raport me shpenzimet faktike, si dhe hartimin dhe zbatimin e një plani të qartë për likuidimin e tyre. Gjatë planifikimit dhe miratimit të fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, të mbahet në vëmendje shlyerja e detyrimeve të papaguara të viteve të mëparshme, me qëllim shmangien e akumulimit të detyrimeve, reduktimin e riskut për buxhetin e vitit në vazhdim dhe garantimin që fondet publike të jenë të disponueshme për financimin e nevojave, investimeve dhe shërbimeve në interes të komunitetit

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të regjistrimit/çregjistrimit, planifikimit, njoftimit të detyrimeve dhe arkëtimeve për tatimpaguesit familjarë rezultoi se:

Nuk është dokumentuar me procesverbal niveli i detyrimeve të papaguara për taksat dhe tarifat vendore sipas kategorive, në datën 31.12.2025;
Nuk është kryer dokumentimi, protokollimi dhe arkivimi i kopjes së printuar dhe elektronike të regjistrit vjetor të detyrimeve, në momentin e mbylljes së vitit ushtrimor dhe para hapjes së regjistrit të vitit pasardhës;
Rregullorja e brendshme e miratuar me Vendimin nr.507, datë 26.11.2025 të Kryetarit të Bashkisë Përmet nuk parashikon procedura për gjenerimin, printimin dhe arkivimin e të dhënave periodike dhe vjetore të tatimpaguesve;
Procesi i popullimit të regjistrit elektronik dhe përpunimi i të dhënave kryhet nga i njëjti personel, pa ndarje funksionesh dhe kontrolle të brendshme të mjaftueshme. Mungojnë evidenca të monitorimit të procesit të përpunimit të të dhënave dhe raportimit të tyre në formë elektronike dhe shkresore për drejtuesit dhe titullarin e Bashkisë.
Sa më sipër, në mospërputhje me përcaktimet e nenin 5/iv, të Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit e Bujqësisë të marrë masa për formalizimin e procedurave për mbylljen, dokumentimin dhe arkivimin e regjistrit vjetor të tatimpaguesve; sigurimin e ndarjes së detyrave midis personave që kryejnë popullimin e regjistrit dhe atyre që përgatisin raportet dhe njoftimet e detyrimeve; vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të procesit të administrimit të regjistrit elektronik të tatimpaguesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore rezultoi se:
- Nuk rezultojnë rakordime të dokumentuara periodike dhe vjetore midis Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit e Bujqësisë dhe Drejtorisë së Financës e Buxhetit, por vetëm komunikime shkresore mbi nivelin e realizimit të të ardhurave.
- Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore përdor evidenca të gjeneruara në formatin Excel, të përpunuara manualisht mbi bazën e informacionit të regjistrit elektronik dhe të dhënave të dërguara nga sektorët përkatës, që mbart riskun e pasaktësive në raportimin financiar dhe të besueshmërisë së informacionit të përdorur për vendimmarrje dhe raportim buxhetor.
-Raportet e monitorimit dhe raportet vjetore nuk shoqërohen me gjurmë dokumentare që të lidhin të dhënat e regjistrit elektronik me tabelat e përpunuara.
Këto veprime janë jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64 dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu II, pika 2, germa "a" dhe "b", Kreu III, pika 32.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në koordinim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit e Bujqësisë të marrin masa për kryerjen e rakordimeve periodike e vjetore të detyrueshme dhe të dokumentuara midis të dhënave të regjistrit elektronik dhe kontabilitetit; formalizimin e procedurave të gjurmimit dhe dokumentimit të të dhënave financiare, si dhe minimizimin e përpunimit manual të të dhënave dhe përmirësimin e integrimit të sistemeve të raportimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i borxheve dhe detyrimeve vjetore për taksat dhe tatimet vjetore në Bashkinë Përmet rezultoi se në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm", në Pasqyrat Financiare të llogaridhënies vjetore për vitin 2025, nuk është kontabilizuar vlera totale prej **2,054,221 lekë e 1,486 debitorëve familjarë.** Si pasojë e vonesës në rakordimin e detyrimeve midis Bashkisë Përmet dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër për vjeljen e detyrimeve të familjarëve të vitit 2025, *(akt rakordimi nr. 498, datë 04.03.2026 mbi detyrimet dhe likuidimet e periudhës Janar-dhjetor 20250),* nuk janë pasqyruar në llogaridhënie vjetore te vitit 2025 detyrimet e popullatës në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm', në shumën 2,054,221 lekë.

-Në lidhje me situatën e detyrimeve tatimore, në asnjë rast nga ana e strukturave të kësaj Bashkie nuk është ngritur padi gjyqësore dhe nuk është dërguar kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", i ndryshuar,; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.127, datë 19.12.2025 "*Për procedurat e mbylljen së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2025"*, si dhe dispozita të tjera rregulluese e urdhëruese të lëshuara nga ana e Ministrisë së Financave. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Bujqësisë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm" me kundërparti llogarinë 470 "Të ardhura për t'u marrë", si dhe pasqyrimi në kontabilitet i të gjitha detyrimeve nga taksat e tarifat vendore.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2026

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2025 ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gjirokastër, Drejtorisë Rajonale të Doganave dhe AKBN-së nuk janë mbajtur akt-rakordime periodike për identifikimin e nivelit të të ardhurave të arkëtuara për llogari të kësaj Bashkie. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar neni 117; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë"; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, etj.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 31-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Bujqësisë të marrin masat për të kryer rakordimet periodike me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave; evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për aplikimin e gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, sistemi i kontrollit të brendshëm në Bashkinë Përmet vlerësohet *pjesërisht efektiv*, pasi komponentët e MFK-së nuk funksionojnë plotësisht. Më konkretisht:

- Rregullorja e brendshme nuk përshkruan në mënyrë të plotë proceset kryesore të punës, rrjedhën e tyre, raportimin dhe vendimmarrjen;
- Nuk janë formalizuar plotësisht politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Nuk është hartuar gjurma e unifikuar e auditimit;
- Nuk dokumentohet dorëzimi i inventarit dhe dokumentacionit në rastet e largimit nga puna;
- Mungojnë përshkrimet e detajuara të detyrave, përgjegjësive dhe kritereve të rekrutimit/ largimit për punonjësit e rregulluar sipas Kodit të Punës.
- Struktura e auditimit të brendshëm nuk është e ngritur si njësi funksionale, sipas kërkesave ligjore;
- Sistemi i raportimit financiar bazohet në programin *Microsoft Excel*, me risk të lartë gabimi dhe manipulimi;
- Nuk ekziston rregullore e IT-së dhe sistem *back-up* për të dhënat financiare dhe administrative.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*" i ndryshuar; Ligjin nr. 114/2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik*" neni 10,pika 1 b; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "*Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*" pika 6/a; "Manualin e MFK", miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.4 datë 26.01.2024, Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma "b"; Ligjin nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 13; Udhëzimin nr. 16, dt. 31.12.2024 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike".

(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 1, faqe 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masa për funksionalizimin e plotë të sistemit të MFK-së, përfshirë rishikimin e rregullores së brendshme dhe formalizimin e proceseve të burimeve njerëzore; krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe përmirësimin e sistemeve IT, përfshirë hartimin e rregullores përkatëse dhe vendosjen e sistemit të back-up-it të të dhënave.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit dhe përgatitjes së pasqyrave financiar të llogaridhënës vjetore për vitin 2025 në Bashkinë Përmet ka rezultuar se,

- ✓ *Drejtoria e Buxhetit dhe Financës* operon me mbajtjen manualisht të disa ditarëve të kontabilitetit dhe jo sipas një programi Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.
- ✓ Nga ana e Bashkisë Përmet nuk janë mbajtur libra kontabiliteti për veprimet përmbledhëse, për azhurnimin, përmbledhjen dhe centralizimin e veprimeve dhe llogarive nga gjithë ditarët, për të shmangur rreziqet e dublimit të tyre. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, mungon gjurma e veprimeve sistemuese dhe rakordimin e tepricave kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet dhe ato që mbarten në vitin pasardhës. Kryerja e këtyre veprimeve dhe nxjerrja e bilancit vërtetues është kryer nga jashtë ditarëve. *Sa më sipër,* jo në përputhje me Kreun II, "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Nënkreu II.2 "pika 6 dhe 30, të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar:
- ✓ *Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit* nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin *Microsoft Excel,* gjë që tregon se niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 31.12.2024 *"Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimit të MFK funksionimin e GMR në njësitë publike*"; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 04, datë 26.1.2024; UMF nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar Kreut 2.2, pika nr. 6, Kreu I dhe 28 dhe Kreu III.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të marrë masat për forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar automatizimin dhe integrimin e proceseve të kontabilitetit dhe administrimit të të ardhurave, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi. Për këtë, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të implementojë dhe përdorë një sistem të certifikuar/program kontabiliteti për regjistrimin e veprimeve financiare, duke eliminuar mbajtjen manuale të ditarëve dhe duke siguruar mbajtjen e centralizuar dhe të plotë të të dhënave, për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit dhe implementimit të programeve financiare, që garantojnë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit të pajiset me një sistem informatik të dedikuar për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, duke zëvendësuar përdorimin e programeve jo të specializuara (si Excel). Sistemi të jetë i integruar me sistemin financiar të Bashkisë, në mënyrë që të mundësohet shkëmbimi dhe rakordimi automatik i të dhënave për detyrimet, arkëtimet dhe regjistrimet kontabël, duke garantuar saktësinë, transparencën dhe gjurmueshmërinë e të dhënave dhe të transaksioneve. Gjithashtu, të forcohet roli i strukturave përgjegjëse për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mbajtjes së kontabilitetit rezultoi një nivel i lartë detyrimeve debitore në Bashkinë Përmet në fund të vitit 2025, që ka ardhur në rritje prej +11,376,415 lekë, ose + 12.3 % më shumë se fundi i vitit të mëparshëm, ku shtesat vjetore të llogarisë së debitorëve janë 14,164,044 lekë dhe likuidimet/shlyerjet për 2,787,629 lekë. Gjendja e mbartur e debitorëve *(llog.468)* deri me 31.12.2024 është 92,232,291 lekë kurse në fund të vitit 2025 detyrimet debitorë të paraqitura në këtë llogari janë 103,608,706 lekë. Në strukturën e përgjithshme të debitorëve, 38 % janë detyrimet e popullatës për taksat e tarifat vendore në NJA-të, 30 % detyrimet e biznesit, 26 % debitor ujësjellësi si agjent tatimor dhe 6 % kontratat me të tretët.

- Nga analiza e kësaj llogarie u konstatua një nivel i lartë i detyrimeve të mbartura e të trashëguara për taksat e tokës bujqësore, të biznesit, të ndërtesave etj., nga vitet e mëparshme (2011-2024) të NJA-ve, për të cilat nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit administrohen listat e dërguara nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë dhe Njësitë Administrative Petran, Frashër, Çarshovë dhe Piskovë. Rezulton se për 5 (pesë) Njësitë Administrative të Bashkisë Përmet, detyrimet debitore për mos likuidimin e taksës së tokës dhe të ndërtesës nga abonentët familjarë për periudhën 2011-2024 zënë 85.2 % të detyrimeve gjithsej për këtë kategori. Kjo shumë vjen nga pasqyrat financiare të ish Komunave që nga viti 2015 dhe vlera e debisë së trashëguar prej 39.4 milionë lekë, përbëhet: 33,6 milionë (ose 85.3% e saj) e zënë detyrimet e periudhës 2011-2024 dhe 5,8 milionë (ose 14.7% e tyre).e zënë detyrimet e vitit 2025

Sa më sipër, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; neni 42 pika 1-5 të ligjit nr.67/2017, datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar; Ligjin nr.9632, datë 30,10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kapitulli II, pika 6.

- Nga ana e Bashkisë së Përmetit nuk janë kryer procedurat e kërkimit të detyrimeve në rrugë administrative e gjyqësore, por llogaria "Debitorët e ndryshëm" (llog. 468) në fund të vitit 2025 paraqitet në shumën prej 103,608,706 lekë.

-Nuk është pasqyruar në ditarët e kontabilitetit të Bashkisë Përmet llogaria 470 "Llogari në pritje - të ardhura për t'u marrë" që shërben si kundërparti e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar.

- Në gjendjen e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" përfshirë edhe vlera 26,492,937 lekë e cila është kontabilizuar në zërin "Debitor Ujësjellësi (si agjent)", për shumën e borxheve që Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Përmet i detyrohet Bashkisë Përmet, (e përfshirë sipas Marrëveshjes së Themelimit datë 22.07.2022 në SHRUK Gjirokastër). Sa më sipër, nuk evidentohet një listë analitike të abonentëve familjarë që janë debitorë nga taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu në disa raste janë kontabilizuar vlera me emërtimin debitorë si biznes i vogël dhe i madh të transferuara nga ish-komunat *Piskovë, Çarshovë, Petran dhe Frashër* për të cilat nuk ka një evidencë analitike ku të jetë e shoqëruar me dokumentacion justifikues përkatës.

-Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se, në pasiv të bilancit nuk është pasqyruar llogaria 470 "Llogari në pritje-të ardhura për t'u marrë" me kundërparti llogarinë 468 "Kreditorë të ndryshëm", e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t'u arkëtuar

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, nëpërmjet Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe strukturave përgjegjëse për administrimin e të ardhurave vendore, të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e një plani veprimi për evidentimin, rakordimin, ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve debitore të trashëguara dhe të krijuara rishtazi, duke ndërmarrë procedurat administrative dhe, sipas rastit, procedurat ligjore për mbledhjen e detyrimeve të prapambetura, me qëllim uljen progresive të nivelit të debitorëve dhe rritjen e performancës së arkëtimit të të ardhurave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për pasqyrimin e plotë, të saktë dhe të dokumentuar të detyrimeve debitore në kontabilitet, përmes evidentimin analitik të çdo debitori të mbartur, sistemimin e diferencave të konstatuara, si dhe zbatimin korrekt të skemës kontabël për llogaritë 468 "Debitorë të ndryshëm" dhe 470 "Llogari në pritje – të ardhura për t'u marrë", në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të llogarisë *4342 "Operacione me shtetin (të drejta)"* u konstatua se totali i kësaj llogarie sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në Llogaridhënien Vjetore në fund të vitit 2025 në vlerën 39,718,239 lekë, nuk kuadron me tepricën e llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti i shtetit", me një diferencë **64,904,146 lekë**. *Sa*

më sipër, nuk ka një pozicionim të drejtë të llogarisë, veprime jo në përputhje me trajtimet e UMF nr. 8, datë 09.03.2018, *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, Kreu III, paragrafi 3.3, paragrafi 32 dhe si "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin", si dhe Aneksi 1.

- Teprica e llogarisë *4341 "Operacion me shtetin (detyrime)"* sipas Pasqyrave të Llogaridhënies Vjetore të depozituara në Degën e Thesarit për vitin 2025, paraqitet në shumën 0 (zero) lekë. *Nga ana tjetër,* vlera totale e llogarive 411,423-429,468 është 103,608,706 lekë, me një moskuardim prej **103,608,706 lekë.**

Sa më sipër, nuk ka një pozicionim të drejtë të këtyre llogarive sipas udhëzimeve të miratuara mbi kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në fund të vitit 2025. Veprime në kundërshtim me pikën 8, paragrafi 3.2 të Udhëzimit të MF nr. 5, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"; nënpika 28, 29 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të kryejë analizimin, sistemimin dhe rakordimin e tepricave të llogarive *4341 "Operacione me shtetin (Detyrime)" dhe 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)",* me qëllim eliminimin e mospërputhjeve ndërmjet të dhënave të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare, si dhe sigurimin e klasifikimit dhe paraqitjes së tyre në përputhje me kërkesat e kuadrit normativ në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime" është përfshirë vlera sipas kostos historike **18,353,574 lekë** me emërtimin *"Projekte të ndryshme"* të paidentifikuara nga viti 2015 e në vijim, të cilat u përkasin ish-Komunave. Për këto aktive nuk ka inventar, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për aktivin, si dhe nuk ka analizë të kësaj llogarie pasi mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projektimeve dhe viti i krijimit të tyre. Kjo situatë është e mbartur që nga viti 2015 nga ndarja e re administrative dhe bashkimi i ish/komunave me Bashkinë Përmet.

- Nga auditimi u konstatua se në tepricën e llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" në fund të vitit 2025 prej 31,145,994 lekë është përfshirë shuma prej 1,090,000 lekë që i përket vlerës së disa projekt-studime për investime, e pa shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika16/b. d, Kreu III. pika 36, Aneksi 1, pika 2, Klasa 2; si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 30-35, Kreu IV pika 75.

(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që të kryejë inventarin fizik të projekteve dhe të studim-projektimeve në llog. 202 "Studime dhe Kërkime", si dhe për vlerësimin dhe shpërndarjen e vlerës së tyre, kur plotësohen kushtet për kapitalizim, sipas llojit të aktivit përkatës. Për aktivet e kapitalizuara, të përllogaritet amortizimi sipas normës dhe metodës

së miratuar, të kryhen veprimet sistemuese në llogaritë përkatëse dhe të pasqyrohen ndryshimet në tabelat shoqëruese përkatëse të pasqyrave financiare

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjendjes së e llogarisë 210 "Toka, troje, terrene" rezultoi se nuk është përfshirë në 110 raste vlera e truallit të aktiveve afatgjata materiale (llog.212) në pronësi të Bashkisë Përmet. Nga auditimi dhe analiza e gjendjes së Llogarisë 210 "Toka, troje, terrene", u konstatua se nga ana e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, nuk janë hedhur në kartelat e kontabilitetit asnjë prej vlerave të trojeve nën objekt për ndërtesat e shkollave që ka në administrim, kopshteve, qendrave shëndetësore, Pallatit të Sportit, muzeut, kinemasë, çerdheve, shtëpive të kulturës si dhe të zyrave të Nj.A-ve, etj., sipas regjistrit të aktiveve të pasqyruar në llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione".
-Në llogarinë 210 "Toka, troje e terrene" janë regjistruar shpenzime të lidhura me hipotekimin e aktiveve. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se **18 prej aktiveve të regjistruara janë apartamente**, për të cilat shpenzimet e hipotekimit, nëse plotësojnë kriteret për t'u përfshirë në koston e aktivit, duhet të jenë trajtuar në llogarinë 212 "Ndërtesa". Gjithashtu, për periudhën 2020–2024 nuk është paraqitur një analizë e detajuar e shpenzimeve të hipotekimit sipas aktivit, çka nuk mundëson identifikimin e vlerave që i përkasin secilit aktiv dhe trajtimin e tyre kontabël në përputhje me natyrën e aktivit.
- Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2025 në llogarinë 210 "Toka, Troje, Terrene" nuk janë kontabilizuar 5 (pesë) zëra të aktiveve me certifikatë pronësie, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05, datë 21.02.2022 "Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*", Aneksi 1. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore, të marrë masa për evidentimin, inventarizimin, klasifikimin dhe pasqyrimin e plotë e të saktë të aktiveve afatgjata materiale, duke sistemuar llogarinë 210 "Toka, troje, terrene" dhe llogarinë 212 "Ndërtime e konstruksione", përfshirë regjistrimin e vlerës së truallit për asetet në administrim, sistemimin e gabimeve të klasifikimit kontabël, kontabilizimin e aktiveve të pajisura me certifikatë pronësie dhe kryerjen e rakordimeve me regjistrin e aktiveve të Bashkisë Përmet.

Menjëherë e në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 211 "Pyje, kullota, plantacione" u konstatua se zërat e kësaj llogarie janë pasqyruar në bilanc për vlerën 1,921,860 lek, por të pa analizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare. Bazuar në VKM nr.398, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime ne vendimin nr.433, datë 08.06.2016, të Këshillit të Ministrave, për transferimin në pronësi te bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së mjedisit e të ish komunave, bashkive", në pronësi të Bashkisë Përmet janë kaluar këto sipërfaqet pyjore dhe kullosore: Sipërfaqe totale: **18,433 ha**, e cila përbëhet nga: Pyje 10,771 ha, Sipërfaqe boshe:15 ha, Sipërfaqe djerrë: 20 ha,

Sipërfaqe inproduktive: 110 ha, Sipërfaqe shkëmbore: 484 ha dhe, të cilat nuk janë përfshirë në asetet e kësaj NJVQV.
- Sipërfaqja pyjore e kullosore e transferuar dhe e regjistruar në ASHK është 6,790 ha ose 38% e saj, pasi sipërfaqja Pyjore+ Kullosore është 17,804 ha, (nga kjo sipas VKM sipërfaqja pyjore është në 10,771 ha dhe sipërfaqja e kullotave 7,033 ha).
- *Sa më sipër,* kjo llogari nuk paraqet një pamje reale në pasqyrat financiare të vitit 2025, pasi në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera dhe sipërfaqja e pyjeve dhe kullotave të kaluara në pronësi të kësaj Bashkie me VKM-në 398, datë 13.05.2020, pika 3, shtojca me nr.1, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Përmet. Rezulton se këto pyje dhe kullota janë të pavlerësuara dhe të pa pasqyruara në Pasqyrat Financiare të Bashkisë Përmet për vitin 2025.
Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për administrimin e pronave dhe menaxhimin e fondit pyjor e kullosor, të marrë masa për evidentimin, inventarizimin, vlerësimin dhe pasqyrimin e plotë e të saktë në llogarinë 211 "Pyje, kullota, plantacione" të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të transferuara në pronësi të Bashkisë Përmet, si dhe rakordimin e tyre me dokumentacionin e pronësisë dhe regjistrat përkatës, me qëllim paraqitjen e drejtë të aktiveve në pasqyrat financiare të këtij institucioni.

Menjëherë e në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" gjatë vitit 2025 rezultoi se janë kontabilizuar dhe kapitalizuar në këtë llogari 5 (pesë) zëra shpenzimesh për investime nga ana e Bashkisë Përmet në shumën **144,456,959 lekë**, si vijon:

- "Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet të favorizuara 2019, 2020, 2023", me vlerën gjithsej 45,380,213 lekë;
- "Rikualifikim i Qendrës së Qytetit fasadat, ndriçimi, lulishtja ne Qytet V.2018", me vlerën gjithsej 81,676,761 lekë;
- "Lyerje fasade", me vlerën gjithsej 2,275,273 lekë;
- "Ndërtesë rezidenciale vila", me vlerën gjithsej 5,284,712 lekë;
- "Gjelbërim mjedise publike 2016", me vlerën gjithsej 9,840,000 lekë.

Aktivet e mësipërme të kontabilizuara në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", nuk janë aktive në posedim të Bashkisë Përmet. Këto zëra shpenzimesh në 5 (pesë) raste janë kryer për asete të regjistruara në pronësi të komunitetit, të cilët nëpërmjet programeve të ndryshme sociale janë përfitues të granteve të ndryshme, prandaj ato nuk mund të kapitalizohen pasi nuk lidhen me asnjë nga aktivet e kësaj Bashkie, ndaj rezulton mbivlerësim i kësaj llogarie për shumën 144,456,959 lekë.
Sa më sipër, është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018, "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Përmet të marrë masa për sistemimin e trajtimit kontabël të 5 (pesë) investimeve, të regjistruara gabimisht në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione". Për këtë qëllim, të kryhet çregjistrimi i shumës **144,456,959 lekë**

nga llogaria 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" dhe sistemimi i saj në përputhje me trajtimin kontabël të parashikuar për grantet kapitale për pjesëmarrje në investime për të tretë**,** sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, prezantimit dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2026

14.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Përmet, për projektet që do të zbatohen në kuadër të programeve sociale, të sigurojë klasifikimin korrekt të shpenzimeve në përputhje me natyrën e tyre ekonomike, duke i njohur ato si shpenzime/transferta dhe jo si aktive afatgjata, kjo në koordinim me Ministrinë përgjegjëse për financat. Ky trajtim kontabël synon të garantojë paraqitjen e drejtë dhe të besueshme të pasqyrave financiare, të shmangë mbivlerësimin e aktiveve dhe të sigurojë përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione" gjatë vitit 2025 rezultoi se pjesë e objekteve ndërtimore janë të trashëguara dhe të mbartura nga ish/komunat në periudhat raportuese para vitit 2015 dhe janë të pa shoqëruara me kartelat përkatëse të objekteve.

- Nga ana e Bashkisë Përmet nuk është bërë një pasqyrim real dhe i drejtë në lidhje me vlerën e objekteve dhe gjendjen e tyre, pasi në shumicën e rasteve të audituara janë pasqyruar vetëm investimet e kryera gjatë viteve të fundit, dhe se në shumë raste, vlerat e tyre janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të shkuara (para vitit 2000), në mospërputhje të gjendjes faktike të objekteve pasuri shtetërore me konfirmimin e dokumentacionit financiar dhe se ky informacion kontabël duke mos pasqyruar gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive.
- Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Përmet ka në administrim 22 (njëzetë e dy) banesa të llojit apartament të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) dhe të dorëzuara në pronësi të saj, me vlerë privatizimi **34,084,716 lekë**, nga të cilat me datën 31.12.2025 mbeten në pronës të kësaj Bashkie 20 (njëzetë) apartamente. Vlera e këtyre apartamenteve të regjistruara në ASHK për llogari të Bashkisë Përmet nuk është përfshirë në llogarinë 212 "Ndërtime e rikonstruksione" dhe nuk janë përfshirë as në Regjistrin e Aktiveve të kësaj Bashkie.
- Bashkia Përmet, me krijimin e saj, nuk ka trashëguar dokumentacionin e duhur për asetet e ish-Komunave (të tilla si, harta topografike, planimetri të objekteve, koordinata të vendndodhjes së tyre, etj.). Kjo situatë e mungesës së dokumentacionit teknik ka krijuar probleme për administrimin e aseteve të kësaj bashkie. Bashkimi i aseteve nga ish-komunat, është realizuar nga bashkimi i vlerave te bilanceve të tyre, në të cilët vlerat e pasqyruara me postet e aktivit dhe pasivit rezultojnë pa analizë, pa mbështetje dhe rakordim me inventarë të rregullta të vlerave të Aktiveve të Afatgjata Materiale dhe Aktiveve Qarkulluese. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Përmet rezultoi se, mbi 22 (njëzetë e dy) aktive afatgjata/ pasuri që administrohen nga NJVQV, në fakt janë të kontabilizuara sipas të dhënave që i përkasin periudhave të ndryshme kohore nga viti 1990 dhe ky informacion kontabël nuk pasqyron gjendjen e vërtetë vlerore të këtyre pasurive.
- Nga auditimi i gjendjes së llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" (kosto historike) u konstatua se në këtë llogari, referuar analizës në nivel artikulli, vlerat e rikonstruksioneve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit nuk janë shtuar vlerës së aktivit fillestar pas investimeve të kryera, për 5 (pesë) artikuj aktivesh në vlerën **37,962,272 lekë**.

Sa më sipër, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të

njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1; pika 2, klasa 2, "Aktivet afatgjata" dhe me Nomenklaturën e Llogarive të Planit Kontabël Publik.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
15.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Përmet të marrë masa që të kryhet një proces i rishikimit dhe sistemimit të evidencës së llogarisë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione", duke siguruar plotësimin e dokumentacionit teknik dhe kontabël të aktiveve të trashëguara, evidentuar dhe regjistruar asetet e papasqyruara, përditësuar vlerat e aktiveve në përputhje me investimet e kryera ndër vite, si dhe rakorduar regjistrin e aktiveve me dokumentacionin e pronësisë dhe gjendjen faktike, me qëllim garantimin e paraqitjes së plotë, të saktë dhe të besueshme të aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare dhe siguruar gjurmueshmërinë e tyre administrative, teknike dhe kontabël.

Në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 213 "*Rrugë, rrjete, vepra ujore"* rezultoi se në inventarin e saj janë 4 objekte në vlerën **87,569,184 lekë**, të cilat janë asete të ujësjellësit. Nga ana e Drejtorisë se Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masat për transferimin e aseteve të ujësjellësit në "Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër Sha" , në kundërshtim me VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimi e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujerave të ndotura, Kreu II, pika 14; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet në bashkëpunim me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër sha, të marrin masa për transferimin në mënyrë të dokumentuar të aktiveve sipas vlerës kontabël, ku vetëm për 4 objekte të saj vlera e regjistruar është 87,569,184 lekë. Pasi Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastër Sh.a të ketë marrë në dorëzim këto aktive, Bashkia Përmet të pasqyrojë në kontabilitet efektet e këtij transferimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktiveve financiare rezultoi se llogaria 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta" është paraqitur në vlerën 216,752,570 lekë, e cila përfaqëson pjesëmarrjen e Bashkisë Përmet në kapitalin e ish-shoqërisë UK Përmet sh.a., bazuar në raportin e vlerësimit të miratuar në prill 2019.
Nga verifikimi i korrespondencës me SHRUK Gjirokastër rezultoi se me datë 31.12.2022 është transferuar në shoqërinë rajonale një pjesëmarrje në kapital në vlerën 583,637,584 lekë, e lidhur me projektin *"Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit për qytetin e Përmetit".*
Referuar rekomandimeve të auditimit të mëparshëm të KLSH-së, vlera që duhej të reflektohej në kontabilitet ishte 583,299,150.92 lekë, ndërsa vlera e transferuar ishte 583,637,584 lekë, me një diferencë prej 338,433.08 lekë.
Deri në momentin e kryerjes së auditimit, procesi i zmadhimit të kapitalit nuk ka përfunduar dhe rekomandimi i lënë më parë për saktësimin e vlerës së llogarisë 26 nuk rezultoi i zbatuar, me argumentin e mungesës së aktit përfundimtar të vlerësimit.
Mosreflektimi i plotë dhe i saktë i vlerës së aktiveve financiare cenon besueshmërinë e pasqyrave financiare, sjell risk të paraqitjes jo korrekte të investimeve të Bashkisë me ndikim në

vendimmarrjen financiare dhe raportimin kontabël. Sa më sipër, në kundërshtim me SKK nr. 14, "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje", pika nr. 17; Kreun I, pika 3.1."Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kreu III, pika 3.1, paragrafi nr. 31, të Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018, "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme"* i ndryshuar.*(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, pas përfundimit të procesit të zmadhimit të kapitalit dhe administrimit të aktit përfundimtar të vlerësimit nga audituesi ligjor i pavarur dhe të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë masa për saktësimin dhe sistemimin e llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalet e veta", duke reflektuar vlerën e saktë të pjesëmarrjes në pasqyrat financiare.

Deri në mbylljen e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2026

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi organizmin dhe mbajtjen e evidencës kontabile, rezultoi se Regjistri i Aktiveve i vitit 2025 nuk ka përfshirë të gjithë zërat e aktiveve afatgjata materiale, jomateriale, llogaritë e pjesëmarrjes në kapital dhe afatshkurtra, si dhe nuk është i plotësuar sipas kërkesave të Paragrafit nr.30 dhe nr.109, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit e Bujqësisë është hartuar vetëm regjistri elektronik i aktiveve, i cili nuk përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore.

-Në regjistrin e aktiveve mungojnë të dhënat mbi vlerën fillestare të aktivit në momentin e blerjes, data e hyrjes në përdorim, *(në shumë raste vendosur shënimi para vitit 2015),* vlera e shpenzimeve kapitale që i shtojnë vlerën aktivit dhe koha e kryerjes së këtij shpenzimi, datën e skadencës, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.

-Nuk janë përfshirë në regjistrin e aktiveve, aktivet të cilat gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualit MFK.

- Nga ana e Bashkisë Përmet deri në fund të vitit 2025 janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, 3,126 zëra të pasurive të marra në pronësi, me emërtime të ndryshme si, ndërtesa, sheshe, truall, etj., por që nuk janë përfshirë në regjistrin e aseteve dhe si të tilla, të pa kontabilizuara në inventarin e AAGJ të kësaj bashkie.

-Nuk është kryer kontabilizimi me vlerë simbolike 1 (një) lek për asetet që janë amortizuar plotësisht, por janë ende në përdorim, ose për transferime asetesh me vlerë të papërfillshme materialiteti. *Kjo shënon mbajtjen e asetit në inventar për qëllime kontrolli,* pa ndikuar në pasqyrat financiare, shpesh duke debituar llogarinë e shpenzimeve dhe kredituar arkën/bankën.

- Nga përgjigja e pyetësorit të dërguar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqërisë dhe Turizmit, evidentohet se janë 22 apartamente në pronësi të Bashkisë Përmet, që nuk rezultojnë të regjistruara në Regjistrin e Aktiveve (analiza e llogarisë 212)

- Nuk është hartuar *Regjistri i unifikuar i aktiveve të Bashkisë,* por vetëm regjistri elektronik i cili përfshin informacionin pjesor vetëm mbi vlerën e aktiveve dhe amortizimin.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar dhe Manualin e MFK-së, Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.11.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik*" i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6, Kreu III, paragrafi 28, Kreu I, paragrafi 4/c, Kreun II, Paragrafi III, pika 26, 27, 28 dhe Paragrafi IV pika 81.

(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të Bashkisë Përmet, të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e punës në mbajtjen e Regjistri të Aktiveve të institucionit, i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vend ndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike. Regjistri të Aktiveve të përfshijë aktivet afatgjata dhe afatshkurtra materiale dhe monetare, si dhe të specifikojë aktivet të cilat gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për inventarizimin e pasurisë për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur e më eficiencë të tyre, janë konstatuar disa mangësi në lidhje me zbatimin e proceseve dhe procedurave të inventarizimit të pasurisë, rregullshmërinë e dokumentacionit dhe rakordimin e brendshëm. Konkretisht;

- Nuk i është nënshtruar procedurave të inventarizimit të pasurisë institucioni i Qendrës Kulturore Përmet, (nuk është kryer *inventarizimi për materiale të pikturave dhe kompozimeve*), me arsyetimin se për këto materiale ka një çështje nga ana e Prokurorisë për ndjekje. Gjithashtu, edhe për Bibliotekën e Qytetit nuk është kryer inventarizimi i fondit të saj (libra, revista, etj.) që nga viti 2016 për të identifikuar artikujt me numër serie dhe me sasi, emërtim, e vlerë. Këto çështje janë prezantuar edhe në raportet e inventarizimit të pasurisë në vitin 2023 dhe 2024, por pa i adresuar ato.
- Rezultoi se i njëjti punonjës i Bashkisë është pjesë e Komisionit të Inventarizimit, Vlerësimit dhe Nxjerrjes Jashtë Përdorimit të aktiveve.
- Nuk ka gjetur dokumentim paragrafi nr.83 i UMF nr. 30/2011 që përcakton se *"Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një proçesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës.*"
- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk disponon të dhëna mbi kryerjen e inventarizimit fizik për Aktivet Afatgjata Materiale të llogarive 210, 211, 212, 213 dhe 214 përkatësisht për: Toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtesa e konstruksione, rrugë, rrjete e vepra ujore, instalime teknike, makineri e pajisje, në kundërshtim me kërkesat e pikave 74 e 96 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar. Nuk i janë nënshtruar inventarizimit zërat *Ndërtesa dhe Rrugë, rrjete e ujësjellësa*, por vetëm janë përfshirë si një zë i vetëm në përmbledhësen e inventarëve të vitit 2025, pa u zbërthyer analitikisht në zëra të veçantë.
- Nuk është kryer inventarizimi i Aktiveve Afatgjata Jomateriale, *(llogaria 203 "Koncesione, licenca, patenta e të ngjashme")*, që paraqitet në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare me vlerën 20,194,217 lekë në fillim të vitit 2025 dhe 18,313,570 lekë në fund të kësaj periudhe). Nuk është hartuar dhe miratuar urdhri i titullarit të Bashkisë për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale.
- Në përfundimin e procesit të Inventarizimit, komisioni i Inventarizimit ka hartuar relacionin për mbylljen e inventarit për Kryetarin, por ky raport / relacion nuk ka miratim nga ana e Kryetarit të Bashkisë Përmet, në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 85 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar.

(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve Afatgjata (AAGJ), i cili të verifikojë dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit me llogaritë kontabël përkatëse për gjithë zërat e aktiveve dhe në përfundim të punës komisioni të hartojë raportin për drejtuesin e institucionit mbi rezultatet e inventarizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Bashkisë Përmet është hartuar dhe miratuar "Manuali i proceseve për menaxhimin e Aktiveve vendore", *(protokolluar në këtë Bashki me nr. 308 prot, datë 31.01.2025).* Megjithatë, nga auditimi rezultoi se, krahas këtij dokumenti nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për miradministrimin e aktiveve, si një dokument që miratohet nga Këshilli i Bashkiak i njësisë së vetëqeverisjes vendore për një periudhë afatmesme, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 8, pika 8/ç; Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar; Kreun IV, të Manualit të MFK-së miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.4, datë 26.1.2024*;* Udhëzimit nr. 30/2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik"* i ndryshuar, Kreu I, pika 5 e 6 *dhe* Kreu II, pika 17-25. *(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 3, faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1.Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i Bashkisë Përmet, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të marrë masat për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Pronave Publike Vendore dhe të Rregullores për Menaxhimin e Aktiveve, si dokumente bazë për administrimin, mbrojtjen, inventarizimin, vlerësimin dhe përdorimin me efektivitet të aktiveve publike të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Këto dokumente të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Përmet në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor e nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me qëllim forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e një menaxhimi efektiv, ekonomik dhe transparent të aktiveve vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Raporti Përfundimtar i Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Përmet administruar në KLSH me nr.323/9, datë 22.10.2025 është protokolluar në Bashkinë Përmet me nr. 3526, datë 23.10.2025.

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit:

a. Janë rekomanduar 24 masa organizative; (17 prej tyre te lidhura me AF)

b. Janë rekomanduar 4 masa shpërblim dëmi (0 prej tyre te lidhura me AF)

c. Janë rekomanduar 4 masa për uljen e borxhit tatimor;

d. Janë 2 dy rekomandime për Kryetarin e Bashkisë Përmet që të shqyrtojë raportin përfundimtar të auditimit dhe ti kërkojë komisionit vendosjen e masave disiplinore për 21 persona të cilat janë trajtuar në raportin përfundimtar.

-Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH është 100 %

-Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara nga ana e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuara, që i përkasin auditimit financiar paraqitet si më poshtë:

Janë rekomanduar 17 masa organizative, 4 masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore dhe 2 masa disiplinore

a).*17 masa organizative të* cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat 9 masa janë zbatuar plotësisht, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 2 masa nuk janë zbatuar.
b). Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, me efekt mungesë të ardhurash janë rekomanduar 4 masa për të cilat janë pranuar plotësisht 4, nga të cilat 1 masë është zbatuar plotësisht, 1 pjesërisht dhe 2 masa janë në proces zbatimi.
*c). Masa disip*linore janë rekomanduar 2 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat 2 masa janë zbatuar.
- Nga Bashkia Përmet nuk janë marrë masat e duhura për zbatimin e plotë të këtyre rekomandimeve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 4, faqe 99-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë, duke marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe atyre në proces zbatimi si më poshtë:

Masa Organizative
11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit të marrë masa që deri në mbyllje të vitit ushtrimor 2025:
- Të sistemohet llog. 468 "*Debitorë të ndryshëm*" për vlerën 5,724,449 lekë që përbën vlerën e detyrimit progresiv nga të ardhurat vendore e cila nuk rezulton e kontabilizuar nga DFB;
- Për nëntë projektet e hershme të periudhës deri në vitin 2015 në vlerën totale 7,302,172 lekë që përfshihen në llog.202 "*Studime e projektime*", të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 "AAM": llog.212 apo llog.213 sipas rastit tek investimi respektiv;
- Në llog. 218 "*Inventari ekonomik*" të klasifikojë veçmas llog.2186 "*Pajisje kompjuterike"* në regjistrin e aktiveve të njësisë dhe pasqyrat financiare, sipas nomenklaturës së llogarive;
- Me mbylljen e procedurave të pajisjes me titull pronësie të aseteve të transferuara me VKM, të parashikohet në PBA fond për rivlerësimin e tyre, me qëllim kontabilizimin në llogaritë respektive të klasës 21 "AAM";
- Të llogarisë amortizimin sipas normës përkatëse për çdo aktiv, për të patur në çdo kohë informacion të saktë mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero, të cilat nga rivlerësimi do rezultojnë në gjendje pune;
- Me mbylljen e llogaritjeve të kapitalit të ish UK Përmet pjesëmarrës në UK Rajonale Gjirokastër, të saktësohet dhe vlera e llog. 26 *"Pjesëmarrje në kapitalin e vet".*

14.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë dhe Sektori i taksave e tarifave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit, të marrin masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukturore, për mirëadministrimin dhe mos kompromentimin e informacionit tatimor, si dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Ekonomike dhe STT të analizojnë me vëmendje të shtuar shkaqet që kanë sjellë mosrealizimin e të ardhurave nga taksat e tarifat përkatëse sipas parashikimit vjetor, si dhe të marrin masa për hartimin e planeve strategjik e vjetor

jo vetëm për rritjen e të ardhurave nga arkëtimi i detyrimit vjetor të tatimpaguesve, por edhe për minimizimin e vlerës së debisë progresive.

15.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, GMS në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit, Drejtorinë Ekonomike dhe Sektorin e të Ardhurave nga taksa e tarifa vendore, dhe gjithë strukturat që sigurojnë të ardhura nga aktiviteti i tyre të marrin masa:
- Për planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshme dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik;
- Për të kryer rakordim periodik mujor dhe vjetor me agjentët tatimor DRSHTRR Gjirokastër, DRT Gjirokastër, DPD/Dogana "Tre urat" Përmet dhe ASHK Vendore Gjirokastër, sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Përmet nga taksat që mblidhen nga këta agjentë.

16.1.Rekomandimi: Drejtoria ekonomike dhe e të ardhurave vendore dhe Njësitë Administrative, dhe gjithë strukturat e Bashkisë që nga funksioni i tyre sigurojnë të ardhura për buxhetin e Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe buxhetit dhe Zyrën Juridike të marrin masa për të riverifikuar në terren çdo subjekt që ushtron aktualisht aktivitet në territorin e Bashkisë Përmet, duke:
- identifikuar subjektet që ushtrojnë më shumë se një aktivitet të pa deklaruar,
- të rillogarisin vlerën e saktë të detyrimeve vjetore të pa paguara të këtyre subjekteve, referuar kuadrit ligjor dhe vlerës së përcaktuar në VKB që ka miratuar "paketën fiskale të vitit ushtrimor 2025"

17.1.Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të planifikohen në buxhet Fondi i kontigjencës; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta mbi arsyet e realizimit dhe mosrealizimit të buxhetit në total dhe për çdo zë buxhetor, sipas programeve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e riskut dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrit të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjes së detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/mallra apo vendimeve gjyqësore; për të paguar detyrimet sipas planit të miratuar dhe raportuar në MFE për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën 2,648,974 lekë deri në fund të vitit 2025; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre në afat dhe sipas radhës; si dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të prapambetura në periudhat e ardhme;
- Drejtoria e Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më real të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre brenda afatit të përcaktuar

dhe sipas radhës, por dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

20.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Përmet, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për përmirësimin e komponentëve të MFK dhe veçanërisht për forcimimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, nëpërmjet: rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të Kordinatorit të MFK dhe Kordinatorit të riskut; plotësimit të kuadrit rregullator me krijimin e një strukture efektive, miratimin e proceseve të punës, rregullores për menaxhimin e aktiveve dhe të gjurmëve të auditimit, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; forcimit dhe standardizimit në implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT të avancuara, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në Bashki.

Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)
1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të marrin masat për verifikimin e listës së debitorëve të trashëguar nga ish komunat për saktësimin e numrit dhe të debitorëve si dhe arkëtimin e vlerës debitore 33,616,134 lekë.

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për monitorimin dhe ndjekjen e kontratave të qirasë, me qëllim zbatimin e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara në shumën totale prej **1,641,667 lekë**, që rrjedhin nga dhënia me qira e aseteve publike, si dhe të merren masat për ndjekjen e pagesave të késteve të kontratave të shitjes nga procesi i privatizimit, në shumën totale prej **343,261 lekë**.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike dhe e të Ardhurave, të hartojë një plan masash periodik dhe vjetor për të siguruar vjeljen e taksave dhe tarifave vendore brenda afateve të miratuar me VKB si për familjarët dhe për biznesin, me qëllim parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ditarit të shpenzimeve të Bashkisë Përmet rezultoi se gjatë vitit 2025 janë likuiduar shpenzime në vlerën totale 501,160 lekë , si pasojë e humbjes së proceseve gjyqësore për marrëdhëniet e punës, përkatësisht shuma 481,480 lekë, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 671 (86-2025-852), datë 24.04.2025, me objekt dëmshpërblim page dhe 19,680 lekë, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 778, datë 12.05.2025.
Nga verifikimi i dokumentacionit nuk rezultoi të jenë kryer analiza administrative për identifikimin e shkaqeve që çuan në humbjen e proceseve gjyqësore, si dhe për evidentimin e

përgjegjësive dhe përmirësimin e praktikave administrative që kanë gjeneruar këto detyrime financiare. Likuidimi i shumës **501,160 lekë** ka sjellë kosto shtesë për buxhetin vendor dhe ka cenuar parimet e ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.
(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.1, faqe 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Përmet të marrë masa për analizimin e çdo procesi gjyqësor të humbur, evidentimin e shkaqeve dhe përcaktimin e përgjegjësive administrative, si dhe për vendosjen e masave korrigjuese me qëllim minimizimin e kostove financiare dhe parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se,
Detyrimet e papaguara për taksa dhe tarifa vendore më datë 31.12.2024 janë **92,232,291 lekë,** nga këto biznesi i madh dhe i vogël 30,450,900 lekë, abonentët familjarë për 27,346,796 lekë dhe të tjera *(kontrata, gjoba, Aluizni etj):* 34,434,595 lekë. Detyrimet e likuiduara gjatë vitit 2025 janë në shumën **2,787,629 lekë.**
Detyrimet e krijuara gjatë vitit 2025evidentohen në shumën **14,164,044 lekë**, *nga të cilat,*
- Detyrimi që subjektet fizikë/juridikë kanë ndaj Bashkisë Përmet për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 është 3,432,894 lekë.
- Detyrimi që subjektet familjarë kanë ndaj Bashkisë Përmet për taksa e tarifa në fund të vitit 2025 është 3,586,189 lekë.
- Detyrime të shtuara për kategori të tjera 7,144,961 lekë

Gjendja progresive e detyrimeve më datë 31.12.2025 është**në** shumën **103,608,706 lekë,** (ose shtuar +11,376,415 lekë krahasuar me fundin e vitit të mëparshëm, ose 12.3 % më shumë).
Nga kjo debi progresive,

- Gjendja e detyrimeve për taksa e tarifa në trajtë *progresive* në fund të vitit 2025 për subjektet fizik/juridik është **31,343,418** lekë.
- Gjendja e detyrimeve për taksa e tarifa në trajtë *progresive* në fund të vitit për abonentët familjarë në vlerën **30,932,985** lekë.
- Gjendja e detyrimeve për taksa e tarifa në trajtë *progresive* në fund të vitit për kategori të tjera (Gjoba, Aluizni, IMT etj) për **41,332,303** lekë.

***Në total borxhi tatimor është në vlerën* 103,608,706 lekë,** vlerë e cila është evidentuar në kontabilitet, ndërsa rezultojnë dhe shuma të detyrimeve të prapambetura për tatime e taksa të pa kontabilizuara në fund të vitit 2025 *(detyrimet e vitit 2025 për popullatën nuk janë kontabilizuar në pasqyrat financiare për shkak të vonesave në mbajtjen e aktit të rakordimit të të ardhurave vendore në shumën* **2,054,221 lekë** në ngarkim të 1,486 debitorëve familjarë).
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar dhe me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93. me VKB-në nr. 96, datë 27.11.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore dhe administrimin e tyre për vitin 2025",*(Më hollësisht gjetja trajtuar në pikën 2.2, faqe 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik, Drejtoria Financës dhe e

Buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me strukturat e tjera të Bashkisë Përmet, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e shumës së borxhit progresiv tatimor prej **103,608,706 lekë,** krahas pjesës së detyrimit të pa kontabilizuar në vlerën **2,054,221 lekë** në ngarkim të 1,486 debitorëve familjarë, veçanërisht për arkëtimin e debisë prej 34,776,313 lekë të debitorëve të kategorisë "biznes".

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria Financës dhe e buxhetit, Sektori i të Ardhurave vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të marrin masat për verifikimin e listës së debitorëve të trashëguar nga ish- komunat për saktësimin e numrit dhe të debitorëve, si dhe arkëtimin e vlerës debitore të regjistruar në librat e kontabilitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Përmet, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT